

ISMAIL  
KADARE

---

BH-3

K14

UNAZA  
NE  
KTHETRA

Sprova letrare,  
Shkrime të ndryshme,  
intervista

Onufri

## NGA I NJËJTI AUTOR

- Dialog me Alain Bosquet, botimi i parë*, 1996  
*Dialog me Alain Bosquet, botimi i dytë*, 1996  
*Spiritus*, roman, 1996  
*Kushëriri i engjëjve*, ese, 1997  
*Tri këngë zie për Kosovën*, triptik, *botimi i parë*, 1998  
*Kombi shqiptar në prag të mijëvjeçarit të tretë*, ese, 1998  
*Pallati i Ëndrrave*, roman, 1999  
*Ikja e shtërgut*, tregim, 1999  
*Tri këngë zie për Kosovën*, triptik, *botimi i dytë*, 1999  
*Dialog me Alain Bosquet, botimi i tretë*, 1999  
*Qorrfermani*, roman, 1999  
*Vjedhja e gjumit mbretëror*, tregime, 1999  
*Ra ky mort e u pamë*, ditar për Kosovën, artikuj, letra, 1999  
*Kohë barbare (Nga Shqipëria në Kosovë)*, biseda, 2000  
*Ra ky mort e u pamë*, ditar për Kosovën, artikuj, letra, 2000  
*Kronikë në gur*, roman, 2000  
*Breznitë e Hankonatëve*, 2000  
*Bisedë përmes hekurash*, 2000  
*Spiritus*, roman, *botimi i dytë*, 2000  
*Lulet e ftohta të marsit*, roman, 2000  
*Eskili, ky humbës i madh*, 2001

## MBI AUTORIN


- 1) *Shaip Beqiri*, Sfida e gjeniut, Kadare, Ekzili, Kosova
- 2) *Tefik Çaushti*, Universi letrar i Kadaresë
- 3) *Tefik Çaushti*, Kadare – Fjalor i personazheve
- 4) *Injac Zamputi*, Ekskursion në dy vepra të Kadaresë
- 5) *Shaban Sinani*, Pengu i moskuptimit
- 7) *Emin Kabashi*, Kadare-mendësia shqiptare
- 8) *Alfred Uçi*, Grotesku kadarean
- 9) *Bashkim Kuçuku*, Kadare në gjuhët e botës

85H-3  
K14

Ismail Kadare

*Unaza në kthetra*

sprova letrare, shkrime të ndryshme,  
intervista



Onufri

*Përgatiti për botim:*  
Bujar Hudhri

*Kopertina*  
Lulzim Mema

*Korrektor*  
Nexhat Myftiu

© Onufri, 2001

*Të gjitha të drejtat e botimit, në gjuhën shqipe,  
brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë,  
i takojnë Shtëpisë Botuese Onufri*

ISBN 99927-45-30-4

*Shtëpia Botuese Onufri*  
*Rr "S. Pasha", Tiranë*  
Tel&Fax 00355 42 20017  
<http://www.Onufri.com.al>  
E-mail: [onufri@abissnet.com.al](mailto:onufri@abissnet.com.al)

## LËNDA

### I

A i është dashur letërsia njerëzimit?

-Vendi i shenjuar

-Dita e 29 prillit

Zhvendosjet e popujve

Darka e botës

Don Kishoti në Ballkan

### II

Unaza në kthetra

Portret artisti në rini, version shqiptar

Fjalimi i pranimit në Akademinë Franceze

### III

Kur kërkohet e drejta për të tradhtuar

Për kë punon koha

Ne, që s'duam vetveten

Shqipëria, si do të jetë në Ballkan

## A I ËSHTË DASHUR LETËRSIA NJERËZIMIT?

*Konferencë e mbajtur në një forum  
botëror të letërsisë në Munih, më 22 mars  
1992.*

A i është dashur letërsia botës? Ndoshta nuk do të kishim të drejtë ta bënim këtë pyetje, që të kujton animatorët e dobët të TV, kur përpiqen të gjallërojnë një bisedë shterpë, sikur pyetja të mos ishte bërë, ndërkaq, mijëra vjet më parë. Dihet që ka patur dy lobe të kundërt: pro dhe kundra letërsisë.

Letërsia, pra, ka lindur bashkë me një mohim, me një pengesë. Sado që në pamjen e parë të duket si e habitshme, po të mendohemi pak, do të vijmë në përfundimin se ky negacion i shkon letërsisë, madje, fare natyrshëm. Negacioni dhe letërsia janë të së njëjtës racë. Shkurt, më shumë se nga engjëlli, letërsia duket si e prirë nga djalli.

Le ta shikojmë në mënyrë fare të thjeshtë gjithçka. Letërsia, domethënë poemat e para orale, kanë, zakonisht, për subjekt kthimin nga një udhëtim i gjatë, rrëfimin për ato ç'kanë ndodhur atje larg, në kufi të shtetit, të shkretëtirës ose të vdekjes.

Udhëtarët e parë që ktheheshin nga larg ishin, praktikisht, dhe shkrimtarët e parë. Duke ecur drejt vendit të tyre, në vetminë e rrugës, truri i tyre përpunonte ngjarjet në mënyrë që gjatë rrëfimit ato të ishin sa më interesante për dëgjuesit. Kështu, në udhë dilnin dialogët, përtëriheshin ngjarjet, dendësoheshin ngjyrat, theksohej diçka e diçka tjetër fshihej.

Por ndonëse udhëtarët sillnin ngjarjet, heronjtë e tyre ishin së shumti larg. Ata zakonisht mungonin, ishin përherë matanë, përtej kufirit të shtetit e, zakonisht, përtej jetës, domethënë të vdekur.

Kështu, qysh në fillimet e letërsisë mungesa dhe vdekja zunë vendin e nderit. Por letërsia hyri në domenin e vdekjes jo për t'iu përlurur asaj, por si e barabartë me të. Te poema madhështore për Gilgameshin, letërsia, duke e njohur pushtetin e vdekjes, merrte, megjithatë, të drejtën t'i bënte një qortim asaj. Gilgameshi mposhtet prej vdekjes, por, për hir të letërsisë, një pjesë e tij i ikën, i shpëton, megjithatë, vdekjes. Është një zgjidhje kompromisi, po të përdorim një formulë të kohës sonë. Të tilla kompromise të mëdha me të pamundurën mund të bënte vetëm një art i madh.

Letërsia vazhdoi të ushqehet nga vdekja dhe nënproduktet e saj: nata, gjumi, ëndrrat, vrasja e ndërgegjes.

Letërsia qysh në fillimet e saj u lidh me aktin e flijimit. Troja ishte kërkesa e saj e parë në këtë altar. Më pas me qindra ishin ngjarjet, subjektet, personazhet dhe skenat, që përpara se të ushqenin letërsinë u spërkatën nga gjaku dhe zija. Kur poeti shqiptar Fan Noli përktheu "Waterlonë" e Hygoit, shënoi në fund të saj se, pas gjithë asaj tragjedie, kishin së paku një

ngushëllim: këtë poemë që nuk do të mund të lindte pa të.

Letërsia u mësua kështu të kërkojë fli. Në një mënyrë ose në një tjetër ajo na kërkon ne. Në një mënyrë ose në një tjetër ne i paguajmë tributin.

Vdekja, gjumi, vrasja e ndërgegjes, të gjitha këto të kujtojnë natën. Nata, në mendimin skematik njerëzor lidhet me negacionin. Por ne e përmendim këtë mendjelehtësisht, pa menduar se ç'tmerr do të ishte koha në botë, sikur të mos ndërpritej nga nata. Sikur gjithë kalendari të përbëhej nga një ditë e pafundme. Askush, pra, nuk është kujtuar gjër më sot të bëjë një studim hipotetik se çfarë roli ka luajtur nata në zbutjen e njerëzimit. Pa ndërhyrjen e saj, pa frenimin, pa ndërprerjen e saj revani i së keqes, i nervozizmit, i tërbimit njerëzor do të arrinte ritme katastrofike.

Në periudhën e saj të parë letërsia nuk ka njohur veç po ato rreziqe që kërcënonin jetën njerëzore: harrimin, shuarjen. Rapsodët këndonin, njerëzit i dëgjonin, pastaj dilnin rapsodë të rinj që këndonin këngë të reja, që vdisnin bashkë me to ose pak më vonë. Letërsia njihte kështu pak a shumë ato rreziqe natyrale si edhe jeta njerëzore. Më pas ajo njohu rrezikun e parë që vinte nga një sferë tjetër: nga shoqëria, shteti. Ishte teatri, me sa duket, që, për shkak të grumbullimit të njerëzve mu në mes të qytetit, provokoi së pari idenë e censurës.

Censura zyrtare lindi, kështu, dymijë e pesëqind vjet më parë dhe ishte kaq e fuqishme, sa që u shkaktoi mjaft telashe edhe kolosëve të tillë, siç qenë tragjikët e mëdhenj.

Censura lidhet me shkrimin. Sa pa u shpikur shkrimi



prej akkado-sumerëve, kontrolli i poezisë orale s'mund të ishte veçse i pasaktë dhe jo këmbëngulës. Shumëshumë një rapsod jokonformist nuk do të ftohej të këndonte në gostinë e princit dhe puna merrte fund me kaq.

Kur në horizont të kulturës botërore u shfaq shkrimi, ky ishte vërtet një tërmet i papërfytyrueshëm.

Shkrimi ishte një makinë e dyfishtë. Nga një anë, ai i hapte një horizont të ri letërsisë, nga ana tjetër, e ngrinte atë, e vdiste, e mumifikonte.

Përpara një faze të re të zhvillimit, letërsia, sipas kanunit të saj të ashpër, u kërkonte prapë shkrimtarëve një tribut të rëndë. Të jepnin një pjesë të spontanitetit të tyre, ta kalonin mendimin nëpër rrotëzat, rripat dhe në makinën e rëndë të sintaksës. Të mos mundnin dot ta qortonin atë lirisht, në çdo ditë të re të Zotit, sipas gjendjes së tyre shpirtërore. Shkrimi ishte kontroll i dyfishtë. Kontrolli i ndërgjegjes së tyre, i përgjegjësisë përpara kohës, por edhe kontroll zyrtar.

Historia e shkrimit është, në radhë të parë, historia e rrezikimit të shkrimtarëve.

Disa shprehje të sotme që lidhen me këtë, si “kjo vepër letrare mund të të djegë” ose “të të bjerë si fatkeqësi mbi kokë”, bëhen çuditërisht të qarta, po të mendojmë pllakat e argjilit mbi të cilat sumerët shkruanin mendimet e tyre. Kur pllakat e pjekura i nxirrite nga furra pa kujdes, shkrimtari mund të digjte duart. Ose, një vepër letrare, ta zemë, një rrëfim i gjatë, mund të ishte vendosur në studion e shkrimtarit në formë muri dhe një ditë, për shkak të vendosjes jo të kujdesshme të pllakave, të pjekjes jo të mirë ose të një tërmeti, vepra mund të rrezohej e të zinte nën vete shkrimtarin.

Por, si gjithçka fillestare, edhe këto s'ishin veçse rreziqe të thjeshta, në krahasim me ato që do të vinin më pas. Dhe më pas do të vinin lemeritë që dihen tashmë.

Ikja e Eskilit nga Athina do të hapte serinë e ikjeve të mëdha. Eskili dhe Homeri ishin shkrimtarët më të mëdhenj të njerëzimit gjer në shekullin e pestë. Kështu, së paku, njëri nga dy më të mëdhenjtë u detyrua të braktisë vendin. (Them së paku, sepse s'përrjashtohet mundësia që Homeri, si rapsod shëtites, të ketë lëvizur aq shumë, sa që për të fjala ikje të mos kishte ndonjë kuptim në jetën e tij).

Ikja ose dëbimi i shkrimtarëve u lidh kështu me letërsinë, hyri si të thuash në kodin gjenetik të saj tepër herët. Por ikja gjithashtu pësoi ndryshim gjatë shekujve. Ndërsa koha në botë qëllonte që zbutej, qëndrimi ndaj letërsisë egërsohej.

Ikja e Ovidit nga Roma na duket ndoshta më e dhimbshme, ngaqë, ndryshe nga Eskili, ku rolin kryesor për vendimin e ikjes e luajti zemërimi i shkrimtarit, Ovidi u dëbua nga shteti. Me Ovidin nisi internimi i shkrimtarëve në kuptimin e sotëm të fjalës.

Në rastin e Ovidit kemi të gjitha shenjat e totalitarizmit të ardhshëm: dënimin pa shkak të shpallur. Domethënë atë lloj shtypjeje të shtetit totalitar, kur ti nuk e ke as vetë të qartë përse të dënojnë. Ky terror i pashpjeguar, kjo goditje e verbër do të mbetet një nga makinat kryesore të terrorit gjer në shekullin e XX, kur komunizmi, pasi ta përkryejë makinën, njëlloj si te makina e Kafkës, do të shembet bashkë me të.

Me ikjet e tyre, shkrimtarët e mëdhenj, që nga Eskili te Dante Aligieri, duket sikur kërkuan në një farë mënyre të rikthehen në atë zonë, në atë klimë, në atë kaos prej

nga lindi letërsia. Me fjalë të tjera, ata deshën të provonin një tjetër gjendje të tyre, një gjysmëvdekje, për të mos thënë vetë vdekjen. Ishte, ndoshta, një urdhër i brendshëm i artit, i ritit të madh të tij që i sugjeroi Dantes që, para se të niste të përshkuante udhëtimin nëpër ferr, të largohej në njëfarë mënyre nga jeta.

Megjithatë, duhet thënë se gjer te Dante Aligieri, shkrimtarët, qoftë dhe në fatkeqësi, trajtoheshin përgjithësisht si një racë senjorale. Ishin diktaturat e mëvonshme ato që e kuptuan se, për t'i goditur më mirë, duhej që shkrimtarëve t'ua ulje rangun. Kështu u bë zakon ajo që më parë ngjante e pazakonshme: burgimi i shkrimtarëve, rrasja e tyre në qelitë e përbashkëta, internimi, çnderimi, zhvendosja me tren nga një kamp në tjetrin, fyerjet, riedukimi me anë të punës etj., etj.

Rendi komunist ishte ai që më shumë se çdo rend tjetër e mori seriozisht luftën kundër letërsisë. Komunizmi dhe letërsia e vërtetë s'mund të bashkëjetonin kurrë. Qëndrimi mohues ndaj letërsisë nuk është deformim i mëvonshëm. Ai është në gjenezën e komunizmit. Paragrafet e cekëta të Marksit për letërsinë antike ose për Shekspirin s'janë veç një alibi për të mbuluar krimin e mëvonshëm. Në vizionin e tij të botës së ardhshme nuk ka vend për letërsinë. Artikulli platformë i Leninit "Letërsia e partisë dhe organizata e partisë" ishte aq barbar për nga pasojat e tij, sa që mund të kishte poshtë nënshkrimin e Xhingis Khanit. Por, nga artikulli i Leninit te pushkatimet e Stalinit, tek urrejtja patologjike e Maos për shkrimtarët, gjer te Pol Poti i Kamboxhias, që i masakronte njëlloj, si ata që shkruanin libra, dhe ata që i lexonin ato, kalon si një fill i kuq qëndrimi për letërsinë.

Totalitarizmi kuptoi, gjithashtu, se shkatërimi i letërsisë nuk mund të bëhej vetëm me terror. Ai e kuptoi se jo asgjësimi, por vetasgjësimi i letërsisë do të ishte zgjidhje e plotë e problemit.

Komunizmi totalitar nisi kështu një nga aksionet më kriminale të tij: varrosjen e letërsisë prej vetë shkrimtarëve. Vetëcensurën, këtë sëmundje shekullore, me të cilën letërsia që ndeshur edhe më parë dhe që në një mënyrë ose në një tjetër e kishte kapërcyer, komunizmi u përpoq ta kthente në murtajë.

Dhe ai arriti, në njëfarë mënyre, ta bënte këtë. Mijëra shkrimtarë, kryesisht mediokër, e rrethonin nga të gjitha anët tempullin e letërsisë. Numri i tyre shtohej çdo ditë në atë masë që numri i shkrimtarëve të vërtetë, të atyre që përpiqeshin të mbanin gjallë zjarrin e shenjtë, sa vinte pakësohej.

Asnjëherë letërsia e gjysmës së botës nuk kishte ndeshur me një rrezik të tillë. Shkrimtarët u ndanë kështu më dysh: në ata që e tradhtuan tempullin dhe në ata që i qëndruan besnikë. Pyetja hyjnore që mund t'u bëhej shkrimtarëve të Lindjes "ç'bëre ti Adam?" do të kishte në këtë rast dy përgjigje. E para: unë u degradova sipas ligjeve të komunizmit. E dyta: unë vazhdova të shkruaj normalisht, sikur komunizmi të mos ekzistonte.

Është thënë edhe herë të tjera se, të mendoje normalisht në botën e çmendur komuniste, është, ndërkaq, një qëndresë e parë. Të flisje normalisht, kjo ishte pothuajse heroike.

Komunizmi u shemb pa e njëmendësuar dot ëndrrën e tij të mbrapshtë. Ne e arritëm fundin e këtij mijëvjeçari pa të. Ka tre mijë vjet që letërsia jeton në botë. Mijëvjeçari i saj i parë ka qenë i pasur e plot

dritë. I dyti, për fat të keq, ishte i varfër. U duk sikur njerëzimi donte të pushonte njëfarë kohe, gjersa erdhi mijëvjeçari i tretë, ky që po jetojmë, i cili prapë e ringjalli letërsinë. Le të shpresojmë që mijëvjeçari i ri, i katërti i saj, të mos përsëritë, për një simetri fatale, të dytin.

## VENDI I SHENJUAR

*Shkruar për World Media*

Sikur shumë vite më parë, kur isha në gjimnaz, të dëgjoja se pyetjes "ç'vend të ka mbetur i shenjuar në qenien tënde" dikush do t'i përgjigjej: "një fushë" (një fushë me emrin X ose Y.), do të habitesha pa dyshim dhe, ndoshta, do të zemërohesha më pas.

Jetoja në Shqipëri, ku në vjersha, në përralla, në historitë që rrëfeshin ishte përherë kulti i maleve. Më pas do të merrja vesh se emri i krejt gadishullit të madh, ku gjendej vendi im, vinte nga një fjalë turke, që do të thoshte "vend malesh".

Ka mbetur një gjë e pashpjegueshme përse ky gadishull, djepi i parë i qytetërimit evropian, i mbetur pa emër të përbashkët gjatë dymijë e ca vjetësh, pranoi të quhet më së fundi "Ballkan", pra, pranoi emrin me të cilin e pagëzuan ata që quheshin kundërshtarët e tij mortorë: turqit osmanë.

A mund të thuhet, megjithatë, se ishin turqit ata që, të ardhur nga rrafshullat e Anadollit, të trandur e njëherësh të trembur prej pamjes së maleve, projektuan te popujt e gadishullit atë nderim të veçantë për malet, nderim që mund të krijohet vetëm nga përzierja e



mahnitjes, frikës dhe së panjohurës?

Kurrsesi nuk ka qenë kështu. Shumë shekuj para mbërritjes së osmanëve banorët e gadishullit kishin arritur, ndërkaq, t'i himnizonin malet e tyre, madje, me tepri. Ishin grekët e vjetër të parët, që e kishin shpallur malin e Olimp të strehë të perëndive, pra, kryevendin e shenjtë të botës. Popujt e tjerë fqinjë, nën këtë shembull, zgjodhën edhe ata male të tyre, për t'i himnizuar si simbole të ngjijtes lart, të mospërkuljes e të shpresës në ditë të këqija.

Përse pikërisht malet? - mund të pyeste dikush. Mos vallë ngaqë ato ishin të panevojshme dhe, siç ndodh shpesh, janë pikërisht gjërat e panevojshme që sublimohen?

Ndonëse mund të ketë një pjesë të së vërtetës në këtë shpjegim, ai mbetet i mangët. Kryesorja që ka vendosur peshën e maleve ka qenë dukja e tyre. Malet duken. Që larg dallohen kreshtat e tyre, dëbora, çarjet e frikshme. E mbuluar nga retë, dukja e tyre s'humb asgjë, përkundrazi fiton. Një autoritet ka nevojë, pra, për t'u dukur. Në qoftë se pranë deltës së Nilit do të kishte male, piramidat nuk do të ndërtoheshin kurrë.

Nga kjo pikëpamje, fushat janë e kundërta e maleve. Ato nuk duken, ose duken pak, me përmasa të kufizuara, sidomos kur je midis tyre. Pra, kanë mbetur pa peshë dhe pa autoritet pikërisht ato që e mbajnë jetën gjallë. Raporti mal-fushë në peizazhin e jetës ballkanase ngjan çuditërisht me raportin burrë-grua.

Burrat duken. Në tribune, në kuvend, në log të burrave, në dhomën e miqve. Gratë nuk duken ose duken fare pak. Ndërkaq, janë ato që përgatitin darkat, ku burrat do të hanë, do të pinë e, natyrisht, do të krenohen për gjëra të qena e të paqena.

Kjo kronikë ka vazhduar me shekuj në Ballkan. E meqenëse kanë qenë burrat ata që kanë krijuar kodet, rapsoditë dhe ligjet, pa dyshim që e kanë kapur ngjasimin e tyre me malet madhështore, por jo fort të nevojshëm, dhe nëpërmjet maleve kanë sublimuar veten.

Në kronikën e botës ka shpesh përpjekje për revizionim. Një nga këto ka qenë dalja e gruas në skenë. Midis luftërave, midis epidemive, midis dëshpërimit del shpesh një grua, që i habit të gjithë. Jeanne d'Arc e francezëve është tipike.

Por gratë nuk pranohen lehtë në log të burrave. Jeanne d'Arc u dogj si shtrigë dhe ende sot ka njerëz që nuk e duan në Francë.

Midis aradhës homerike të maleve të Ballkanit, një fushë u përpoq, më në fund, të hynte: Fusha e Kosovës. Emri i saj ishte i ëmbël, romantik: Fusha e Mëllenjave. Hyrja e saj ishte shqetësuese, ngatërrestare, tamam hyrje prej gruaje, siç përfytyrohej me mllef nga pleqtë e moçëm. Me fjalë të tjera, hyrja e një shtrige.

Një fushë ku u bë një luftë. Ku u derdh shumë gjak njerëzor. Gjak popujsh të ndryshëm, me kombësi, fe e ligje të ndryshme. Një fushë lufte me pamje të dyzuar. Me fjalë të tjera, një disfatë që përkujtohet prej një pjese të të mundurve si të ishte fitore. Shkurt, fillimi i një mashtrimi i ndjekur nga një grumbull tjetër mashtrimesh. Më e keqja, një fushë lufte, që pas gjashtë shekujsh kërkonte ende gjak.

Përse gjak i ri? Nga kush? Të mundurit kërkojnë revansh ndaj fitimtarëve? Kurrsesi. Fitimtarët, turqit, janë larg dhe të paarritshëm. Përveç kësaj, ata janë



anëtarë të NATO-s.

Atëherë, nga kush kërkohet gjaku? Përgjigjja është tronditëse: serbët, një pjesë e të mundurve, e kërkojnë gjakun prej shqiptarëve, ish-aleatëve të tyre, gjithashtu, të mundur prej turqve.

Përse? Në bazë të ç'të drejte, të ç'logjike?

Përgjigjja është: të asnjë të drejte, të asnjë logjike.

Për të kuptuar, këtë duhet të dimë çka ndodhur vërtet në Fushë të Kosovës më 28 qershor të vitit 1389.

Me dy fjalë, ka ndodhur kjo: trupat perandorake osmane, bashkë me aleatët e tyre, myslimanë e të krishterë përzier, mbërrinë në Fushën e Mëllenjave. Përballë tyre janë aleatët ballkanas: serbët, shqiptarët, boshnjakët, vllahët, kroatët, të gjithë të krishterë. Lufta është e egër, ballkanasit thyhen.

Kjo është e vërteta. Nuk ka tjetër.

Për ta përmbysur këtë të vërtetë, pra, për të përligjur masakrën e saj kundër shqiptarëve, Serbia ka krijuar një mal me mashtrime.

Mashtrimet e saj, ndonëse të përkrahura nga miqtë e saj, nuk ecën. Serbia u ndëshkua. Mbi Fushën e Mëllenjave është ngritur sot flamuri i Evropës.

Kur më 1972 shkela për herë të parë në fushën, për të cilën kisha dëgjuar të flitej aq shumë, ishte muaji tetor. Ajo shtrihej e qetë, me pak mjegull anëve, e ftohtë në prag të dimrit.

Një monument prej guri në trajtë pirgu, në zgavrinën e të cilit mund të ngjiteshe gjer në majë të tij, ishte ngritur për kujtim të betejës. Përballë, jo shumë larg ishte një tyrbe myslimane, ku janë varrosur jo trupi, por gjaku dhe rropullitë e sulltan Muratit I. Monumenti

*varrë nga pirgja kosovare uillo in kopje*

dhe tyrbja kanë gjashtë shekuj që rrinë përballë, ai, i lartë e krenar, ajo e pikëlluar e pa madhështi, siç janë shpesh vendvarrimet myslimane. Një vizitor që nuk di asgjë nga historia do të kujtonte se monumenti simbolizon fitimtarët dhe tyrbja të mundurit. Në të vërtetë, është e kundërta. Ky është paradoksi i parë, sidoqoftë i falshëm, ngaqë jemi në tokën ballkanase, ku njerëzit e përfytyrojnë historinë sipas ëndjes së tyre.

Mashtrimi fillon shkallë-shkallë te muret e monumentit, atje ku janë ngjitur pllakë bronzi, që flasin për betejën. Në ato pllaka flitet vetëm për serbët. Lart, në një tarracë, prej nga vizitorët mund të sodisin fushën, është një pllakë tjetër, e cila shpjegon betejën. Atje përsëritet e njëjta gjë. Është falsifikuar thelbi i betejës: pjesëmarrësit në të. ✓

E gjithë kjo është tejet e trishtueshme. Një luftë, që duhej të ishte simboli i miqësisë së popujve që luftuan bashkë kundër fatkeqësisë së përbashkët, është kthyer në të kundërtën: në minierë të urrejtjes dhe të krimit.

Lart, në tarracën e monumentit ia them mendimin tim, poetit të njohur që më shoqëron, mikut tim Azem Shkreli. Ai ngre supet, por nuk dëshiron të flasë. Përreth ka turistë. Midis tyre mund të ketë spiunë të veshur si turistë. E njoh fare mirë këtë klimë ferri, por kam kujtuar se në Jugosllavinë komuniste, ka pakëz më shumë liri se në Shqipërinë komuniste.

"Për të tjerët, për popujt sllavë, po, por për ne shqiptarët, jo", më shpjegon sivëllau im, kur gjendemi vetëm në makinë. "Ne jemi të huaj këtu, më keq se të huaj. Në sofrën e tyre sllave ne jemi të tepërt".

Kurse bota e mendon ndryshe Jugosllavinë. Mozaik popujsh. Vend festivalesh për vëllazërimin e kulturave. Model për të tjerët.

"Kur isha i vogël" vazhdon sivëllau im. "ngaqë familja ishte e varfër, pasi dilja nga shkolla, im atë më çonte të kullosja një lopë. Shpesh mbetsha vetëm me lopën në ndonjë faqe kodrine të butë. Vështroja përreth: asnjëri. Atëherë mendoja se ishte koha të bëja një gjë të ndaluar, një gjë tepër të dënueshme, diçka që ia kalonte mëkatit. Ti qesh? Ke të drejtë të qeshësh, madje, e di ku të ka shkuar mendja. Po prit, më dëgjo gjer në fund.

Kureshtja ime rrallë herë ka qenë kaq e ndezur.

Ajo gjë e ndaluar, ai mëkat i dënueshëm ishte kthimi i kokës nga ai drejtim ku mendoja se ishin malet e Shqipërisë. Ti habitesh? Të duket me siguri një frikë e tepruar. Dhe në këtë rast ashtu është vërtet: një frikë e tepruar nga fantazia fëminore. Por, në thelb, ajo bazohej në një të vërtetë të madhe. Ishim aq shumë të tmerruar nga ato që kishim dëgjuar, nga vrasjet e fshehta, torturat, spiunët që gëlonin kudo, saqë mjaftonte që edhe kthimi i kokës nga drejtimi i tokës ku duhej të ishte vendi amë, do të përgjohej nga dikush, do të kallëzohej, do të shkaktonte tmerr.

Miku im fliste dhe unë nuk ia ndaja dot sytë fushës së gjerë që shtrihej gjer larg, e mbuluar në cepa nga mjegulla e tetorit.

Gjithë ai tmerr, për të cilin fliste poeti kosovar, kishte lidhje me atë fushë. Ajo e prodhonte atë tmerr vit pas viti, më shumë se grurin, më shumë se lulet. Ajo e përtërinte urrejtjen dhe etjen për gjak, thua se gjaku që kishte rrjedhur gjashtë shekuj më parë në të nuk qetësohej dot.

Ishte një fushë që, e futur gabimisht midis maleve, nuk e linte Ballkanin e madh të flinte i qetë.

Paris, mars 2000.

## DITA E 29 PRILLIT

*Revista franceze "Nouvelle Observateur" u kërkoi 100 shkrimtarëve të kohës, të shkruanin si e kanë kaluar ditën e 29 prillit 1994. Midis tyre ishin Gabriel Garcia Marquez, Vaclav Havel, Günter Grass, Umberto Ecco, Milan Kundera, Salman Rushdie, Jose Saramago, Norman Mailer, Vargas Llosa, Ocatvio Paz etj. Ky shkrim u bë me këtë rast.*

Ngaqë ka disa javë që ndodhem në Shqipëri, dita e 29 prillit, ashtu si gjithë ditët e tjera, për shkak të dendësisë së ngjarjeve, ngjan si e pazakonshme. Duket sikur, sipas teknologjisë së krijimit letrar, e kam pasuruar atë, ashtu siç pasurohet minerali: prej ngjarjeve të ditëve të tjera.

Në të vërtetë, s'ka kurrfarë pasurimi dhe jam i sigurt se në qoftë se miqtë e të njohurit e mi të Tiranës do t'u bjerë rasti t'i lexojnë këto shënime, do t'i gjejnë ato disi të kursyera.

Qysh se pjesën më të madhe të kohës e kaloj në Paris, sa herë që vij në Tiranë ditët janë, ashtu siç thashë më lart, të pazakonshme për nga dendësia. Secila prej

tyre ka brenda saj dy-tri ditë e, nganjëherë një javë të tërë. Më parë kjo më ndodhte kur nga Tirana vija në Paris, me ditën time pariziane. Tani ndodh e kundërta.

Pas mëngjesit, shkoj në dhomën time të punës për të përfunduar një tregim që po e shkruaj këtu. Është hera e parë që po provoj të punoj në Shqipëri, qysh nga viti 1990. Në udhëtimet e tjera s'kam patur asnjë mundësi të ulem për të shkruar. Këtë herë më duket se po e kapërcej të pamundurën. Miqtë e mi e dinë ç'bëj dhe nuk më shqetësojnë përpara mesditës. Të panjohurit, që, zakonisht, trokasin gjithë ditën te dera e apartamentit, i presin njerëzit e shtëpisë.

Tregimi quhet "Kisha e Shën Sofisë" dhe tregon për kthimin e ngrehinës së famshme të Konstantinopolit nga kishë në xhami. Mendoj se është një shqetësim universal i kohës sonë: strehimi i dy feve më të mëdha të botës në të njëjtën ndërtesë.

Tregimin ia kam premtuar gazetës letrare "Drita". Meqenëse sa herë që shkruaja diçka, gjëja e parë që më shkonte ndër mend përpara botimit ishte interpretimi që do t'i bënte shteti, domethënë zyrat e partisë komuniste dhe të policisë së fshehtë, ky refleks më ka mbetur ende. Por këtë herë kam arsye. Së paku, katër institucione në Tiranë mendoj se do të merren, ndoshta, me zbërthimin simbolik të tregimit: kryepeshkopata ortodokse shqiptare, kryesia e fesë myslimane dhe dy ambasadat: e Greqisë dhe e Turqisë, vende me të cilat ka lidhje kisha e famshme e Shën Sofisë. Të gjitha këto institucione do të përpiqen të gjejnë ndonjë mesazh në këtë tregim, ndonjë qëndrim të autorit lidhur me njërën fe në raport me tjetrën, ndonjë shenjë që shkon më larg, të qëndrimit të Shqipërisë ndaj Evropës, për shembull, ose të polemikave në parlament, lidhur me ekuilibrin e

të trija feve në Shqipëri (katolike, myslimane, ortodokse) ose që shkon edhe më larg, si te çështja e peshkopit grek Janullatos, që është sot kryepeshkopi i Shqipërisë, te marrëdhëniet e acaruara greko-turke, ose te konflikti në Bosnjë etj.

Jam i sigurt se sa më shumë të zhbirojnë aq më fort do të ngatërrohen, sepse, në qoftë se ka një gjë që unë s'e kam menduar fare, janë pikërisht këto dhe se ky tregim është letërsi dhe asgjë tjetër.

Jam i gëzuar që po e mbaroj tregimin, kjo më jep ndjesinë e një oguri të mirë. Në orën njëmbëdhjetë e gjysmë një miku im më propozon të shkojmë të pimë një kafe në breg të detit në Durrës, që është veç 30 km larg.

Nisemi së bashku me gratë. Ndërsa kalojmë përmes Tiranës, përpiqem të lexoj tabelat e kafeneve, të restoranteve e të diskotekave që sapo janë hapur. Emrat janë nga më të çuditshëm: Xhokonda, Shtrauss, Cafe de Paris. Emra pronarësh pa fund. Qyteti ndërron fytyrë çdo ditë. Makinat ecin në mënyrë disi të çrregullt. Lavdi Zotit, semaforët punojnë.

Ja dhe *embouteillage*! Për mua kjo është një kureshti e madhe. *Embouteillage* në Tiranë! Tingëllon gati e pabesueshme për vendin ku veturat private ishin praktikisht të ndaluara. Nuk ekziston as fjala për këtë dukuri. Të shohim si do të vendosë Akademia: shtupim, plumbosje, bllokim. Zgjat kryet për të parë: *embouteillage* i vërtetë, në të dy anët e rrugës, që zgjat rreth 100 metra.

Në Durrës shkojmë të pimë kafe në bregdet në zonën e ndaluar, ku pushonin udhëheqësit komunistë. Vilat janë aty, njëra pas tjetrës: dy vilat e diktatorit, vilat e anëtarëve të Byrosë Politike, banesat e rojeve.

Në hyrjet e një pjese të tyre janë tani tabela të shkruara në gjuhë të ndryshme: Oil Company, Banque Mondiale; ADA AIR. Megjithatë, njerëzit i quajnë vilat ende me emrat e ish udhëheqësve: vila e Palit. E Lenkës. E kryeministrit (ky ka dymbëdhjetë vjet që tretet në tokë, i vrarë në mënyrë misterioze). Nuk e di ç'ndodh në vendet e tjera të Lindjes, por, me sa duket, në Shqipëri, emrat e ish-udhëheqësve që janë shkukur nga historia, që kujtohen vetëm me urrejtje, së shumti me tallje, vazhdojnë të jetojnë vetëm të ngjitur pas vilave të pushimit. Analistët do ta shpjegojnë, ndoshta, një ditë këtë. Ndoshta, shkëputja nga vilat e pushimit ka qenë për shpirtrat e tyre vuajtja më e madhe.

Kur kthehemi në shtëpi, ajo, si zakonisht, është plot me njerëz. Njerëzit rrinë në dhomën e pritjes. Pinë kafe dhe bisedojnë si në kafene. Një pjesë janë miq e të njohur. Të tjerët të panjohur. Ka nga parti dhe rryma të ndryshme politike dhe, kuptohet, që shumica e bisedave ashtu janë: politike. Në përgjithësi njerëzit janë pasionantë, nervozë dhe shpesh fillojnë të grinden me njëri-tjetrin .

Në disa minuta marr vesh të reja e fundit: vazhdon acarimi me Greqinë, për shkak të një vrasjeje të shëmtuar afër kufirit. Pëshpërima të ndryshme lidhur me daljen në gjyq së shpejti të ish-presidentit Alia. Një aktore e Teatrit Kombëtar është kthyer e zhgënjyer nga jashtë shtetit dhe ka botuar një intervistë, që s'është pritur mirë nga ata që shpresojnë të gjejnë punë në Perëndim.

Drejtori i një gazete të pavarur, "Dita informacion", më pëshpërit se ka diçka për të njoftuar. Hiqemi pak mënjane dhe më thotë se ka një informacion se shërbimi i fshehtë grek dëshiron të vrasë peshkopin grek

Janullatos në Tiranë, për të shkaktuar luftë midis Shqipërisë dhe Greqisë. Nuk e besoj fare, ai ngul këmbë. Është i zbehtë në fytyrë nga kjo dhe mendon që nesër ta shpalli në gazetë. S'di ç't'i them. Ndërsa me vete mendoj se proverbi "ditë e re, fat i ri", tani është zëvendësuar me "Ditë e re, skandal i ri".

E shoqja e përkthyesit tim, Jusuf Vrionit, i telefonon time shoqeje për t'i thënë se për herë të parë pas tridhjetë vjetësh që janë martuar, Jusuf Vrioni, i shquar për elegancë dhe sqimë, nuk është rruar në mëngjes, për shkakun tim. Domethënë, kaq shumë është i ngarkuar me përkthimet që "Fayard" ia kërkon me ngut, sa që ka lënë pas dore edhe atë gjë që nuk e ka lënë as në kohën kur ndodhej në burg.

Mbasdite shkëputem një çast nga bujtësit për të shkuar në sheshin Skënderbej, sepse dua të shikoj me sytë e mi këmbimin e monedhës. Pranë "Bankës së Shtetit", banka të vogla private, madje individë, bëjnë operacione financiare të ngatërruara. Thyej 100 dollarë dhe bindem se inflacioni është vërtet zero. Gjatë gjithë kësaj furtune të pashembullt paraja shqiptare është mbrojtur mjaft mirë. Qysh nga viti 1970 e gjer më 1990, një dollar është këmbyer me 30 lekë. Sot këmbehet me 99 lekë. Pra, leku shqiptar është zhvlerësuar vetëm 3 herë. Praktikisht, ai është i konvertueshëm me çdo lloj monedhe perëndimore. Përveç anës financiare, kjo luan një rol psikologjik për krijimin e besimit.

Bisedojmë me miqtë se sa cinike është të shkuraresh njerëzit, t'u heqësh besimin dhe shpresën. Në qoftë se bota perëndimore do të vazhdojë të dëshpërojë popujt e tjerë, duke u thënë ditë e natë: mjerë ju, sa të varfër jeni, sa të prapambetur jeni, vendet tuaja s'do të rregullohen kurrë, atëherë, ajo s'mund të presë



veç një sulm të verbër prej këtyre popujve për të përfshirë gjithçka. Për fat të keq, mjaft gazetarë e kanë për zemër dëshpërimin e të tjerëve.

Rrugës për në shtëpi takoj përkthyesin e vjetër të Balzakut, Enver Fico. Kemi punuar të dy për shumë vjet së bashku në Lidhjen e Shkrimtarëve. Ka ruajtur zakonet e finesën e intelektualëve gjirokastritë. "Ç'qe kjo që ndodhi, more Ismail, më thotë. Kaq i keq na doli ky Enver Hoxha, adashi im?". "E pra", i përgjigjem. Ai tund kryet: "Ç'është e vërteta, ca shenja i kishte dhënë që atëherë kur kemi qenë bashkë në gjimnaz. Mbaj mend, më kërkoi për ta lexuar "Dashnori i Lady Chatterley" dhe nuk ma ktheu më".

Dita vazhdon kështu e ngjeshur si dhe ditët e tjera të javës. Në orën 20 shikoj lajmet, ngaqë, pas dyzetë vjetësh propagande komuniste ende kam etje për të dëgjuar në gjuhën e vendit tim lajme të formuluar ndryshe.

Në orën 20.15' troket te dera një i çmendur, i cili dëshëron të bisedojë me mua për çështjet e universit. Në orën 20.30' jemi të ftuar për darkë tek ambasadori gjerman. Në kohën që po nisemi më merr në telefon drejtori i gazetës "Dita informacion" për të më thënë se dyshimi lidhur me vrasjen e peshkopit greko-shqiptar është i vërtetë, madje, ai i ka çuar fjalë ndërkaq peshkopit, i cili qenka përgjigjur se nuk është hera e parë që dëgjon paralajmërime ogurzeza dhe se ai është gati të shkojë te Zoti, kur ai ta kërkojë... Them me vete: edhe kjo i duhet sot gadishullit ballkanik: vrasja e një peshkopi grek në tokën shqiptare.

Tiranë, 1994

## ZHVENDOSJET E POPUJVE

*Për revistën "Les exilés"*

Zhvendosja, qoftë ajo e njeriut të vetmuar, qoftë e grupeve të mëdha, e ka trazuar përherë mendjen njerëzore. Pas misterit të vdekjes, që ka qenë shqetësimi kryesor i njeriut, zhvendosja ka qenë në vëmendjen e tij afërsisht në të njëjtën shkallë si enigma e gjuhëve, e seksit ose e kalendarit (rrjedhës së kohës). Si për të gjitha këto, edhe për zhvendosjen, mendimet kanë qenë e vazhdojnë të jenë gjer në ditët tona nga më të kundërtat. Për të mos u zhytur në citime, mjafton të përmendim shpjegimin që i ka bërë Borgesi mitit të Kainit e të Abelit, si ndeshje midis nomadëve e sedentarëve (të ngulurve), pra, midis barbarisë dinamike dhe qytetërimit statik, dhe qëndrimin e kundërt të Marksit, i cili, ndryshe nga Borgesi, është përherë në anën e "dinamizmit revolucionar".

Si çdo trazim madhor, zhvendosja ka zënë një vend të ndjeshëm në dëshmitë më të bukura të kulturës njerëzore. Poemat homerike "Iliada" dhe "Odisea" s'janë, veçse kronika të dy zhvendosjeve. E para, një lëvizje popujsh, trupore, brutale drejt Lindjes (Iliada),

e dyta- një lëvizje vetmitare, fine, për më tepër. shpirtërore, drejt Perëndimit (Odisea).

Për të ndjekur më mirë problemin mund ta afronim kamerën në të njëjtin truall, ku kanë ndodhur tragjeditë e vjetra, dhe tek të njëjtët popuj, që, ndonëse sot quhen me emrin e ri "ballkanas", janë gjithmonë ata që kanë qenë qysh nga Iliria dhe Greqia e vjetër, shqiptarët dhe grekët. Baladat e tyre të vonshme për mërgimin ekonomik, ndonëse flasin për probleme të përditshme, janë po aq tragjike sa mitet e lashta.

Kam përmendur në një ese një baladë shqiptare të fundit të shekullit XIX, e cila refugjatit ekonomik shqiptar (ja, më në fund erdhëm te një term aq familjar i kohës sonë), ndonëse vjen nga Nju-Jorku i SHBA-së, i vesh pelerinën dhe fatin e Edipit mbret. Është prapë skema e vjetër: at, nënë, bir. Vrasje midis atit dhe të birit, për shkak të xhelozisë ndaj nënës. Veç, s'është i biri që vret të atin, por e kundërta, i ati të birin. Është refugjati ekonomik, që, i kthyer pas njëzet vjetësh, e merr të birin për dashnor të nënës së vet dhe e vret.

Por drama, ndonëse e afruar në kohën moderne mbetet po aq hijerëndë si në antikitet. Skenat e përshkuara nga gazeta e opozitës shqiptare "RD" në portin e Durrësit në pranverë të vitit 1991, kur refugjatët shqiptarë rrëmbyen anijet për të shkuar në Itali, janë rrëqethëse në dramacitetin e tyre.

Mërgimi tregon forcën apo dobësimin e një kombi?

Përgjigjja është tejet e vështirë, për të mos thënë e pamundur. Mendoj se i tregon të dyja, edhe forcën, edhe dobësinë. Është normale që një komb, me bërthamë të fortë, të rrezatojë fuqishëm. E në rrezatimin e një kombi hyn edhe lënda njerëzore, që ai herë pas here e shpërndan nëpër botë. Por, në qoftë se rrezatimi nis të

shterojë bërthamën e kombit, kjo tregon se kombi është dobësuar, po shkon drejt shuarjes së tij. Ndryshe nga rrezatimi, mërgimi i shëndetshëm, i cili, me gjallërinë e tij këndell edhe vendet ku shkon, mërgata e një kombi të dobësuar është e përvojtur, e përulur dhe atë nuk e pret veçse një fat i mjerë, një përsëritje, ndonse e pudrosur, e metekëve të dikurshëm.

Është me interes të bëhen paralele midis emigrimeve që ndodhen në disa vende të Lindjes në prag dhe gjatë përmbyesjes së diktaturave, me çvendosjet e mëparshme.

Shqipërisë, për shembull gjatë këtij mijëvjeçari i kanë ndodhur dy ikje tragjike. E para ka ndodhur në shekullin XV. E dyta në vitet 1990-1991. Të dyja në Itali, me anije. E para ka qenë shkaktuar nga pushtimi otoman, në prologun e tij. E dyta, nga diktatura komuniste, në epilogun e saj. Vala e parë përbëhej nga elita e vendit, nga senjorët, peshkopët, oficerët, që ikën bashkë me bagazhet, arkivat, madje me këmbanat e kishave që s'donin t'ua linin turqve. Të dytët ishin njerëz të thjeshtë, shumica të papunë, që ikën pa asgjë, disa herë vetëm me sandalet e tyre. Të parët u pritën si heronj të kohës, u dhanë toka, katunde ku të vendoseshin, i ftuan nëpër mesha e ceremonira. Të dytët i futën nëpër kazerma ushtarake dhe, për t'u mbrojtur nga shiu, u dhanë thasë plastike, nga ato që përdoren për kufomat në morg. Të parët do të ruanin mallin për atdheun e humbur, do të jetonin me dinjitet midis italianëve dhe do të merrnin pjesë në bëmat e në historinë e Italisë. Të dytët, ndonëse do të trajtoheshin me bujari nga popullsia vendase, shpesh do të shkaktonin zhgënjime të hidhura.

Nga kjo paralele del qartë se mërgata e parë

shqiptare ndodhi kur populli shqiptar ishte i fortë, dhe ajo mërgatë dëshmonte forcën dhe dinjitetin e tij. E dyta tregonte, përkundrazi lodhjen dhe rraskapitjen e tij pas gjysmë shekulli shtypjeje. |

Zhvendosjet e njerëzve që paralajmëruan tërmetin që do të rroposte komunizmin, s'janë veçse një prolog, në krahasim me lëvizjen në shkallë të gjerë të etnive, popujve e grupeve të popujve që mund të ndodhin në të ardhmen.

A ndodhemi në prag të një epoke zhvendosjesh të reja, a duhet të kemi frikë prej tyre?

Mendoj se po. Bota ndodhet përballë dallgëzimesh të mëdha dhe bota duhet të ketë frikë. Mendja jonë e mësuar me rutinën e gjërave, i përfytyron rreziqet në një formë statike. Por rreziqet gjithashtu, ndryshojnë. Ato, gjithashtu, dinë të maskohen mjaft mirë, gjersa vjen një ditë dhe të kapin në befasi.

Mërgatat, zhvendosjet e grupeve njerëzore duken një gjë banale, diçka që na kujton zyrat e kontrollit të pasaportave, doganat, debatet në shtyp. Por zhvendosjet e masave të mëdha njerëzore, në një mënyrë ose në një tjetër, kanë brenda tyre rrezikun, luftën.

Në të vërtetë, ato kanë qenë nëna e luftës. Zhvendosje popujsh, lëvizje e ngadaltë, gjysmë e ngadaltë, dyndje, lëvizje e shpejtë, marshim ushtarak, goditje e befasishme, të gjitha këto janë të një race, të asaj të luftës. Nga kjo pikëpamje L. Tolstoi kishte të drejtë kur i fuste në një thes.

Në historiografinë marksiste-leniniste të kampit socialist, dyndja sllave drejt Evropës Qendrore, Danubit e sidomos drejt Gadishullit Ballkanik përshkruhej në mënyrë idilike. Theksohej vazhdimisht

ana paqësore e saj, gruri që mbillnin, mollët, bashkëjetesa e tyre paqësore me popujt që gjetën në vend. Kjo i vinte fare mirë për shtat politikës së Stalinit e më pas të Brezhnjevrit për skllavërinë e këtyre popujve.

Mirëpo, monumentet e vjetra artistike tregonin tjetër pamje. Eposi mesjetar ballkanas, si ai i shqiptarëve, si ai i sllavëve të jugut dëshmonin të kundërtën. Ai epos ishte ngjethës. Në dhjetëra mijëra vargjet e tij tregohej se kjo dyndje, ndonëse kishte zgjatur me dhjetra vjet, ndonëse ishte një dyndje tipike popujsh ku kishte edhe gra, edhe fëmijë edhe grurë, edhe bagëti, ishte, në të vërtetë, një nga zhvendosjet më tragjike, e shoqëruar me masakra, mizori dhe përrenj gjaku të pafund.

Të gjitha zhvendosjet e popujve, qofshin ato të kryera me dhunë (etnocitet), ato që bëri Stalini në Bashkimin Sovjetik, ato që bëri Hitleri me çifutët, drama e armenëve, e kosovarëve, e hungarezëve ose e kurdëve etj., qofshin të nxitura në rrethana të tjera, në një shkallë ose në një tjetër, e kanë brenda tyre katastrofën.

Rreziku është sot më i afërt se kurrë. Sado paradoksale të duket, kjo periudhë e gjatë paqeje në një pjesë të botës e thekson edhe më tepër këtë rrezik të ri. Faktorë të ndryshëm janë të favorshëm për të. Një nga këta është, për shembull, TV.

Historia e njerëzimit na ka treguar se pushtimet ose zhvendosjet e popujve janë nxitur, së pari nga syri, nga pamja. Përpara se persët të sulmonin Greqinë, barbarët Romën ose mongolët Evropën, në kufijtë e vendeve që do të sulmoheshin janë vërtitur përherë endacakë të çuditshëm, dervishë me rrecka ose kalorës, që shfaqeshin si hije. Sot, grupet njerëzore, tek të cilat

lind ideja e zhvendosjes nuk kanë nevojë për zbulues të tillë. Në ekranin e TV-së, më mirë se nga kali i shpejtë, madje, më mirë se nga dylbitë, nomadi që jeton në shkretëtirë mund të shikojë fushat e bleruara, i urituri begatinë, i shtypuri lirinë. Për refugjatët shqiptarë për shembull, TV italian, pamjet e të cilit kapeshin lehtë në Shqipëri, luajti rolin kryesor në dyndjen e tyre. As pengesa natyrore, që ishte deti, as policia dhe rojat e të dyja vendeve nuk i penguan dot ata që në mënyrë të vrazhdtë, gati të dhunshme, të kryenin zhvendosjen.

Në kushtet e sotme, kufijtë e shteteve, ligjet dhe administratat janë pa dyshim një frenim serioz për një lëvizje kaotike. Por në qoftë se dëshira për zhvendosje do të rritet dhe, në qoftë se nuk do të jenë marrë masa për ndalimin e saj, bota mund të ndodhet përpara të papriturave.

Lufta e Gjirit Persik, që sapo mbaroi është quajtur njëzëri si më modernia e të gjitha luftërave. Megjithatë, si për të na kujtuar arketipin e luftërave më të hershme të botës, ajo pati brenda një motiv të stërlashtë: çvendosjen e një populli, të kurdëve.

Por, meqenëse, siç u tha më lart, ashtu si lufta ka brenda zhvendosjen, edhe zhvendosja mund të ketë luftën. Lufta e Tretë Botërore, që ne kemi kujtuar se e kemi shmangur, mund të shfaqet befas, në një formë të papritur. Shembja e diktaturave në shumë anë të botës, krahas energjive pozitive, mund të çlirojë energji të mbrapshta. Nga germadhat e këtyre diktaturave mund të dalin grupe të mëdha njerëzore të shfytyruara nga urrejtja dhe dëshpërimi. Bashkë me diktaturat mund të thyhen kombe të tëra, kështu që prej mbeturinave të këtyre kombeve mund të krijohen hordhi të pafundme

moderne të traumatizuara, të shkurajua dhe pa atdhe, domethënë pa kombësi.

Bota e nesërme, pjesët më të lulëzuara të saj ka rrezik të gjenden një ditë para trysnisë së këtyre hordhive.

Ashtu si në një lagje ose rrethinë qyteti, shkatërrimi i vatrave familjare do të mbushte rrugët me të rinj të braktisur, jetimë, rrugaçë të margjinalizuar, etj., etj., të njëjtën gjë por në përmasa kolosale do të shkaktonte shkatërrimi i kombeve në zona të ndryshme të botës.

Kur arkitektët e Evropës dhe të botës së nesërme vrasin mendjen për gjetjen e formulave të përshtatshme ekonomike, gjeopolitike, etnike etj., mendoj se një vëmendje të veçantë janë të detyruar t'i kushtojnë pengimit të këtij procesi të tmerrshëm.

Një botë me popuj të ngulitur shëndetshëm në trojet e veta, do të jetë shumë më e lirë, më e qëndrueshme dhe më harmonioze, se sa një Babiloni e re.

Ndër barrierat që mund të kërkohen për të penguar procesin e hordhizimit të njerëzimit, mendoj se janë kombet. Në këtë pikëpamje, nga forcimi i identiteteve kombëtare të popujve, më shumë se kokëçarje bota do të ketë përfitim. Bërthamat tërheqëse kombëtare, të çliruara pa dyshim nga demonët e shovinizmit, të racizmit e të urrejtjes, mund të jenë sot kështjellat më të sigurta për t'i mbajtur të ngulitur popujt në trojet e tyre. Dobësimi e sidomos zhdukja e këtyre qendrave tërheqëse do të ishin pak a shumë të ngjashëm me dobësimin e gravitacionit universal. Krejt drejtpeshimi i gjithësisë do të trandej.

Paris, maj 1991



## DARKA E BOTËS

*Parathënie e shkruar për librin "Krishtlindjet në botë". Një antologji e teksteve më të bukura të letërsisë botërore për kërsëndellat, botuar nga "L'Archipel" e Parisit, më 1994. Në këtë libër, ku janë përfaqësuar vendet kryesore të Evropës sipas rendit kronologjik të autorëve, Shqipëria, si vend i hershëm i krishtëritimit evropian, zë vendin e katërt. Vendin e parë e ka Bizanti, me Simeon Métaphraste (shek. X), të dytin Spanja me Lope de Vegën (1562-1635), të tretin Anglia, me Ben Jonhson (1572-1637), të katërtin Shqipëria, me Jul Varibobën (1724-1788), të pestin Gjermania, me Gottfried Bürger (1747-1794) e kështu me radhë Suedia, Italia, SHBA, Danimarka, Norvegjia, Rusia, Belgjika, Çekia, Kanadaja, Afrika e Jugut, Hungaria, Portugalia etj. Midis autorëve të tjerë të mëdhenj janë: Giacomo Leopardi, Charles Dickens, Fedor Dostojevski, Oscar Wilde, Anton Çehov, Fernando Pessoa, etj.*

Parë nga një pikëshikim planetar në rragimin njerëzor dallohen, ndër të tjera, dy prirje: ndarësja dhe bashkuesja. E njohim mirë të parën, e cila, për fat të

keq, është tepër e pranishme dhe shfaqet egërsisht në jetën tonë: kufijtë, muret, urrejtja racore, mosdurimi etnik, fanatizmi fetar, ideologjik, politik. Tjetra, bashkuesja, është gjithashtu e pranishme, por, si për çdo gjë që e ka dëshmimin të butë, harmonioz, pozitiv, për të, përveç që flitet më pak, flitet pa forcë, me përtesë, pa nerv.

Me dendësinë e informacionit në kohën tonë, me konkretësinë e imazheve, me saktësinë e pamëshirshme të shifrave, me shpeshtinë (ritmin) e ngjarjeve dhe mbytjen shpesh të tyre prej ngjarjeve, që duken më të mëdha ose më të bujshme, gjendemi përpara një copëtimi dhe fragmentarizimi të vlerave, të tillë që e bën gati të pamundur krijimin e vlerave të reja planetare, nga ato që kanë aftësinë ta bashkojnë familjen e madhe të njerëzimit. Në këto kushte, nuk është e rastit që i rikujtojmë e u rikthehemi atyre vlerave, që janë krijuar ndërkaq, ashtu siç bëhet në këtë libër kaq fisnik, ku kujtohet nga disa dhjetëra shkrimtarë të të gjithave vendeve diçka, në dukje e thjeshtë, si ajri që thithim, Nata e Krishtlindjeve.

Tradita e Krishtlindjeve, ajo shfaqje e thjeshtë teatrale me personazh kryesor plakun, që simbolizon mbarimin e vitit, është një nga aksionet bashkuese njerëzore me përmasa vërtet planetare. Në sferën tjetër, atë ndarëse, ose negative, nuk gjendet kurrsesi një barasvlerë me shtrirje kaq të gjerë, çka vërteton se në këtë botë, e mira gjithsesi, është më e fuqishme se ç'mendohet.

Shpesh mendoj se çfarë e ka bërë kaq gjithënjëzör këtë kremtim. Nuk mund të thuash se administratat kanë luajtur një rol të madh. Madje, shpesh ka ndodhur e kundërta. Është e vërtetë se kisha e krishterë e ka

ushqyer, por të tjera forca të rëndësishme kanë qenë krejt mospërfillëse për të, pa përmendur ato, që kanë qenë haptas armiqësore. Ndër këto të fundit, në shekullin XX u radhit ajo forcë e tmerrshme, e paparë ndonjëherë, që u përpoq të merrte në dorëzim tërë globin tokësor: komunizmi. Ai ishte haptas kundër Krishtlindjeve, u përpoq në fillim t'i zbehte, pastaj t'i shtrajtonte, e, së fundi, t'i ndalonte me dhunë. Por as ai, për të cilin rrënimi dhe ndalimi ishin gjërat më të thjeshta, nuk arriti t'i prishte dot. Ato nuk arritën të mbyten dot as në të vetmin vend komunist, ku jo vetëm feja u ndalua me dekret, por ku gjysma e popullsisë ishte e konvertuar në fenë myslimane. Më qartë se çdo gjë tjetër, kjo tregonte se tradita e Krishtlindjeve ushqehet nga rrënjë edhe më të thella e universale.

Si të gjitha traditat e mëdha të njerëzimit, ajo ishte traditë e pasuruar. Lindja e Krishtit ishte bërthama e saj, por rrotull kësaj bërthame u mbështollën enigma të tjera, nga ato që prej mijëvjeçarësh nuk e linin të qetë trurin njerëzor. Ndër to, ndër më kryesoret, ishte pa dyshim enigma e kohës dhe e rrjedhjes së saj. Është mbarimi i një viti dhe fillimi i një tjetri, çasti kur i vjetri dhe i riu gjenden përkohësisht bashkë, çasti i ndarjes së tyre, i fillimit të një viti të ri, i një kohe të re. Është nata ku bashkohet përpikëria e njerëzimit, (astronomia, matematika) me fantazinë e poetikën e tij.

Që në këtë dramë zotëron personazhi i plakut, pra, i vitit të vjetër, (père Noel), kurse viti i Ri, mezi ndihet, është e natyrshme për mendësinë njerëzore. Gjithë vëmendja e tij ka qenë përherë tek e shkuara. Gjithë poezitë epike, gjithë literatura kanë qenë për të shkuarën. Dhe Krishtlindjet janë pothuajse një tregim epik, një

rrëfim tek vatra, ku aedi është zëvendësuar nga një plak me mjekër të bardhë. Veç kësaj, ky plak vjen nga larg, nga horizonte të tjera. Pra, ai është i ndryshëm, sjell një mesazh, një shpresë, që është gjithashtu e ndryshme për çdo qenie njerëzore.

Lidhur me këtë, një kujtim i fëminisë, me kalimin e viteve, ka marrë në mendjen time një domethënie simbolike. Ishte koha e leximeve të para, kryesisht të çrregullta e pa kriter, siç mund të bëheshin në një qytet të vjetër shqiptar, nën regjimin komunist, në fund të viteve '40. Një shoku im, me të cilin gjurmonim andej-këtej për të gjetur libra, më tha se kishte parë te ungi i vet një libër të një autori që s'i kujtohej emri... që i ngjante plakut të Vitit të Ri, madje, mund të ishte vetë ai autori, plaku i Vitit të Ri. Ishte fjala për një libër të Leon Tolstoit, me fotografinë e tij tipike me mjekër, në kopertinën e prapme.

Qysh në atë kohë, sa herë që flitej për Tolstoin, në çastin e parë, në mendjen time ai shfaqej fillimisht si plaku i Vitit të Ri, për t'u bërë më pas Leon Tolstoi. Me kalimin e viteve, ky gënjim fëminor përherë e më pak po më ngjante si gënjim. Prapa gënjimit fshihej, megjithatë, një e vërtetë, që i shpëtonte logjikës, por që ishte më e fortë se ajo: plaku i Vitit të Ri mund të ishte autor romanesh, vjershash, dramash. Dhe ai kishte qenë vërtet, në mos autor i drejtpërdrejtë, nxitës i fantazisë krijuese të miliona njerëzve, në atë mënyrë siç ishte era dimërore në pullaz ose bora e sidomos Nata.

Pa natën është e vështirë të përfytyrohet lindja e poezisë epike. Fshatarët e gjithë botës, në stinën e dimrit, kur punonin më pak ose aspak, rrinin netëve më vonë

dhe mbrëmjet e gjata pranë zjarrit i mbushnin shpesh me rrëfime. Aty pranë zjarrit, në gjysmë terr, lënda e jetës përpunohej, tkurrej, bymehej, ndërronte trajtë, gjersa kthehej në brumë, prej të cilit mund të gatuhej një gojëdhënë ose një përrallë.

Krishtlindjet janë të lidhura me natën, me dimrin, atëherë kur truri njerëzor, i pasfilitur nga lodhja dhe vapa, ishte më i prirur për të thithur e për të rrezatuar fantazi.

Vlerat e përbotshme, të krijuara prej njerëzimit mbarë, duke u ndodhur shpesh në trajtë të natyrshme përpara syve tanë, gati-gati pjesë përbërëse e peizazhit, në shumë raste nuk çmohen. Duhet të ndodhi, për fat të keq, një humbje, për të mos thënë një katastrofë, që ato të rivlerësohen.

Poeti kinez Juan Çzhen në një vjershë të shkruar njëmijë e ca vjet më parë, ankohet për zbehjen e zakoneve të mira, të dikurshme. René Chateaubriand më 1802 bën të njëjtin ankim për vlerat tradicionale që po shkelen prej revolucionit frëng. Sergej Esenin, rus, më 1922 vajton humbjen e traditës fshatare në Rusi nën sulmin e hekurit. Është i pari poet, ndoshta, që u llahtaris nga steriliteti i komunizmit dhe nga zëvendësimi i festave fshatare kristiane me mbledhjet politike dhe mitingjet komuniste.

Kur kisha e krishterë përdori, ndër të tjera, legjendën e Prometheut dhe kultin e diellit, për të krijuar zotin e saj, Krishtin (ai lindi pikërisht kur nata nis t'i lëshojë minutat e para ditës), ajo nuk e mendonte dot se gati dy mijë vjet më pas, në një vend të krishterë, në një vend me mijëra kisha e kryqe, do të bëhej përpjekja

e parë për zëvendësimin e Krishtit nga një politikan dinak, me emrin Lenin. Nuk mund të thuhet se kjo përpjekje e parë u bë nga ndonjë bolshevik kokëgdhë ose e shtyrë nga servilizmi. Përkundrazi, ajo u bë nga poeti aristokrat simbolik Aleksandër Blllok, më 1921, në poemën "Të dymbëdhjetët", ku përshkruhen dymbëdhjetë revolucionarë rusë bolshevikë, që marshojnë kundër armikut të klasës dhe që krahasohen prej poetit me të dymbëdhjetë apostujt me në krye Krishtin, domethënë Leninin. Ishte një poemë e padetyrueshme, jashtë llogarive politike, pra tejet e rrezikshme. Lenini nuk e pranoi, me sa dukej krahasimin, jo aq për modesti, se sa për faktin se trurin e tij prej komunisti, e trembte për qasja me fantazitë e mëdha të njerëzimit. Nuk i trembej cilësimit si vrasës, përbindësh, xhelat (madje aty-këtu lë të kuptohet se i japin kënaqësi të tërthortë këto epitete "të armiqve të klasës"), kurse cilësimit si Krisht i tmerrohej. Veç kësaj, lavdërimi ishte thikë me dy presa, sepse vinte në kundërshtim me parimin bazë të komunizmit: egërsinë klasore. Për komunistët ishte fyerja më e madhe t'i quajë të mëshirshëm!

Komunistët, në perandorinë e tyre të pamatë, filluan luftën vendimtare për të përmbysur fenë. Ishin të lehtë rrënim i kishave e i manastireve, ndalimi i kremtimeve fetare, burgosja e priftërinjve ose hoxhallarëve. E vështirë ishte pjesa tjetër: zbehja e frymës fetare. E privuar nga kishat, ajo kishte disa kështjella të parrokshme ku strehohej. Një ndër to ishin Krishtlindjet. Në vendet ku quheshin "Krishtlindje", si në Shqipëri, mbrojtja ishte më e vështirë. Në vende të tjera, ku quheshin "Ringjallje" ose "Noel", ishte më lehtë. Afërsia e natës së Vitit të Ri ishte shansi kryesor për

Krishtlindjet. Nën mbulimin e festës së vitit, të krishterët e Lindjes, festonin shpesh Krishtlindjet. Por komunistët nuk mund t'i gaboje lehtë. Pikërisht shansin e Krishtlindjeve, Vitin e Ri, ata u rrekën ta kthenin kundër tyre. Ata u përpoqën ta thithnin festën fetare brenda festës kalendarike për ta mbytur më lehtë. Festimi i Vitit të Ri fillonte për shembull, disa net përpara. Ai bëhej nëpër restorante, mensa, salla gjimnastikore. Vallëzohej, mbaheshin fjalime nga shefat, bëheshin dekorime, u jepeshin shpërblime punonjësve të dalluar. Pra, "dhuratat e Noelit" i jepte shteti socialist.

Sipas stilit shkretues komunist, po zvetënohej fryma e festës. Figura e vitit Plak zbehej në dobi të figurës së Vitit të Ri, i cili paraqitej si një adoleshent 14-15 vjeçar me veshje sportive, i ngjashëm aq shumë me pionierët, që bëhen gati të hyjnë në rininë komuniste, ose me heronjtë pozitivë të romaneve të realizmit socialist.

Duke sjellë kujtime të tilla të trishta, në krye të një antologjie, ku është përmbledhur gjithçka e bukur që letërsia botërore ka krijuar për Krishtlindjet, autori i këtyre radhëve, jo pa një ndjenjë shqetësimi, ka menduar se mos ka folur shumë për një dramë, e cila ka qenë e huaj për një pjesë të botës e sidomos për shkrimtarët e paraqitur këtu. Megjithatë, drama është ende pranë, dhe ata që e kanë jetuar, ndodhen ende të zënë si në një kurth prej saj. Veç kësaj, në darkën e Krishtlindjes, kur qëllon që një i ftuar mbërrin më vonë se të tjerët, një i ftuar që sapo ka shpëtuar nga një llahtarë dhe prandaj mbërrin më vonë se të tjerët, a nuk ka të drejtë të tregojë diçka për greminën që porsa kapërceu?

22 gusht 1994

## DON KISHOTI NË BALLKAN

*Konferencë e mbajtur në Bibliotekën Kombëtare të Spanjës në vitin 1994. Meqenëse konferenca është improvizuar nga autori në gjuhën frënge, përkthimi spanjisht i botuar nga shtypi i Madridit mund të merret si i vetmi tekst i shkruar i saj.*

Në një konferencë që u bë më pas e famshme, në vitin 1939, në Nju Jork, Thomas Mann-i, duke folur për një grindje midis poetit të madh pers Firdusiut, autorit të Librit të Mbretërve (Shah-name) dhe Shahut - punë honorarësh, pasi Shahu i kishte premtuar një sasi floriri për poemën e vet dhe pastaj ia kishte mohuar, - thoshte se gjëra të përmasave të tilla mund t'u bëjnë vaki vetëm poetëve të mëdhenj epikë.

Ne të gjithë i dimë - i kemi mësuar që në shkollë, - grindjet midis studiuesve grekë për vendlindjen e Homerit. Është i njohur diskutimi nëse qe Shekspiri vetë ai që i shkroi veprat e tij apo qe Baconi. Një gjë pak a shumë e ngjashme ka ndodhur me Cervantes-in në një vend të Ballkanit, të cilin ndoshta nuk e njihni. Diskutohet se ku qe burgosur Cervantes, në Algjeri apo



atje në Ballkan. Me sa duket, kjo puna e burgimit të shkrimtarëve vazhdon t'u ngjallë shumë kureshti popujve sot, dhe mendoj se është domethënës fakti që edhe pas kaq shumë vitesh në gadishullin ballkanik, flitet ende për burgimin e Cervantesit, madje dhe pa ia ditur saktë emrin shkrimtarit.

Një folklorist shqiptar, duke folur për legjenda dhe kronika të vjetra mesjetare, përshkroi, përpara pak kohësh në shtyp, disa histori për Cervantes-in, që kishin kaluar nga goja në gojë duke hedhur tezën se ka mundësi që Cervantesi nuk ka qenë i burgosur në Algjeri, por në një qytet midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ky studiues e bazon tezën e tij në rrëfenja pleqsh, të cilët përqendrohen në faktin se robi ishte një spanjoll shumë i ditur, për të cilin u pagua një sasi e madhe parash që ta lironin nga burgu. Emri i tij del, ka raste, Cervantes, ka raste Servet apo Sarvet. Dhe të gjitha rrëfenjat përkujtojnë në një pikë, që ky rob, ky i burgosur, kishte miq në Spanjë dhe ata, që nga larg, donin ta lironin me çdo kusht. Studiuesi pohon se ka fort të ngjarë që Cervantesi të ketë qenë rob në Ballkan, sepse bregdeti ballkanas është shumë i thyer dhe plot me guva e shpella të përshtatshme për piratët. Sidoqoftë, edhe në mos qoftë e vërtetë historia, është tepër emocionues për një shkrimtar fakti, që pleqtë e Ballkanit, që janë analfabetë, të ruajnë në kujtesë fatin dhe jetën e këtij njeriu. S'duhet harruar që këta pleq mbajnë shumë drama në kujtesën e tyre dhe, në kohën që lindën këto rrëfenja, Cervantesi nuk ishte botuar në Ballkan. Mendoj se është domethënëse që njerëz injorantë të mbajnë në kujtesë një shkrimtar, ndonëse kjo ndodh fort rrallë.

Njerëzimi ka një ndjeshmëri shumë të veçantë për

të zgjedhur se ç'njerëz do të përdorë për krijimet e tij, me çfarë njerëzish do t'i mbrujë legjendat e veta. Sado e çuditshme që të duket, lidhja midis Cervantesit dhe pleqve të Ballkanit ka një logjikë të brendshme. Një logjikë e brendshme e prek këtë lidhje dhe e pohon atë.

Kjo, nga ana e saj, ka të bëjë me temën që do të trajtoj më tej, me faktin që udhëtimi i Don Kishotit nuk është një udhëtim hapësinor, por bën pjesë në udhëtimin e brendshëm të njerëzimit. Udhëtimi i Don Kishotit ndodh në kohën e udhëtimeve të mëdha, siç është udhëtimi më i famshëm dhe më me bujë i historisë së njerëzimit: zbulimi i Amerikës. Nuk mund të ketë, është e pamundur që në histori të ketë një zbulim më të madh se ky.

Bota, toka, globi tokësor u dyfishua. Por ka ndodhur diçka e habitshme: ky zbulim kaq i madh nuk la pothuajse gjurmë në letërsinë botërore. Domethënë, nuk i pasuroi faqet e saj. E, megjithatë, udhëtimi i një marroku nga një fshat i Spanjës në një fshat tjetër të Spanjës, një udhëtim që nuk kishte pikë rëndësie për njerëzimin, që nuk i ka sjellë atij asgjë dhe që, ndoshta, as që ka ndodhur fare, i jep njerëzimit një nga kryeveprat më të mëdha letrare. A është kjo një kundërshti apo është në logjikën e gjërave? Unë besoj se nuk është kundërshti. Gjithmonë, kur kanë ndodhur zbulime në botë, zbulime të mëdha, është shtruar ideja se këto zbulime do ta transformonin letërsinë. Të fundit janë udhëtimet, zbulimet kozmike dhe sidomos fakti që njeriu ka shkelur në Hënë. Për shumë njerëz poezia po merrte fund në botë, sepse Hëna, një nga frymëzueset e poezisë, tashmë humbte misterin, meqë po shkelej nga njeriu. Ne e dimë se kjo nuk ndodhi. E, megjithatë, me

kalimin e kohës, kanë kaluar tashmë shumë vjet, udhëtimi i brendshëm i Don Kishotit i takon këtij kalendari të fshehtë. Prandaj ka ndikuar në letërsinë botërore më tepër se shpikja e lokomotivës, më tepër se zbulimet e Kristofor Kolombit, më tepër se anijet kozmike. Ndonëse duhet thënë se ky personazh i madh i historisë së njerëzimit nuk ka bërë shpesh inkursione të gjalla në jetën njerëzore. Jeta e këtij personazhi është e dyfishtë: ai bën pjesë njëkohësisht në trazimin e brendshëm të njerëzimit, por edhe në jetën e jashtme të tij. Më pas do të mundohem të shpjegoj se përse duke dalë në botën e jashtme, kjo figurë është e dëmtuar jashtëzakonisht. Përpara kësaj, do të hap një parantezë në lidhje me përkthimin e Don Kishotit në një vend të Ballkanit, në vendin tim, në Shqipëri. Është një fakt tipik që ky personazh hyn i gjallë në histori. Don Kishoti u përkthye në shqip nga peshkopi i Shqipërisë. Ky peshkop ishte në luftë me mbretin e ardhshëm të Shqipërisë. Peshkopi përpiqej ta përmbyste monarkun. Për t'u dhënë guxim njerëzve, e në radhë të parë vetes, në fillim përktheu Hamletin dhe Makbethin dhe arriti vërtet ta përmbyste mbretin. Më pas, mbreti e rrëzoi përsëri peshkopin dhe u përmbys situata, dhe ndërsa peshkopi ishte i ngujuar dhe tejet i trishtuar, iu vu përkthimit të Don Kishotit. Në parathënien me të cilën peshkopi shoqëron librin, thoshte se Don Kishoti do të kuptohet në Ballkan më mirë se në çdo vend tjetër. Ai gjeti një lidhje midis marrëdhënieve të Spanjës me hapësirat amerikane dhe lidhjeve të njerëzve të Ballkanit me perandorinë otomane, vetëm se këtu fati është i përkundërt. Ndërsa Spanja pushtoi hapësirat e mëdha amerikane, popujt e Ballkanit u pushtuan nga

një tjetër forcë, që vinte nga hapësirat e mëdha. Është njëlloj sikur Spanja të pushtohej nga indianët e Amerikës. E, megjithatë, ndodhi pak a shumë e njëjta gjë: Perandoria Otomane, që ishte jashtëzakonisht e madhe, krijoi marrëdhënie aventureske me popujt e Ballkanit. Ajo kishte qindra mijëra ushtarë të një niveli të lartë, ushtarë të bindur, tepër të bindur, porse i mungonin oficerët. Kishte nevojë për çmendurinë ballkanase. Në këtë mënyrë shpjegohet që ushtria otomane e krijoi elitën e saj ushtarake kryesisht me oficerë ballkanas, sidomos shqiptarë. Kur u shpërbë kjo perandori, të gjithë këta oficerë dhe mercenarë mbetën pa punë. Dhe këtu e gjen paralelizmin peshkopi midis këtyre njerëzve dhe Don Kishotit e Sanço Panços, që nuk kanë shkuar në Amerikë, por bredhin poshtë e përpjetë dhe fillojnë të ëndërrojnë kthimin e së kaluarës. Peshkopi shqiptar thotë se të gjitha vendet e Ballkanit në shekullin XX janë të mbushur me Don Kishotë, por ne po shohim se hija e tij vazhdon të shfaqet edhe sot në gadishull. Figura e Don Kishotit vazhdon të përdoret shumë shpesh tani midis partive politike. Nuk ka forcë politike që të mos ketë akuzuar kundërshtarin e vet si "Don Kishot". Komunistët, për shtatëdhjetë vjet me radhë i kanë akuzuar liderët perëndimorë si Don Kishotë. Këta të fundit kanë bërë të njëjtën gjë duke akuzuar stalinistët si Don Kishotë. E kështu me radhë, historia vazhdon. Ka disa javë, dëgjova në fushatën elektorale presidenciale në Francë që njëfarë Philippe de Villier, përpara kamerave, e konsideruan si një Don Kishot. Dhe siç e shikoni, Don Kishoti del i humbur në të gjitha rastet, sepse në të gjitha rastet politikanët që ia përdorin emrin janë nën nivelin e tij dhe nuk kanë

një grimë nga fisnikëria e tij.

Kjo është një karakteristikë mijëvjeçare e njerëzimit. Besoj se dy personazhe të letërsisë dhe të botës, Prometeu dhe Don Kishoti, kanë patur një fat të përbashkët, janë korrigjuar, kanë ndryshuar, janë reformuar nga njerëzimi. Në pamje të parë, duket një nder i madh që i gjithë njerëzimi merr pjesë në ribërjen e një personazhi, porse ky ndryshim, ky korrigjim mund të jetë për mirë ose për keq. Në rastin e Prometeut, personazhi ka fituar dhe në rastin e Don Kishotit ka humbur. Por në të dyja rastet është diçka e jashtëzakonshme që njerëzimi bëhet bashkautor me shkrimtarët. Do të mundohem ta shpjegoj këtë më thjesht. Le të marrim Prometeun: Prometeu nuk u krijua as nga legjenda dhe as nga Eskili në kohë të tij, ashtu siç e njohim ne sot. Prometeu u pasurua nga i gjithë njerëzimi. Ai ka qenë një personazh shumë më i koklavitur se ai që njohim tani. Prometeu arriti të merrej vesh me Zeusin, ndërsa pjesa më e madhe e njerëzimit këtë fakt nuk e njeh, domethënë nuk e rinjeh, e ka shmangur, i ka bërë një korrigjim personazhit. Me një fjalë, e ka bërë më heroik Prometeun. Me Don Kishotin, siç thamë më lart, ndodh e kundërta, i humbet fisnikëria duke krahasuar me personazhet mediokër. Schiller-i thoshte se e përfytyronte korin e tragjedive antike si një mur mbrojtës, si një lëdh që e mbron artin nga ndërhyrja e njerëzve, që nuk duhet ta prekin atë. Sipas tij, pjesëmarrja e spektatorëve grekë në teatër do ta kishte shkatërruar atë. Natyrisht, është populli ai që mban të gjallë artin, por tjetër gjë është ta mbash të gjallë artin dhe tjetër gjë është të ndërhysh për ta rregulluar, për ta korrigjuar, për ta riformuar. Sidoqoftë, ekzistojnë

personazhe të mëdhenj, tek të cilët njerëzimi ka ndërhyrë për t'i ndryshuar pikërisht për hir të popullaritetit të tyre. Nga ana tjetër, ka vepra të mëdha, si Makbethi i Shekspirit; megjithatë, Makbethi asnjëherë nuk është kthyer në një figurë popullore në botë. Çuditërisht kjo ka ndodhur me të shoqen e tij, Ledin Makbeth, e cila vitet e fundit është përdorur si figurë krahasuese për disa nga gratë e udhëheqësve komunistë, sidomos për Chiang Chingun, vejushën e Mao Ce Dunit, dhe, Elena Çausheskun.

Kjo tregon se mund të ketë vepra të mëdha të njerëzimit, si Makbethi, Fausti, Vëllezërit Karamazov etj., personazhet e të cilave i përkasin vetëm gjithësisë së artit. Të tjerë personazhe, si Prometeu apo Don Kishoti, dalin në këtë botë dhe pikërisht për shkak të kësaj daljeje vendosen përpara një prove shumë të vështirë. Besoj se Don Kishoti vazhdon të jetë edhe sot një personazh i pashpjeguar. Është e nevojshme të bëhet një përpjekje, një përpjekje e madhe nga të gjithë, për t'ia vënë nderin në vend, për ta ngritur sërish në vendin që i takon. Nuk mund të lejohet që Don Kishoti të përdoret në diskutimet politike. Historia e vërtetë e botës, ajo që i intereson letërsisë dhe së cilës i përket Don Kishoti është, siç e thamë më lart, historia e brendshme e saj. Kalimi nga një botë tek tjetra, me fjalë të tjera, dalja në klimën e egër të botës ku ne jetojmë, siç është rasti i Don Kishotit, mund të ketë rrjedhoja dramatike.

Përktheu nga spanjishtja  
Mira Meksi

## UNAZA NË KTHETRAT E SHKABËS

*Shkruar për Këshillin e Evropës*

Është e qartë për gjithkënd se stabiliteti në gadishullin ballkanik varet nga dy faktorë kryesorë: e para, nga vetë popujt e Ballkanit, e dyta, nga Evropa (më saktë Evropa atlantike). As mendësia marksiste që ekzaltonte vetëm rolin e popujve në zgjidhjen e fatit të tyre, as mendësia kolonialiste, që bënë të kundërtën, nuk funksionojnë sot, sidomos në Ballkan. Ky gadishull, së shumti, mund të konsiderohet pjesë e shtëpisë evropiane, më së paku, oborri i kësaj shtëpie. Edhe në rastin e fundit, pra edhe si oborr, ai duhet marrë seriozisht, ashtu siç merren seriozisht qetësia e rregulli i oborrit, në qoftë se shtëpia e kërkon për vete atë.

Kur fati i diçkaje varet nga dy palë, mirëkuptimi ose moskuptimi i të dyja palëve kthehet në faktor bazë për ecjen e gjërave. Është bërë zakon të thuhet se Ballkani nuk kuptohet nga Evropa. E thonë këtë evropianët, por e thonë sidomos vetë ballkanasit. Në këtë pohim të këtyre të fundit ka një fije dëshpërimi, por më shumë se dëshpërim ka koketëri, trill, madje, mendjemadhësi të fshehur. (Ne jemi të çuditshëm,

enigmatikë, askush s'na e merr vesh dot kokën).

Në të vërtetë, planeti ynë është dhe s'ka si të jetë veçse një pazar moskuptimesh midis zonave të ndryshme, grumbujve të popujve e shpesh midis popujve fqinjë. Kërkesa për një mirëkuptim total është një kërkesë naive, në atë masë që vajtimi për një moskuptim total është i tepruar.

Mospërputhjet e orarit midis Evropës dhe Ballkanit nuk kanë në bazë kurrfarë enigme apo fataliteti. Ato janë rrjedhojë e një fakti të thjeshtë e tragjik: kjo gjymtyrë e Evropës iu shkëput asaj për një periudhë pesëqindvjeçare. Përpjekja e gadishullit për kthim te kontinenti mëmë nuk mund të ishte pa dramacitet. Te popujt ballkanas e kaukazianë tregojnë legjendën e shqiponjës të zënë rob, e cila arrin t'i shpëtojë robërisë e të kthehet prapë te familja e saj. Mirëpo robëruesi i ka vënë shqiponjës një unazë në kthetra. Është kjo shenjë që e bën shpendin e arratisur të huaj për racën e vet. Familja nuk e pranon më shpendin e kthyer.

Popujt ballkanas qëndrojnë përpara portave të Evropës pa mundur ta fshehin dot shenjën që u ka lënë në trup e në ndërgjegje perandoria otomane. Ata kanë nostalgji për Evropën, por bashkë me nostalgjinë ndiejnë nervozizëm e zemërim. Nervozizëm për fajet e tyre, që s'duan t'i pranojnë, zemërim për harresën e gjatë të nënës kontinentale: Evropës.

Evropa, gjithashtu, për një kohë të gjatë i është shmangur përgjegjësisë së saj. Një vargor moskuptimesh kanë shoqëruar marrëdhëniet me gadishullin në shekullin XX. Popujt e Ballkanit nuk janë tribu që grinden për gjëra pa kuptim, siç kanë menduar për një kohë të gjatë shumë zyrtarë evropianë. E, natyrisht, grindjet e tyre



nuk e kanë patur atë kuptim të lartë e heroik, siç kanë dashur t'i jepnin vetë ballkanasit. E vërteta qëndron midis të dyjave.

Në këtë pikë jemi të detyruar të shikojmë qoftë edhe fare shkurt atë periudhë 500-vjeçare, kur popujt e Ballkanit nga njëra anë dhe Perandoria Otomane nga ana tjetër sajuan bashkarisht një nga mashtrimet më të mëdha historike të historisë së vonshme të njerëzimit.

Kohët e fundit është bërë zakon të shfaqet një farë përçmimi, njëfarë ndjenje ngopjeje, madje një farë tmërri sapo përmendet historia e ballkanasve. Mendoj se ky është një nga keqkuptimet e rënda të gjërave. Është pak a shumë e njëjta gjë sikur neveria për një krim, në vend që të na shtyjë ta hapim për ta shqyrtuar dosjen e krimin, të bëjë të kundërtën: të na shtyjë ta mbyllim. Historia e rreme e ballkanasve është një nga mjegullat që nuk lejon njohjen e tyre, rrjedhimisht ndihmon kaosin ballkanik. Kjo mjegull historie ka qenë aleatja më e mirë e kastave shoviniste ballkanike, e nacionalizmave të egra, e doktrinave monstruoze, për të mos pranuar, për të shtypur, për të gjymtuar, mundësisht për të zhdukur "tjetrin". Shpërndarja e kësaj mjegulle do t'i linte këto kasta kriminale pa veshje maskimi, pa psikoza ndihmëse dhe pa alibi.

Pa u zgjatur në këtë çështje, mund të thuhet shkurtimisht se otomanët, nga njëra anë, dhe ballkanasit nga ana tjetër, krijuan dy motërzime të historisë, të dyja të kundërta e fare pak të besueshme. As versioni otoman, sipas të cilit, perandoria i zbuti dhe i kultivoi ballkanasit kokëfortë, e as versioni i këtyre të fundit, sipas të cilit ata paraqiten si popuj martirë, që veç vringëllonin shpatat kundër pushtuesit, nuk i qëndrojnë të vërtetës.

Një version i tretë na e jep atë çka ndodhur. Është e vërtetë se popujt e Ballkanit i bënë qëndresë perandorisë, por po aq e vërtetë është se ata u bënë pjesë e perandorisë, pra pjestarë në trofetë, në bëmat dhe në krimet e saj.<sup>4</sup>Perandoria Otomane, një nga strukturat ushtarako-shtetërore nga më të plotat që ka njohur historia, nuk mund të kuptohet pa popujt e Ballkanit dhe të Kaukazit. Ata, më shumë ndoshta se vetë turqit, me të cilët gabimisht identifikohet shpesh kjo perandori, ushqyen me energji e vunë në lëvizje mekanizmat e këtij shteti kolosal.

Në shekujt XIX e XX, kur popujt e Ballkanit njëri pas tjetrit po shkëputeshin nga perandoria, kur erdhi, pra, ora e kujtimeve, secili nga këta popuj nisi të harronte atë pjesë të historisë që quhej "e turpshme", domethënë bashkëpunimin, dhe të kujtonte veç pjesën "heroike", atë të rebelimeve. Një mal spekulimesh u krijua me këtë rast. Për kastat shoviniste ballkanase ishte shumë e lehtë krijimi i psikozave për të monopolizuar "heroizmin ballkanas" e për t'u lënë kundërshtarëve të tyre "turpin ballkanas".

Mashtrimi historik u bë kështu bazë e gjithë nacionalizmave në Ballkan. Fshehja e së vërtetës, e nisur në fillim si një dredhi e lejueshme lufte në emër të mbrojtjes së interesave të kombit, me kalimin e kohës u kthye në psikozë të rëndë kundër të tjerëve. Sa më tepër që kalonin vitet, psikoza nacionaliste, të ngurtësuarra nëpërmjet shkollës dhe edukimit, nga brezi në brez u bënë më të helmuara. U harrua zanafilla e tyre si dredhi lufte ose dredhi e tregut (dredhi e lejueshme, për të fituar ca fusha ose ca kullota më shumë) dhe ato u zëvendësuan nga një bindje dhe një

vethipnotizim, se popujt e tjerë nuk duhej të kishin të drejta normale. Nga kjo, tek ideja e krimit kundër të tjerëve, tek ideja e mbrapshtë për të shpërngulur, djegur e masakruar të tjerët, nuk kishte veçse një hap. Për fatin e tyre të keq dhe për turpin e tyre, një pjesë e ballkanasve e kapërcyen atë kufi. Idetë nacionaliste, të mbështetura tani nga administratat, policitë, akademitë, pollën doktrina të egra e çnjerëzore, që mund të krahasoheshin me modelet më të këqija që kishte pjellë njerëzimi. Në këtë pikë duhet patur kurajua për të pranuar se ballkanasit, ata që ankoheshin me të drejtë se kishin qenë për pesë shekuj viktimat te një perandorie të errët e të prapambetur, u bënë ata vetë më të errët e më të prapambetur se kjo perandori (kontradiktë!)

Kur Evropa atlantike vendosi të ndërhyjë në Kosovë për të ndaluar krimin shtetëror, në atë që quhet "elitë kulturore", pati zëra që e kundërshtuan ndërhyrjen. Zakonisht, ka qenë kultura ajo që i kritikonte shtetet kur hezitonin të ndërhynin për arsye morale. Ishte, me sa duket, hera e parë në historinë e Evropës e të njerëzimit që 19 kancelaritë e shteteve evropiane kryen në mënyrë unanime një aksion ushtarak, në emër të mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Mëdyshja e njerëzve të kulturës përballë këtij unanimiteti të kancelarive jep përshtypjen sikur kanë ndërruar vendet: kancelaritë kanë zënë vendin e kulturës dhe kultura atë të kancelarive.

Konflikti ballkanik, ashtu siç nxiti nga njëra anë, një veprim të tipit të ri, që i bën nder Evropës, ashtu nga ana tjetër, zbuloi njolla të errëta në zgafellat e ndërgjegjes së saj. Çrënjësja e krimit, si veprim dhe si ide bëhet kështu edhe më e ngutshme, qoftë në

gadishullin ballkanik që e nxori krimin në dritë, qoftë në hapësirën europiane që mbante të fshehtë në qilaret e saj.

Nga ky pikëshikim mund të thuhet se evropianët, duke qenë të pranishëm në dramën e sotme ballkanase, krahas vendosjes së rendit në Ballkan, kanë rastin që, ashtu siç thoshte Aristoteli për spektatorët e moçëm të theatrit antik, të "spastrojnë veten nëpërmjet mëshirës dhe frikës".

## 2

Roli aktiv i bashkësisë ndërkombëtare në Ballkan është jo vetëm i domosdoshëm, por edhe e vetmja zgjidhje e mundshme për shmangien e një tragjedie vrasëse e vetëvrasëse me përmasa kolosale.

Sot për sot, një pjesë e ballkanasve nuk janë të aftë të zgjidhin disa nga çështjet e tyre themelore. Gabimet dhe fajet e tyre, jo vetëm nuk i lënë të zhvillohen këto vende normalisht, por i çojnë pashmangësisht drejt një konflikti të armatosur. Ndaj "evropianizimi i Ballkanit" ndonëse tingëllon si një formulë iluministe, e kapërcen dukshëm atë dhe kthehet në faktor vendimtar për vendosjen e paqes në gadishull dhe në Evropë.

Ky "evropianizim" s'mund të kryhet pa veprime që disa herë mund të ngjajnë arbitrare, madje brutale, siç ka qenë ndërhyrja e armatosur në Bosnjë dhe në Kosovë.

Ajo elitë politike e kulturore ballkanase, që afishohet tepër e fyer në ndjenjat e saj kombëtare nga ndërhyrja arbitrare evropiane, me atë kinse fyerje nuk fsheh veçse natyrën e saj perverse dhe dëshirën për destabilizim të përhershëm në gadishull. Destabilizimi

u volit strukturave mafioze e shoviniste. në shërbim të të cilave elita ballkanase ka kohë që është vënë me shumë zell. Prandaj, i parë nga ky këndvështrim. "patriotizmi ndërballkanik" e meriton në këtë rast maksimën amerikane që e cilëson si "streha e fundit ku kërkon të fshihet çdo horr".

Ballkanasit, ndërsa nuk e meritojnë përbuzjen evropiane, meritojnë ndërkaq arbitrazhin evropian.

Nga ana evropiane mbrojtësit e doktrinës së mosndërhurjes, përherë e më me vështirësi e mbulojnë përcmimin e vjetër kolonialist. Duke treguar një nderim të tepruar për qeveritë e këtyre shteteve, ata dëshmojnë në të vërtetë përbuzjen për fatin e popujve që jetojnë nën këto qeveri.

Duke njohur tërë vështirësitë që lejon mundësia e ndryshimit të kufijve në kohën e tanishme, duke pritur, në qoftë se është e domosdoshme, kohë më të qeta e më të emancipuara, për aplikimin e parimit të madh të vetvendosjes së popujve, Evropa nuk duhet gjithsesi, në mënyrë arrogante të përpiqet të varrosë këtë ide shpëtuese. Ajo është e vetmja ide ndërtuese, që na lejon të shohim dritën e daljes nga tuneli. Mbyllja e kësaj drite është baraz me provokacionin më të rëndë që mund t'i bëhet një populli: dekretin për heqjen e të drejtës së lirisë. Asnjë popull në botë nuk mund ta pranojë këtë, e aq më pak një popull në Evropë.

Pranimi i idesë së lirisë vetëvendosëse, përgatitja me durim e mençuri e saj, do të jenë një lehtësim i madh në ndërgjegjen e popujve të Ballkanit. Pa këtë lehtësim janë të pamundura hapat drejt uljes së tensionit e drejt paqes.

Një ide e tillë kërkon pa dyshim luftën pa mëshirë

të çdo lloj nacionalizmi. Për fat të keq, dalja e popujve të Ballkanit prej tutelës së dy perandorive: otomane dhe habsburgase pati si shoqërues, frymëzues dhe si çimentim të unitetit kombëtar pikërisht nacionalizmin. Shpesh herë ai u përzie e u bë njësh me patriotizmin, me idealizmin heroik, madje me idenë e emancipimit shoqëror. Ai u fut kaq thellë në kulturën politike e në krejt kulturën ballkanase sa që sot, për ta shkukur është e domosdoshme të gërryhen thellë shtresimet e tij që kanë zënë vend njëra sipër tjetrës, ashtu si suvatë e mureve të vjetër. E keqja është se kjo gërryerje në qoftë se bëhet jo në vendet e duhura, domethënë jo atje ku ajo ekziston vërtet, mund të prekë ngrehën e një kombi, duke rrezikuar shembje të tjera, pas të cilave mund të kemi katastrofa që nuk i sjellin asgjë të mirë, as paqes, as stabilitetit në Ballkan.

Rreziku i luftës kundër nacionalizmit në mënyrë globale, sipas klisheve që aplikohen verbazi, pa shqyrtuar karakteristikat dhe rrethanat e çdo vendi, mund të çojë në përfundime të kundërta me qëllimin e këtij aksioni. Për ta ilustruar këtë me një shembull të thjeshtë, le të kujtojmë ngjarjet e vitit 1997 në Shqipëri, kur ndërtesa e shtetit shqiptar u shemb. Ndërsa shoqëria dhe gjithë institucionet shtetërore po tronditeshin si pasojë e zhgënjimit postkomunist, në kohën që humbja e shpresës e dëshpërimi e kapluan tërë popullin shqiptar, duke e shtyrë drejt rrënimin të çdo vlere morale, një propagandë e verbër, brenda dhe jashtë Shqipërisë, në vend ta shuante i hidhte benzinë zjarrit të rrënimin. Shqiptarët akuzoheshin për nacionalizëm dhe glorifikim të vlerave kombëtare, në kohën që ata, të sëmurë kolektivisht prej një kozmopolitizmi agresiv,

pikërisht këto vlera po i shkelnin me këmbë në mënyrën më barbare. Ata ishin në gjendjen e një të sëmuri që po kurohej në mënyrë të mbrapshtë me barna të kundërrindikuara. Ky keqkuptim tragjik përfundoi me shembjen e vetë shtetit shqiptar, gjë që krijoi probleme të rënda për gjithë rajonin (emigrim masiv, armata klandestinësh, trafik njerëzish etj.).

Ndërsa në rastin e Serbisë dhe në një shkallë më të vogël të Greqisë, ishte e nevojshme një ndërhyrje kulturore evropiane për të ulur ethet e nacionalizmit agresiv, në rastin e Shqipërisë duhej bërë e kundërta: një ndërhyrje kulturore për rivendosje të vlerave, gjë që do të sillte një inkurajim dhe një farë shprese që ky popull të kuptonte se jetën duhej ta ndërtonte në atdheun e vet e jo në troje të të tjerëve.

Ky dallim në këtë rast, midis prirjes nacionaliste dhe vetëglorifikimit të dy fqinjëve të Shqipërisë, dhe prirjes kozmopolite e anarkike të kësaj të fundit nuk e vë popullin shqiptar kurrsesi në një skajim të favorshëm. Rrënimi anarkik nuk e nderon asnjë popull dhe historia shpesh ka treguar se mohimi i atdheut nga njëra anë, ose glorifikimi i sëmure i tij, nuk janë veçse dy anë të një medaljeje, të tillë që lehtësisht mund të këmbehen me njëra-tjetrën.

### 3

Raporti me krimin është testi themelor për çdo qytetërim. Meqenëse koncepti i krimit është mjaft i gjerë e i larmishëm, gjerësi dhe larmi që ia ka dhënë vetë historia e njerëzimit, e cila tani për tani nuk mund as të shpjegohet e as të kuptohet pa të, duhet të nënvizojmë

se është fjala këtu për krimin e mirëfilltë, atë që qëndron në bazë të piramidës: krimin që derdh gjakun njerëzor. Grekët e vjetër ishin shumë të qartë kur e veçonin këtë krim nga gjithë të tjerët. Dymijë e pesëqind vjet më parë në "Orestian" e tij Eskili e ka përcaktuar si gjëmën më të palejueshme: daljen e gjakut njerëzor prej dejeve të njeriut, atë dalje pa kthim e pa riparim.

Vrasje e njeriut prej njeriut për ta ngrënë. Vrasje për t'i marrë ushqimin. Për t'i marrë kullotën, shtëpinë, gruan, tokën. Vrasje për zhdukjen e krejt një race, një populli. Në prag të mijëvjeçarit të tretë, pavarësisht nga stërhollimi i racës njerëzore, të gjitha krimet bazike, (me përjashtim të kanibalizmit) janë në veprim. E vetmja zbutje tani për tani është përpjekja serioze e një grumbulli shtetesh në kontinentin evropian e atë amerikan, për ta nxjerrë krimin e mirëfilltë, së paku atë që varet nga makina shtetërore, nga praktika njerëzore. Në kontinentin evropian kjo përpjekje u kundërshtua e u sfidua haptas nga një pjesë e gadishullit ballkanik, kryesisht nga regjimi serb. Dënimi i këtij regjimi e i krerëve të tij si kriminelë nga kancelaritë euro-atlantike ka qenë një akt i madh emancipimi. Mbrojtja e tij e drejtpërdrejt ose e tërthortë prej një shtrese intelektualësh e politikanësh, dëshmoi më qartë se kurrë se krimi mizor e vulgar në planetin tonë ka qenë mbështetur nga mendimi kriminal.

Shkulja e krimit të mirëfilltë në Ballkan e, krahas tij, goditja pa kompromis e mendimit kriminal në Evropë e në botë, janë veprime që kërkojnë ngut.

Shkulja e krimit fillon nga dënimi i tij. Dënimi i krimit fillon nga goditja e burimeve të tij.

Shërimi prej nacionalizmit të sëmurë nuk është i



pamundur në Ballkan. Një nismë e UNESCO-s për rishikimin e historisë së Ballkanit ka qenë një ide e mirë, por ajo ka mbetur e vetmuar e pa vazhdim. Procesi emancipues, që do t'i shtyjë popujt ballkanas drejt njohjes së vetvetes, është tepër i rëndësishëm. Të njohësh peshën dhe rëndësinë tënde të vërtetë, të njohësh peshën dhe rëndësinë e fqinjit tënd, të çlirohesh nga fantazmat, të çlirohesh ndërgjegjen nga rëndesa e kotë, nga helmi revanshist, nga ëndrra të marra e pa kuptim është fillimi i vërtetë i emancipimit. Nga një pikëshikim i veçantë mund të thuhet se drama e Serbisë së sotme ka ardhur ngaqë ky vend i vogël i dha vetes së vet një rëndësi që gjithsesi nuk e kishte, qoftë nga ana fizike, qoftë shpirtërore. Për të kryer këtë dhunim të realitetit objektiv, Serbia krijoi e vuri në veprim makinën e urrejtjes kundër popujve të tjerë. Pas urrejtjes, dihet ç'vjen: agresioni dhe krimet.

Është provuar tashmë nga historia se hapësirat greke, shqiptare, serbe, bullgare etj. mund të jetojnë natyrshëm përbri njëra-tjetrës. Ky nuk është një urim moralizant, por përfundim i një përvojë pesëshekullore, kur ata jetuan e u mbajtën në këmbë pikërisht ngaqë u ndodhën përbri njëri-tjetrit në kushte tejet tragjike. Prishja e kësaj tabloje, ideja e mbrapshtë se për të jetuar vetë më mirë, disa nga popujt duhet të shtypin, mundësisht të zhdukin popuj të tjerë, është në bazën e dramës ballkanase sot. Rivendosja e drejtpeshimit shekullor është fillim i daljes nga drama.

Për t'i ndihmuar ballkanasit Evropa atlantike duhet t'i ketë vetë të qarta disa gjëra bazike. Moskuptimi për një kohë të gjatë nga Evropa i konfliktit midis shqiptarëve dhe serbëve (konflikt kryesor, pa zgjidhjen

e të cilit nuk mund të ketë paqe në Ballkan) ka ndodhur edhe për një arsye të thjeshtë, por themelore: njohja e gabuar e peshës dhe e rëndësisë së dy popujve. Në një trysni shurdhuese propagandistike të bërë kryesisht nga Beogradi, në opinionin publik, madje edhe në zyrat europiane u krijua klisheja e konfliktit midis dy popujve me peshë krejtësisht të pabarabartë: Serbia si vend i madh, vend kryesor, rrjedhimisht me të drejtën për të vendosur rend, Shqipëria e kundërta: vend i vogël, popull i vogël, problematik, rrjedhimisht i shenjuar për t'u mbajtur në përgjim.

Kjo tablo e dhunshme, ky hipnotizim kërkonte të përjetësonte një gjendje absurde, të krijuar nga një vendim absurd, që kishte vendosur ndarjen e një vendi në mbarim të Luftës së Parë Botërore. Natyrisht, ishte e lehtë të zvogëloje gjer në kockë kufijtë e një vendi, por ç'duhej bërë me popullin shqiptar? Ishte pikërisht ai, populli shqiptar, që iu mbeti nëpër këmbë zyrave europiane. Ishte ai që kërkonte korrigjimin e tablosë. Ishte kjo arsyeja që, kur ai u shpall praktikisht "popull i ndaluar" Evropa nuk u shqetësua fort ngaqë ky popull ishte vërtet i besdishëm, si çdo qenie e pastrehë.

Gabimi bazik evropian duhej të qortohej pikërisht në këtë pikë themelore: dy popujt nuk ishin me peshë të ndryshme, por ishin pothuajse të barabartë qoftë nga ana fizike, si numër, qoftë nga ana kulturore.

Ka qenë vërtetë kaq e panjohur kjo e vërtetë? Për publikun e gjërë po, por është pak e besueshme për specialistët. Një shfletim sado i përciptë i historisë do të jepte të dhëna të tjera për statusin e dy popujve në konflikt. Në shekullin XVII, kur otomanët, pasi e kuptuan se nuk mund të sulmonin Evropën pa ndihmën e

ballkanasve, ata vendosën ta joshin gadishullin, duke i dhënë postin e kryeministrit të perandorisë, vezirit të madh. Ky post për gati një shekull, në formë dinastie iu dha shqiptarëve. Në atë kohë ata konsideroheshin dhe, me sa dukej ishin, një ndër popujt kryesorë në Ballkan, i tillë që mund të përfaqësonte gadishullin. Me kalimin e kohës, ky popull e humbi peshën dhe rëndësinë. Megjithatë, mbeti trupi i tij dhe natyrisht ato që ballkanasit nuk i humbasin kurrë: kujtimet historike.

Kur, në kushte krejtësisht të reja, shqiptarë e serbë rifilluan konfliktin e lashtë, shtypja e tyre prej serbëve nuk mund të ishte veçse një revansh, për fyerjen e gjatë e të padrejtë, që populli serb kishte pësuar nën Perandorinë Osmane. Ky revansh nuk mund të ishte veçse i përkohshëm. Në këtë botë mund të ndodhin gjithfarë gjëmash, por është vështirë të besohet që një popull ballkanas mund të thyhet nga një tjetër popull ballkanas.

Kur popujt e gadishullit të bëhen të ndërgjegjshëm për këtë të vërtetë, kur ata të kuptojnë se i vetmi shans për ta është e kundërta e konfliktit, ata do të vihen vërtet në rrugën e shpresës.

#### 4

Është normale të thuhet sot se Ballkani ka nevojë për Evropën. Ndërkaq pyetja tjetër: a ka nevojë dikush për Ballkanin, ose, më mirë, a mund t'i hyjë në punë Ballkani Evropës, bëhet rrallë. Kjo pyetje ka gjasë të shoqërohet me buzëqeshje ironike dhe me mendimin: kush mund të jetë i interesuar të fusë djallin në shtëpi?

Nga dy perandoritë e fundit, që patën punë me

ballkanasit: ajo e Habsburgëve dhe ajo e otomanëve, ishte kjo e dyta që, siç u tha më lart, e kapi qysh në krye faktorin ballkanas, si faktor vital për risimin e saj. Në këtë ide novatore e çoi logjika ushtarake. Duke qenë për më shumë se dy shekuj shumë më të përparuar se Evropa nga pikëpamja ushtarake, otomanët erdhën natyrshëm te shfrytëzimi i minierës së pashtershme ballkanase, ajo që do t'i furnizonte me oficerë, gjeneralë, me shpirt aventuroz, ambicie dhe marrëzi.

Habsburgët aristokratë as që mund ta duronin idenë që në elitën e tyre ushtarake, që plakej çdo ditë, të futnin këtë magmë të nxehtë e të rrezikshme. Ndërkaq, maksima se Ballkani fillon nën Vjenë, ndonëse e thënë me shpoti nëpër sallonet e Evropës, përmbante në vetvete një realitet, një ngacmim mondan, një qortim dhe pse jo, një sugjerim që nuk u mor kurrë parasysh.

Ideja e kundërt, që Evropa të shfrytëzonte Ballkanin si *fer de lance* kundër Perandorisë Otomane ka qenë gjithashtu e njohur dhe e vjetër. Projekte kryqëzatash të kryesura nga papë, nga prijës heronj ose aventurierë u braktisën njëra pas tjetrës. Shkak për këtë ishte, me sa dukej, mosnjohja e thelbit të marrëdhënieve Ballkan-Perandori. Ato, siç u tha në krye të këtij shkrimi, duke mos qenë konformiste nuk ishin megjithatë aq heroike, siç mendohej. Dy luftërat ballkanike kundër turqve në fillim të shekullit tonë, nuk ishin veçse karikatura e një premtimi të gjatë, nga ato për të cilat thuhet "u mbars mali e polli një mi". Në krahasim me përplasjet e vjetra pak a shumë epike, këto dy luftëra përmyllëse s'ishin veçse një *razzia* cubash për të plaçkitur një kalë të rrëzuar tashmë.

Sado e habitshme të duket, marrëdhëniet Evropë-

Ballkan sot, duam apo nuk duam ne, përsëritin diçka nga kjo lojë e vjetër pasqyrash. Idenë e vjetër otomane për t'i përdorur brigjet shqiptare kundër Evropës e trashëguan sovjetikët, madje, pikërisht në bazën e vjetër ushtarake turke të Vlorës (që dikur kishte qenë romake), u bënë gati të vendosnin raketat e tyre me mbushje bërthamore. Sot, me sa duket, Perëndimi do të bëjë të njëjtën gjë. Ballkani është gjithmonë tokë që rrezikon, herë nga Perëndimi, herë nga Lindja. Ndaj, kur flitet për të nuk duhet harruar asnjë herë ndarja e fajit: çfarë i përket gadishullit, çfarë i përket kontinentit.

Na pëlqen apo s'na pëlqen, në politikën e Evropës ndaj Ballkanit do të ketë patjetër rikujtime të vjetra, qoftë romake-bizantine, qoftë otomano-habsburgase. Nga gjithë ky realitet mijëvjeçar ka mbetur ende ideja e paluajtshme, ajo e arbitrazhit. Arbitrazhi evropatlantik, megjithë mungesat që mund të ketë një arbitrazh nuk është fyes, përkundrazi është shpëtimtar për rajonin. Fakti që ai është arbitrazhi i vendeve më të përparuara demokratike të kohës i jep legjitimitet përpara këtyre popujve të lodhur, me fat kaq të ashpër, që quhen ballkanas.

Për të ushtruar ndikimin e saj, për ta bërë Ballkanin zonë pozitive, që mund ta furnizojë kontinentin jo vetëm me pasuri e plazhe, që ai i ka si rrallëkush, por edhe me energji njerëzore e kulturore, Evropa duhet të çlirohet nga paragjykimet e fundit, që ende ia errësojnë pamjen. Ajo duhet të pranojë se në gadishull janë krijuar realitete të reja, që më parë as që mund të mendoheshin. Për të parë sa të thella janë ndryshimet mjafton shembulli i dy vendeve me konflikt shekullor: Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Shqipëria e gjerdjeshme: e izoluar, e çmendur, staliniste, antiperëndimore është

kthyer në një nga zonat më proevropiane të rajonit. Jugosllavia e gjerdjeshme, e hapur, properëndimore, liberale ose më saktë kinseliberale ka bërë të kundërtën: është kthyer në vend të mbyllur, stalinist. Dy armiqtë e vjetër kanë ndërruar kështu vendet. Askush nuk mund të jetë i verbër përpara kësaj.

Popujt e Ballkanit gjatë historisë së tyre të gjatë kanë krijuar një drejtpeshim fizik dhe shpirtëror përbri njëri-tjetrit. Në shekullin XX, për shkak të keqkuptimeve politike tragjike ky drejtpeshim u prish. Përpjekja për të përjetësuar të keqen në Ballkan me anë të doktrinave të reja raciste, siç është për shembull ajo e "rrezikut të ekspansionit shqiptar", vjen në kundërshtim me atë frymë qytetëruese evropiane. Në kohën e krijimit të shtëpisë evropiane, në të cilën të gjithë popujt duhet të zhvillohen natyralisht, të krijosh ligje speciale për kufizimin e lirisë dhe për zhvillimin harmonioz të një populli, ky është një kundërsens historik e moral, për të përdorur fjalën më të butë.

Evropa, mbikëqyrëse e gadishullit nuk duhet kurrsesi të bjerë në kurthin e intrigave e xhelozive të ndërsjellta ballkanase. Nga ana e tyre, popujt e Ballkanit përfundimisht duhet ta kuptojnë se, ashtu siç shekuj më parë shkuan bashkarisht drejt katastrofës, ashtu sot bashkarisht do të ecin drejt shpëtimit.

Riskajimi i gadishullit të madh në kontinentin mëmë do të sjellë ndryshime të ndjeshme për të gjithë. Vetëm atëherë mund të thuhet se unaza dalluese në kthetrat e shkabës së rikthyer nuk do të jetë shenjë e ndarjes, por e kujtimit të një brengje.

Paris, mars 2000

## PORTRET ARTISTI NE RINI, VERSION SHQIPTAR

*Prezantim i Maks Velos për publikun francez. Parathënie në përkthimin frëngjisht të tregimeve të burgut "Shitja e ditëve" prej Shtëpisë Botuese të Parisit "Lamprosa", më 1999.*

Dihet se pas rënies së komunizmit, nga vendet e ish- perandorisë u prit me kureshtje dhe padurim një letërsi e re, që do të dëshmonte në mënyrë të veçantë, më dramatike, më thellë dhe rrjedhimisht më bukur tragjedinë e këtyre popujve. U prit një gjë e tillë sidomos nga vende klasike staliniste si Shqipëria, burgjet e së cilës u hapën më 1991. Njëfarë habitjeje për të mos thënë zhgënjim e pasoi këtë pritje. Në të vërtetë, nuk ka patur vend as për habi e as për zhgënjim. Letërsia ka ligjet dhe oraret e saj, kështu që stinët politike, madje, dhe përmbysjet e mëdha, qëllon që e trazojnë atë me shumë vështirësi.

Lidhur me letërsinë që u krijua nga shkrimtarët e burgosur (ajo që u shkrua, u konceptua, u shkrua tërësisht ose pjesërisht atje), ka patur për mendimin tim dy arsye

kryesore, që nuk na ofroi befasinë që prisnim. E para, sepse ajo që ndodhte brenda burgjeve, në thelbin e saj nuk ishte tepër larg nga ajo çka ndodhte në jetën e përditshme. Ankthet, frika, tmërri politik ishin të të njëjtës natyrë, madje, mund të thuhet se qëllonte që në stinë të veçanta terrori, ankthet ndiheshin më shumë jashtë se brenda. Kështu që, kur të burgosurit dolën me dëshirën e natyrshme për të dëshmuar vuajtjet e tyre, ata gjetën jashtë shumë surpriza të hidhura. Arsyeja e dytë lidhet me atë që u përmend më lart, oraret e veçanta të letërsisë. Letërsia shqipe, pavarësisht se në pjesën dërrmuese të saj ishte e rrënuar nga “realizmi socialist”, i mjaftonte trangu i paprekur i saj, i përbërë nga disa shkrimtarë, për të kryer, midis natës së diktaturës komuniste, një dëshmi antidiktatoriale. Kështu që, në njëfarë mënyre, pjesa më e mirë e kësaj letërsie ishte ndërkaq e një familjeje me letërsinë që do të krijohej në liri.

Maks Velo është një nga autorët që, si rrallëkush e kuptoi se krijimi letrar e artistik, në rastin e tij letërsia e piktura, pavarësisht se në ç’kushte lindën, janë në radhë të parë, art. Si e tillë, dëshmia e tij është e një vlere të dyfishtë.

Maks Velo, piktor dhe shkrimtar, ka qenë një i burgosur politik i mirëfilltë. Diktaturat komuniste kanë qenë mjeshtre të vërteta për të ngatërruar, kur ua lypte nevoja, shkaqet e dënimit të njerëzve. Shpesh qëllonte që kundërshtarë politikë të regjimit binin në burg të fajësuar si njerëz me vese, imoralë, kumarxhinj ose vjedhës, ose e kundërta, të tillët, shpalleshin si të burgosur politikë. Në të dyja rastet qëllimi ishte i qartë: çnderimi. Makina vepronte në dy kahje: zhvlerësimi i



kundërshtarëve politikë, në rastin e parë, zhvlerësimi i vetë idesë së rebelimit politik në rastin e dytë.

Maks Velo ishte ndër të rrallët që u dënua drejtpërdrejt për artin dhe për mendimet e tij. Dënimi i tij ishte, gjithashtu, i veçantë për arsye se ai u dënua bashkërisht prej shtetit diktatorial dhe prej Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, pra prej kolegëve xhelozë të tij.

Ende njihet tepër pak aleanca e shëmtuar midis diktaturave dhe Lidhjeve të shkrimtarëve dhe artistëve në të gjithë perandorinë komuniste. Thelbi i marrëveshjes së pashprehur me fjalë ishte ky: Lidhja e Shkrimtarëve i shërbente me zell shtetit, i nënshtrohej çdo kërkesë të tij, për dënimin e anëtarëve të vet, por edhe shteti herë pas here i bënte qejfin Lidhjes duke dënuar ndonjë krijues, dënim që e kërkonte ajo, për arsye xhelozie profesionale!

Maks Velo ishte një krijues, piktor dhe poet, që pati fatin e keq të jetonte nën një diktaturë. Ai u dënua si krijues nga shteti dhe kolegët e vet, puthadorë të shtetit. Në burg ai mbeti ai që ishte më parë: i burgosur politik dhe piktor e shkrimtar. Pas daljes nga burgu ai vazhdoi të ishte ai që kishte qenë: as kërkoi ndonjë revansh të bujshëm, as e ktheu burgimin në mjet përfitimi.

Libri i tij është vërtetimi më i saktë i kësaj vazhdimësie njerëzore. Për ne që kemi jetuar në ato kohëra të vështira, ka qenë gjithmonë kënaqësi kur takonim njerëz, që stuhitë e kohës nuk i përçudnonin dot. Kënaqësia është e dhjetëfishtë kur njerëz të tillë janë miqtë e tu. Maks Velo ka qenë gjatë më shumë se 30 vjetëve miku im. Gjatë kohës që ndodhej në burg, natyrisht edhe ai, edhe unë, kemi ëndërruar takimin e

ardhshëm. Që do të më jepej rasti të prezantoja tregimet e tij për publikun francez, kjo e kapërcente çdo ëndërrim.

Porsa isha kthyer nga studimet nga Moska, kur u njoha me Maksin. Njohja me të ishte një zbulim për mua. Ishte fillimi i viteve '60, koha e paktë kur Shqipëria e porsa shkëputur nga kampi komunist po jetonte një periudhë disi liberale. I mërzhitur prej thatësisë së letërsisë sovjetike e sidomos prej shkrimtarëve sovjetikë, një pjesë e të cilëve u ngjante, edhe nga pamja, edhe nga veshja zyrtarëve të Komitetit Qendror, në mënyrë të vetvetishme po më tërhiqnin shkrimtarët shqiptarë të mbetur nga koha e përmbysur e mbretërisë, ata që popullsia naive i quante "borgjezë". Në Rusi, pas dyzet e ca vjetëve të diktaturës, shumica e shkrimtarëve "borgjezë" ishin zhdukur, kurse në Shqipëri diktatura ishte ende e re, pesëmbëdhjetë vjeçe, kështu që të vjetrit mund t'i takoje ende me shumicë. Tani, pas kthimit nga Rusia, ata po më dukeshin edhe më të çmuar. Kështu u njoha me Lasgush Poradecin, Dhimitër Paskon, Vedat Kokonën, Veis Sejkon e të tjerë.

Ishin të ndryshëm nga të tjerët. Të huaj krejtësisht për botën komuniste. Kishin kryer të gjithë studimet në Perëndim, mbanin borselina nga të viteve '30 e '40. U puthnin dorën grave, e thërrisnin njëri-tjetrin me "zotni" e "zonjë". Më dukeshin të mahnitshëm në gjithçka: nga mënyra si të prisnin në shtëpi e, natyrisht nga ato që tregonin.

Dija jo pak gjëra për vetminë e Pasternakut, fushatën kundër të cilit e kisha përjetuar dy vjet më parë në Moskë, për xhunjia e Lasgush Poradecit, çelësin e Moskës, për vetminë e Lasgush Poradecit, shkëputja e tij nga koha, ishte kolozale: Pastin më të

madh të gjallë të Shqipërisë, një pjesë e shqiptarëve e dinin të vdekur. Ai kishte të njëjtin mendim për epokën, e quante të vdekur.

Dhimitër Pasko, me natyrë të qetë, të kundërt prej Lasgushit nervoz, më dukej i mistershëm me fatin e tij: kishte qenë në stepat ruse, por jo si ne të tjerët, në kohën e miqësisë komuniste, por i mobilizuar me forcë në trupat gjermane, që po i afroreshin Stalingradit, pra, në anën tjetër të pasqyrës.

Një tjetër, Vedat Kokona, në shtëpinë e tij të vogël verore, të marrë me qira në ranishten e Durrësit, më tregonte për plazhin në kohën e mbretërisë, për historitë e kronikën mondane, personazh qendror i të cilës kishte qenë edhe vetë.

Të gjithë këta njerëz më tërhiqnin por edhe më brengosnin, si diçka e pakthyeshme. Ishte një botë që po perëndonte me shpejtësi.

Befas, në këtë kohë, në Klubin e Shkrimtarëve, në një ekspozitë të sapopërruar u njoha me një djalë të ri, pothuajse moshatar me mua, i cili ndryshe nga ne, shkrimtarët e artistët e rinj, të ardhur nga metropolet komuniste: Moska, Varshava, Budapesti, kishte misterin e atyre që po iknin, “borgjezëve”. Ky ishte Maks.

Nuk kishte asgjë prej romantikut të vonuar. As ishte nostalgjik i regjimeve të përmbysura. Përkundrazi, ishte një djalë i hijshëm e modern. Ngjyrimi “i dikurshëm” i vinte nga brenda. Ndihej menjëherë që, ndonëse i ri, ishte jashtë kohës. Ndryshe nga shumica e brezit të ri, që kishin si gjuhë kryesore ato të perandorisë: rusishte, hungarishten etj., Maks lexonte frëngjisht e italisht. E kështu me radhë, në stilin e të folurit, të sjelljeve. Nuk kishte asgjë natyrisht nuk donte, të përdorte dotë edhe

në mbledhje terminologjinë e kohës, madje, as fjalën “shok” nuk e thoshte dot.

Ishte i heshtur e pa bujë në qëndresën e tij. Aq i heshtur, saqë gjatë hetimit dhe më pas, në gjyqin e tij, nuk u sollën dot si akuza fjalë a mendime të tij kundër regjimit. U dënua kryesisht për pikturat e tij, që u quajtën moderniste e dekadente. Një nga faktet që tërthorazi dëshmonte ftohtësinë ndaj regjimit ishte “qëndrimi i tij i pikëlluar në kafene”. Ka mundësi që në krejt botën groteske komuniste Maksi të ishte i vetmi që të ngarkohej me një faj të tillë.

Maksi ishte inxhinier arkitekt. Gjatë kohës që i mbetej, pikturonte dhe lexonte. Bisedat tona në shtëpinë e tij (banonte disa minuta me këmbë larg meje), ishin një kënaqësi e vërtetë për mua. Atmosfera gjithashtu ishte e veçantë: ateljeja i tij në katin e dytë të shtëpisë, motra dhe nëna e tij e mrekullueshme, që na sillte herë pas here ndonjë kafe dhe natyrisht ato që flisnin. E njihte mirë letërsinë dhe dramën e saj. Temë e parapëlqyer për të dy ishin natyrisht shkrimtarët e piktorët e huaj të ndaluar në Shqipëri: poetët “e mallkuar” francezë, Prusti, Kafka, Shagalli, Piccasso. Kur pas “Përbindëshit”, që u ndalua si vepër moderniste, shkrova dhe botova “Kasneçet e shiut” (Kështjella), ai shfaqti drojën se mos nën trysinë e kohës po bëhesha si tepër realist. Për t’i treguar se unë vetë e kisha atë droje, i dhashë të lexonte dorëshkrimin e romanit “Kronikë në gur”, për të cilin, siç do të thoshte më pas një kritik francez “realizmi ishte korrigjuar me pakëz marrëzi”. Më kujtohet se titullin e gjetëm bashkë. Nganjëherë më merrte në telefon për të më thënë se në

një përkthim të vjetër të “Biblës” në shqip kishte gjetur dy-tri fjalë të hershme, që mund të më hynin në punë.

Gjithmonë habitesha se si ia dilte që të merrej vesh me zyrtarët në Bashkinë e Tiranës, ku punonte prej vitesh. Përveç heshtjes e mbronte, ndoshta, mosshitja e tij. Të gjithë e dinin se ishte tjetërlloj, ndaj dhe në një farë mënyre e pranonin. S’prisnin prej tij as zjarrmi entuziaste, as zell për të dënuar armiqtë, dy nga gjërat më të zakonshme në mbledhjet e asaj kohe.

Ndërkaq, Maksi punonte. Bënte projekte ndërtesash një pjesë e të cilave kryheshin, botonte tek-tuk ndonjë vizatim të parrezikshëm, shkonte në Klubin e Shkrimtarëve dhe Artistëve, ku natyrisht vazhdonte “të rrinte i pikëlluar”.

Në atë kohë, shkrimtarët e artistët më të njohur, sidomos ata që nuk kishin zyra dhe punonin në shtëpi, kishin të drejtë për një dhomë pune. Apartamenti im në rrugën “Luigj Gurakuqi” ishte fare i vogël, i përbërë vetëm prej dy dhomash. Në vitin 1970, pas botimit të “Gjeneralit” në Francë, kur gazetarët e huaj trokitën disa herë pa paralajmërim në derën time, ngushtësia e apartamentit tim u bë problem, çka bëri që Bashkia e Tiranës të më vinte në listën e ngutshme për zgjerim.

Maksi erdhi një mbrëmje gjithë gëzim për të më njoftuar se kishte marrë vesh në Bashki, se pikërisht në ndërtesën që ai po projektonte, ishte parashikuar që unë të merrja një apartament.

Ndërtesa e projektuar ishte dyqind hapa larg, dhe pas fillimit të ndërtimit, pasi u siguroam se unë isha vërtet në listë, shkonim shpesh të dy për ta parë. Maksi ishte i guximshëm dhe pa pyetur askënd, te njëri nga apartamentet, ai që parashikohej “me një dhomë pune”.

bëri ndryshimet e nevojshme, në mënyrë që dhoma e punës të kishte një hapësirë të pazakontë për stilin socialist të banesave. Pa u mjaftuar me këtë parashikoi vendin e një oxhaku, (domethënë zgavrinën thithëse të tymit), në mënyrë që “zjarri i përjetshëm” të më ndihmonte në punë! Ishte ndoshta i vetmi apartament në një ndërtesë banimi të përbashkët në Shqipëri, i projektuar me një oxhak. (Të dyja këto modifikime, hapësira dhe oxhaku do të bëheshin problem më pas, çështja do të shkonte gjer te kryeministri i shtetit. Vetë ndërtesa do të vihej në shënjestër të akuzave, sidomos pas dënimit të Maksit, do të quhej moderniste, kubiste, madje disa herë do të propozohej shembja e saj).

Ndërkaq ne, duke mos parashikuar asgjë ëndërronim si do të bisedonim duke pirë kafe, ndanë oxhakut. Kishim caktuar dhe vendin ku do të vendosnim tablonë e tij më të dashur “Kënga epike”, të cilën ai ma kishte dhuruar ndërkaq.

Ndërkaq atmosfera sa vinte po zymtohej në Shqipëri. Shpresat që hapeshin aty-këtu mbylleshin prapë. Flitej për një ftohje me Kinën, por asnjë shenjë afrimi me Evropën nuk dukej në horizonte. Njëlloj si në historinë e shkëputjes me sovjetikët në vitet 1960.

“Ora e kafesë tek oxhaku” sa vinte dukej më e largët. Ndërtesa “e jonë“, herë për pengesa burokratike, herë për arsye smire të kolegëve të Maksit, ngrihej fare ngadalë. Disa herë punimet u ndërpre, hapeshin fjalë se ishte skajuar keq, se do të anulohesh.

Në jetën e Maksit ndodhi befas një ngjarje e habitshme. Një ditë trokiti te unë së bashku me një vajzë franceze. Mbeta gojëhapur ngaqë e dija se Maksi nuk

bënte pjesë në ata njerëz, që shteti mund t'u besonte shoqërimin e një të huaje. Më tha se e kishte njohur rastësisht në Bibliotekën Kombëtare dhe kishte disa ditë që e takonte rregullisht. E askush s'të ka thënë asgjë për këtë? e pyeta. Askush, u përgjigj Maksi.

Kjo ishte gati e pabesueshme. Në Shqipëri, pas një bisede disa minutshe me një të huaj, të thërrisnin të jepje shpjegime, e jo pastaj të shoqërohesh ditë të tëra.

Dukeshin të gëzuar të dy dhe kjo më bëri që të mos ia thoshja dyshimin tim se mos kjo heshtje e shtetit mbante erë kurth. Kur pas disa ditësh më tha se vazhdonte të shoqërohej me francezen dhe askush nuk po i tërhiqte vërejtjen, mendova se shteti kishte përfituar nga natyra e veçantë e Maksit për ta shtirë vërtet në kurth. Pas ikjes së vajzës franceze do ta thërrisnin me siguri për t'i bërë trysnitë e zakonshme.

Ata që e morën vesh, menduan se ishte kjo marrëzia që e rrëzoi përfundimisht fatin e Maksit. Unë kam menduar gjithmonë se ajo bëmë e tij, sado e jashtudhshme të dukej, nuk e ka dëmtuar drejtpërdrejt. Zyrtarët shqiptarë janë shqyer gazit. E kanë quajtur me siguri tuaf, Don Kishot, të fantaksur. Megjithatë, sinqeriteti i tij, sado që sinqeriteti ishte i huaj e i paçmuar në atë botë, mund ta ketë ndihmuar. Lidhja intime me një të huaj shkaktonte dënim të rrufeshëm në Shqipëri. Maksi u dënua shumë vite më pas. Veç një gjë ishte e vërtetë: kolegët e tij smirëzinj u gjallëruan kundër tij, pikërisht pas historisë me francezen. Në të vërtetë, ishin ata që do ta rrëzonin.

Më 1973, pas një periudhe të shkurtër liberalizimi,

u ndie një acarim i ri në jetën e krejt vendit, sidomos në kulturë. Ishte një nga ato stinët e pritura me padurim nga shkrimtarët dhe artistët militantë, për të larë llogaritë me kolegët e tyre. Maks Velo bënte pjesë ndër ata që u vunë në shënjestër.

Për një kohë të gjatë nuk e gjeja dot se cili mund të ishte shkaku i vërtetë i atij mllef i të palodhur kundër tij. Me natyrën e tij të heshtur, me mënjanimin e sidomos me shpërfilljen e plotë ndaj karrierës, Maksi nuk rrezikonte askënd prej kolegëve të tij piktorë. Mirëpo ishin, me sa dukej, pikërisht heshtja dhe natyra e tij munguese që ia afruan fatkeqësinë. Të mësuar që të përndizeshin në mbledhjet solemne, që t'u dridhej zëri nga emocioni e t'u skuqeshin fytyrat nga ngazëllimi kur takonin udhëheqësit e partisë, turma e shkrimtarëve dhe e artistëve konformistë nuk e duronin dot dinjitetin e atyre kolegëve të paktë të tyre që rrinin mënjane e si në hije në këto ngjarje. Mënjanimi i këtyre të fundit, fytyrat serioze e pa gëzim, ishin për konformistët entuziastë një sfidë e padurueshme. Maksi bënte pjesë ndër sfidantët.

Shënja e parë e fatkeqësisë së tij u ndie në kryesinë e Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve, kur në një rën nga mbledhjet famëkeqe "për forcimin e partishmërisë dhe të luftës së klasave në letërsi dhe arte", emri i tij u citua ndër ata që fajësoheshin për modernizëm dhe dekadentizëm. Ky ishte vetëm fillimi. Ata që kanë jetuar në atë kohë të egër e njohin mirë shkallëzimin e ankthit, ritmin e rënies së njeriut, shpresat që këputen njëra pas tjetrës, gjersa vjen koha e zbrazët, e vdekur, përpara goditjes fatale.

Maksi i përjetoi të gjitha fazat e këtij ferri. U hoq



nga puna në Bashki, u emërua si inxhinier zbatimi në një kooperativë bujqësore jashtë Tiranës, u përgjua me siguri ditë dhe net të tëra. Por e keqja nuk ndalej kurrë në kësi rastesh. Në një mbledhje tjetër të Kryesisë, kur sekretari i pikturës propozoi përjashtimin e tij nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, unë e kuptova se fati i Maksit kishte marrë rrokullimën.

Mbledhja e përjashtimit të tij mbeti në kujtesën time si një gjëmë e zezë. Kryesia kishte rreth 25 anëtarë, shkrimtarë, piktorë dhe muzikantë. Ishte miku im, dhe mbrojtja e tij ishte më e pakta gjë që mund të bëja. Për fat të keq, askush tjetër nuk e mbrojti Maksin. Por mbrojtja ime, pikërisht ngaqë ishim miq, nuk ishte efikase. Duheshin së paku dy-tri zëra të tjerë, që mbrojtja të kishte peshë. Dhe ishte plotësisht e mundur kjo. Mirëpo askush nuk foli. Heshtën në mënyrë të turpshme shkrimtarët dhe muzikantët, ata që e kishin edhe më lehtë të flisnin gjysmë fjale, ngaqë viktima ishte e një sektori tjetër. Heshtën një pjesë e piktorëve, kurse pjesa tjetër foli veç për të derdhur helm.

Maksi u përjashtua nga Lidhja, me fjalë të tjera, u la në kthetrat e diktaturës. A mund të mbrohej? Natyrisht që po. Mbrojtja nuk ishte kaq e pamundur, siç përpiqen ta bëjnë më pas, të gjithë ata që kërkojnë të përlligjin larjen e duarve në gjithçka. Në kryesi ka patur raste kur janë mbrojtur aq sa mundej disa shkrimtarë e artistë si Dhori Qirjazi, Sotir Andoni, Koço Kosta etj. Në mos shpëtoheshin plotësisht, mbrojtja e zbuste dënimin, dhe sidomos shmangte burgun.

Pak kohë më pas Maksi, ashtu siç pritej, u arrestua. Në gjyq kolegët piktorë dëshmuan njëri pas tjetrit kundër tij. Shtëpia e tij u bastis. Pikturat iu sekuestruan.

Shumica iu grisën e iu dogjën.

Maksi e kaloi në burg një nga periudhat më të rënda të jetës shqiptare. Të kishe shokë në burg në atë kohë do të thotë të ndiheshe dyfish i pasigurt. Të gjithë e dinin se në burg vazhdonte edhe përgjimi edhe hetuesia e mëtejshme, edhe ridënimet. Kështu që çdo natë andej mund të të vinte e keqja. Njerëzit e dinin këtë, diktatura gjithashtu, nuk e fshihte. Ajo e kishte shndërruar burgun në një Hades të vërtetë prej nga vinin kumte të turbullta, si në lashtësi. Përveç mikut tim Todi Lubonja, i dënuar me pesëmbëdhjetë vjet, tani ishte shtuar Maksi. Një tjetër mik i ngushtë, poeti Dhori Qiriaz, ishte ndodhur disa herë në prag të burgimit. Isha i sigurt për besnikërinë e tyre, megjithatë, kush mund ta parashikonte se ç' mund të ndodhte në birucat e errëta, si rrjedhojë e torturave.

Në banesën e projektuar prej Maksit në Rrugën e Dibrës, banorët e njëzet apartamenteve vazhdonin jetën, pa u shkuar mendja se projektuesi i saj ndodhej në burg. Ishte ndërtesa e fundit e projektuar prej tij, pikërisht ajo që i kishte sjellë fatin e keq. Në dhomën time të punës, vendi i oxhakut për disa vjet mbeti si një shenjë e trishtë. (Pas mbarimit të ndërtesës, Maksi kishte ardhur disa herë në apartamentin e ri, por për oxhakun as ai e as unë s'kishim gjetur ende mundësinë ta mbaronim). Kishim vënë vetëm pikturën e tij "Kënga epike" në pritje, ndoshta, të një kohe më të butë.

Kur kohë më pas, oxhaku më në fund u mbarua, Maksi ishte në burg. Ai bënte pjesë tashmë në pikëllimet e mia. Nuk kisha shpresë se do të vinte dita që të rrinim më në fund pranë këtij oxhaku për të marrë kafënë si

dikur, qoftë edhe “me pamje të trishtuar”.

E, megjithatë, mrekullia do të ndodhte vite më pas.

Maksi doli nga burgu pas tetë vjetësh. Askush nuk e mori vesh në fillim. Të burgosurit politikë dilnin nga burgu pa zhurmë e si hije. Një ngazëllim i tepërt në shtëpi, vizita të njerëzve ose takime me ta në rrugë quheshin të rrezikshme. Të porsadalët nga burgu për një kohë të gjatë nuk përziheshin me askënd dhe në rrugë nuk i flisnin të njohurve për të mos u shkaktuar fatkeqësi.

Një pasdite isha duke kaluar me time shoqe në sheshin “Skënderbej”, kur, të befasuar, pamë Maksin. S’kishte ndryshuar asnjë grimë, kishte në fytyrë të njëjtin pikëllim dhe ecte si më parë, me të vetmin ndryshim se nuk shikonte asnjëri.

Ne i thirrëm “Maks!” dhe m’u duk se mollëzat iu drodhën. U desh një grimë kohe, ndoshta, të kuptonte se ne miqtë e tij po i flisnim vërtet, se nuk kishim drojë ta takonim dhe ta quanim prapë mik, si më parë. Kur i thashë se ia kisha ruajtur “Këngën epike” dhe se mund të vinte ta merrte kur të donte sytë i vezulluan nga lotët. “Të tjerat m’i kanë djegur”, tha.

E ftuam që atë mbrëmje në shtëpi dhe ndërsa vërtitej nëpër apartamentin, që e njihte po aq mirë sa unë, dhe sidomos kur u ulëm të merrnim kafënë pranë oxhakut, edhe unë, edhe ai mendonim se diçka ishte thyer në fatalitetin e keq të gjërave dhe se një dritëz dukej, më në fund, në horizont.

Ishte viti 1986. Komunizmi do të binte pas katër vjetësh në Shqipëri.

Paris, mars 1998

## FJALIM I PRANIMIT NË AKADEMINË FRANCEZE

*Seanca solemne në "Coupole" të  
Institutit të Francës më 28 tetor 1996*

Kur pak më parë zoti kryetar i Akademisë duke folur për gadishullin ballkanik, shfaqti mendimin e tij se nga ky rajon i botës nuk presim vetëm tmerre dhe prapësira, por edhe shenja të tjera, unë, si i ardhur këtu pikërisht nga kjo lagje e vështirë e botës i mora ato fjalë si një mesazh fisnik, drejtuar popujve të kësaj zone.

Sot ka shumë egërsi në gadishullin ballkanik, ka shumë ankth e sidomos ka shumë marrëzi. Por, siç ndodh shpesh, kur pikërisht midis shtjellës së keqe shfaqet drita, të jeni të sigurt se atje diçka e mirë e pret ditën e vet për t'u shfaqur. E ndër shenjat e mira që më sigurojnë për këtë vizion shprese, është dashuria për Evropën.

Është paradoksale të konstatohet se sa më fort ballkanasit bëjnë marrëzira, domethënë sa më shumë largohen nga Evropa, aq më shumë ata flasin me nostalgji për Evropën, madje disa prej tyre kujtojnë se edhe krimet që bëjnë i bëjnë kinse për të mbrojtur Evropën. Pavarësisht nga kjo, Evropa mbetet përherë

një referencë e paluajtshme në mendimet e tyre, një shpresë, për të mos thënë një ëndërr.

Dhe unë mendoj se kjo, sado paradoksale të duket është një shenjë e mirë. Një ëndërr është përherë paraprojekti i një kredoje, i një synimi.

Në antikitet, grekët e vjetër, që janë një ndër popujt më të vjetër të gadishullit, e përfytyronin Evropën si një qenie mitike. Edhe sot, po të lexoni këngët popullore që vazhdojnë të krijohen atje, jo vetëm të grekëve, por edhe të popujve të tjerë ballkanas, dhe ndër këta hyn edhe populli të cilit unë i përkas, vazhdon kjo traditë. Evropa vazhdon të përfytyrohet si grua. Një grua e bukur, inteligjente, disi e paarritshme. Dhe, siç ndodh shpesh me gra të tilla, ato nxitin tek adhuruesit ndjenja kundërthënëse: dëshirën për ta dashuruar natyrisht, por në pamundësi të saj, dëshirën për ta përdhunuar.

Ballkanasit ka më shumë se një shekull që të tillë e shprehin dashurinë për Evropën: në mënyrë pasionale, nervoze. Ajo që duhet të ishte dashuri përfundon në keqkuptim tragjik.

Dhe kjo është e kuptueshme. Dy mijë e pesëqind vjet më parë, në këtë zonë të botës lindi drita e qytetërimit evropian. Por, si për një mallkim të fatit, në kohën kur Evropa nisi të qytetërohej, kjo pjesë e saj ra në errësirë për gjashtë shekuj rresht.

Popujt që kanë humbur një herë Evropën e çmojnë atë më fort.

Shqiptarët, populli të cilit unë i përkas, e kanë humbur dy herë Evropën: herën e parë në shekullin XV, si gjithë popujt e tjerë ballkanas, herën e dytë pas luftës së Dytë Botërore, kur ranë nën sundimin komunist. Nuk e teproj aspak po të them se sot, pas përmbysjes së

komunizmit, shqiptarët jetojnë prapë në ankthin e humbjes së tretë të Evropës. Kjo do të ishte fatale për ta, kjo do të ishte baras me vdekjen e tyre.

Ju që jetoni në zemër të Evropës, që jeni thelbi i saj, ju nuk mund ta kuptoni se ç'është ky ankth. Ju nuk mund ta dini se ç'është ankthi i popujve që jetojnë në periferi të kontinentit evropian dhe që në çdo tërmet të historisë mund të shkëputen prej saj. Të mbante të ankoruar vendin e vet pas trupit të kontinentit mëmë, kjo ka qenë aspirata kryesore, misioni kryesor i kulturës shqiptare, një përfaqësues të së cilës ju e pranoni sot në këtë Coupole, që simbolizon më rrokshëm se çdo gjë atë që unë quajta pak më parë thelbi i Evropës.

Kur ju dëgjoni emrin "shqiptar" jam i sigurt se, pa dashur, përpara se të mendoni ç'është ky vend, gjëja e parë që iu vjen ndër mend është imazhi tronditës i mijëra njerëzve që kacavirren me litarë në anije. Unë s'do t'ju vija faj edhe sikur disa prej jush, gjithmonë pa dashur, hyrjen e një sivëllai (confrère) shqiptar në këtë vend të nderuar, më tepër se nëpër një rrugë normale, ta përfytyroni si kacavirje nëpër Coupole.

Unë nuk fyhem nga kjo sepse e kam pranuar të kem fatin e popullit që i përkas, ndonëse, përgjithësisht, ai fat ka qenë i hidhur.

Në qoftë se i kthehemi imazhit të anijeve dhe të turmës së njerëzve që kacavirrej në të, të jeni të sigurt se për ata njerëz të dëshpëruar e të egërsuar, ato anije ishin Evropa. Dhe dyzet vjet pas ndarjes prej saj, ëndrrën e tyre për Evropën, dashurinë e tyre të vështirë për të, dashuri që ishte njëkohësisht përdhunim, siç e thashë pak më lart, ata nuk dinin si ta shprehnin ndryshe.

Ashtu siç thashë pak më parë, duke e ftuar një

shqiptar, një ballkanas në këtë Coupole, ju i jepni shpresë pjesës më të mirë të këtyre njerëzve. Ndryshe nga shumë kalkulatorë politikë, ju tregoni se Evropa është e vëmendshme ndaj këtyre popujve. Dashurisë së tyre, dashurisë së tyre të vështirë, e shpesh të shprehur keq, ju i përgjigjeni jo me përbuzje, por me mirëkuptim.

Kjo nuk është një lëmoshë. Këta popuj e meritojnë vëmendjen. S'është vetëm antikiteti grek që më së shumti na vjen ndër mend. Janë të tjera vlera që ata kanë krijuar, qoftë edhe në kohët e fundme. Mjafton të kujtojmë se pikërisht ky rajon i ashpër i botës dhe, pikërisht, populli shqiptar, i dha njerëzimit të sotëm simbolin e dhembshurisë, Nënë Terezën.

Dhe kjo është një tjetër arsye për të evokuar mirëkuptimin dhe shpresën.

Me këtë fjalë, "shpresë", dëshiroj të kujtoj, së pari, njeriun e madh të cilin kam nderin të zëvendësoj në këtë Akademi, Karl Popperin.

Ishte jo vetëm një filozof i madh, por një ndër ata që si rrallë kush e kuptoi epokën e vet, ndonëse jo përherë u kuptua prej saj. E kur them e kuptoi epokën, do të thotë se e kapi si rrallë kush shqetësimin e popujve, dramën e rëndë që ra mbi ta në këtë shekull të egër, fundin e të cilit ne po e jetojmë.

Ndryshe nga një traditë filozofike negativiste, që e ka përherë më të lehtë të shohë zi dhe dëshpërim kudo, Karl Popperi, ndonëse ishte i ndërgjegjshëm për tragjedinë e njerëzimit, pati kurajën të jetë gjer në fund optimist. Them pati kurajën, sepse dihet që pesimizmi konsiderohet më fisnik se shpresa dhe se optimizmi ka rrezik të merret si konformizëm.

Kjo dritë shprese, kjo kthjelltësi dhe klimë eterne,

e afron atë me filozofët antikë, dhe s'është e rastit që disa herë është quajtur si Demokriti i kohës sonë.

Siç ndodh shpesh me njerëzit e mëdhenj, në jetën e të cilëve ka episode të një lloji të veçantë, në dukje të thjeshta, po me një thjeshtësi monumentale. si episodi, i vërtetë ose i sajuar, nuk ka rëndësi, i mollës së Njutonit, Karl Popperit i ndodh një gjë e tillë në moshën 17 vjeçare. Pothuajse adoleshent, i tërhequr prej ideve komuniste ai mori pjesë në një demonstratë, që duhej të ishte edhe iniciimi i tij në lëvizje. Demonstrata u shtyp me gjak nga policia. Pati katër të vranë dhe shumë të plagosur. Po atë mbrëmje Karl Popperi vendosi ta braktisë përjetë komunizmin.

Mendimi i parë që të vjen kur e dëgjon këtë episod është se Karl Popperi u tremb. Dhe në vend që gjaku i derdhur ta lidhi më fort me lëvizjen, e ndau prej saj përjetë. Mirëpo nuk ka qenë kështu.

Siç e shpjegon ai vetë, po atë mbrëmje, kur Karl Popperi takoi organizatorët komunistë të demonstratës, u tmerrua kur vuri re se ata, në vend të ishin të trishtuar për vrasjen e shokëve, ishin përkundrazi të ngazëllyer. Kjo do të thoshte se e kishin arritur qëllimin kryesor: derdhjen e gjakut.

Në këtë botë shpesh herë qëllon që gjëra të mëdha e të ndërlikuara zbulohen nga një shenjë, nga një ndriçim i rastit, nga një gjest. Karl Popperi 17 vjeçar, ende pa kurrfarë përgatitjeje filozofike, nga një episod banal zbuloi thelbin e diktaturës komuniste. Ky do të ishte i njëjti thelb me atë të nazizmit, që do të vinte pas tij, e i diktaturave të tjera totalitare, të cilat, medet, po i shohim ndërkaq në horizont. Ky thelb është i qartë: këto diktatura, për të jetuar, kërkonin viktima. S'ka



rëndësi gjaku i kujt derdhej: i të tjerëve apo i njerëzve të vet. Mjaftonte që mekanizmi të vihej në lëvizje prej tij.

Gati shtatëdhjetë vjet rresht Karl Popperi e studioi dhe e ndoqi hap pas hapi totalitarizmin nazist e komunist, dhe thelbi i zbulimit të tij të rinisë mbeti po ai.

Antikonformizmi i Karl Popperit është i thellë, i vërtetë dhe asnjëherë trill intelektualist. Pas denoncimit të krimeve të totalitarizmit, ai ka guxim të thotë se edhe demokracia është e aftë të bëjë krime, nëse abuzohet me të. Ai na kujton dy krime të demokracisë greke: masakrimin e banorëve të ishullit Melos prej Athinës dhe dënimin e Sokratit prej një jurie prej pesëqind e ca vetësh. Karl Popperi na kujton një krim të tretë, i cili nuk arriti të kryhej: vendimin e Athinës për ndëshkimin e Mytilenës. Një anije u nis për të çuar dekretin e vdekjes, por të nesërmen Athina e penduar, nisi një anije të dytë, më të shpejtë, për të anuluar dekretin e parë.

Është një rast tepër i rrallë që në historinë e botës përmendet një akt pendimi. Por për këtë do të flas pak më poshtë.

Karl Popperi, pra, i dinte mungesat e demokracisë. Ai mendonte se nuk mund të kërkojmë gjithçka prej demokracisë. Ai mendonte se gjëja kryesore që duhet të kërkojmë nga demokracia është kalimi i pushtetit pa gjak nga një forcë politike në një tjetër. Ky formulim i tij është monumental në thjeshtësinë e tij.

Ende sot, për një pjesë të njerëzve kjo është një ëndërr e bukur. Të mësuar me egërsinë dhe dhunën në që kemi jetuar me botën komuniste, e sidomos në që

qysh në fëmëni jemi ushqyer me diktaturën komuniste, të tilla formulime ende na tingëllojnë të habitshme. Por le të shpresojmë që më vonë, brezat që do të vijnë pas nesh, do të habiten me të kundërtën. Për ta kalimi me gjak i pushtetit do të ishte po aq absurd sikur të përfytyrohej që ndërrimi i stinëve të bëhej jo i natyrshëm, por me gjakderdhje dhe shkatërrim.

Si çdo antikonformist i vërtetë Karl Popperi kishte kurajën të mos bënte lodra me antikonformizmin. Ai pranonte shtetin minimal, ai ishte kundër anarkisë dhe abuzimit me lirinë. Sipas tij, një shumicë gjithashtu mund ta mbyti demokracinë, sipas tij, liria njerëzore, ndryshe nga ajo e kafshëve është liria e vërtetë ngaqë është liri e vështirë e mbikqyrur nga e drejta.

Karl Popperi nuk kishte frikë nga thjeshtësia, kjo fantazmë që shpesh i tmerron intelektualët e kohës sonë. Ai nuk kishte turp nga optimizmi dhe shpresa. Thirrja: "mos i dëshpëroni popujt" buron natyrshëm nga krejt vepra e tij.

Kjo thirrje fiton një vlerë të re pikërisht sot, kur pjesa e njerëzimit që porsa ka dalë nga perandoria e përmbysur komuniste është e çoroditur, e thyer moralisht, e hutuar.

Këta popuj, të zënë në një kurth të madh, për të cilin historia ende nuk ka dhënë shpjegimet e plota, kanë luajtur së bashku një teatër tragjik e grotesk njëkohësisht. Ashtu siç e luajtën bashkërisht atë pjesë, po ashtu, bashkërisht duhet të ndihmohen për t'u ndarë prej saj. Por unë do të shtroja këtu se drama nuk ka qenë vetëm e tyra. Drama ka pasur përmasa planetare dhe në një mënyrë ose një tjetër gjithë njerëzimi ka qenë përzier në atë që mund të quhet epilog i trishtë

komunist i këtij mijëvjeçari.

Asnjë perandori totalitare në globin tokësor nuk ka patur ndonjëherë hapësirë më të gjerë se bota komuniste. Perandoria romake nuk ishte veçse një e pesta ose një e gjashta e saj, perandoria otomane edhe më e vogël, kurse Rajhu i tretë s'ishte as një e dhjeta e këtij gjigandi. Ende nuk është studiuar mirë se sa ndikoi kjo hapësirë e pafundme në psikozën e banorëve të këtij universi.

Gjithë aventura njerëzore u vu në provë në këtë arenë të ashpër. E meqenëse unë i përkas racës së shkrimtarëve, më lejoni ta mbyll diskutimin me dy fjalë për sivëllezërit e mi shkrimtarë, që fati iu ra të jetonin e të punonin midis kësaj bote të çmendur.

Ndoshta, është pak e tepërt që, pasi përmenda vendet ballkanike, pasi kujtova komunizmin, të flas për një terren tjetër të vështirë, siç është letërsia. Por nuk do të zgjatem. Nuk do të flas për shtypjen, censurën, autocensurën. Nuk është hera e parë që letërsia botërore është ndeshur me to. Letërsia është mësuar me të keqen, me ndalimin, me pengesën. Qysh në fillimet e saj, letërsia antike u ndesh me kaosin mitologjik. Kaosi mitologjik ishte krijimi i të gjithëve: atje përziheshin të gjitha, vlerat dhe antivlerat. Ose më saktë: një grusht vlerash dhe një oqean antivlerash. Shkrimtarët antikë grekë, princër të vërtetë të artit, arritën ta venë nën kontrollin e tyre atë mjegullnajë të turbullt e të patrajtë. Nga oqeani i mediokritetit arritën të nxjerrin perlat.

Gjithë historia trimijëvjeçare e letërsisë botërore s'është tjetër veçse mbrojtja e vlerave prej sulmit të paprerë të mediokritetit, me fjalë të tjera prej sulmit të kaosit primitiv që nuk heq dorë prej ëndrrës për ta marrë

prapë në dorë letërsinë e botës.

Njëqind e pesëdhjetë vjet më parë Friedrich Schiler, duke folur për korin e tragjedisë antike ka thënë si ai kor ishte muri mbrojtës që mbronte theatrin nga masa e spektatorëve. Për atë mur letërsia ka patur nevojë përherë. Ndaj shtetet totalitare, për të shkatërruar armiken e tyre të përherëshme, letërsinë, kanë dashur ta thejnë pikërisht atë mur.

Ata e kuptuan se thyerja e murit mbrojtës ishte më efikase se të gjitha policitë, burgjet dhe censurat. Ishte hera e parë në historinë e njerëzimit që po përgatitej varrimi i letërsisë duke u maskuar kjo masakër me lajka dhe me elozhe ndaj saj. Vite me radhë propaganda komuniste, në emër të demokratizimit të letërsisë i bënte thirrje popullit mbarë të merrte pjesë gjerësisht në krijimtarinë letrare e artistike. Kjo propagandë arriti kulmin në fund të viteve 60 me fjalët e Mao Ce Dunit, se letërsia ka nevojë jo vetëm për disa dhjetëra ose qindra por për miliona romancierë. Më haptas se kushdo, më haptas se Lenini dinak, më haptas se Marksi, tirani kinez formuloi dekretin e vdekjes së letërsisë dhe artit. Ai e dinte mirë se një milion romancierë e vdisnin në mënyrë përfundimtare letërsinë më mirë se një milionë xhandarë.

Thirrje të tilla për fat të keq, ngjallën disa herë entuziazëm dhe u duartrokitën nga disa intelektualë këtu në Perëndim. Për ne që jetonim matanë, ishte e pakuptueshme dhe dëshpëruese se si mund të duartrokitesh një politikë kulturore që i detyroi mijëra shkrimtarë të braktisnin mjeshtërinë e tyre, që i çoi mijëra të tjerë në burgje, në orizore ose në çmendinë.

Shtetet totalitare, disa me metoda më të tërthorta e

disa me mjete më brutale, duke dashur të heqin qafe artin e madh, u përpoqën të kthenin në kulturë kaosin primitiv.

Për fat të keq ky nuk është një rrezik që letërsia e ka kaluar. Fatkeqësitë e letërsisë nuk mund të jenë kurrë rajonale, as të varura prej regjimeve politike. Çdo gjë e saj është botërore. Sulmi i mediokritetit, sulmi i oqeanit primitiv ndihet sot më i fortë se kurrë kudo, si në Lindje si në Perëndim. Ajo që kohët e fundit është quajtur "diktatura e parasë", tregohet e pamëshirshme ndaj letërsisë dhe artit të madh, po aq sa makina totalitare e djeshme.

Drama e shkrimtarëve është planetare. Ndaj në vend që një pjesë e tyre t'u japin leksione morale pjesës tjetër, do të ishte mirë të bënin një përpjekje për t'i kuptuar. Sepse kështu ata do të kuptojnë vetveten.

Shpesh herë dukuritë e kësaj bote, sado që në pamje të parë mund të duken të ndërlikuara, kanë përherë një thelb të thjeshtë.

Gjatë mijëvjeçarëve njerëzimi ka krijuar një pasuri shpirtërore të madhe. Ndryshe nga rezervat e naftës e të grurit, kjo rezervë është plotësisht e mjaftueshme për ushqimin e krejt njerëzimit, madje i kapërcen nevojat e tij. Problemi është se rrugët për shfrytëzimin e kësaj rezerve sa vete bëhen më të ngushta.

Njerëzimi i sotëm më fort se kurrë ka nevojë për ushqim shpirtëror. Shkrimtarët bëjnë pjesë në falangën e parë për përgatitjen e tij.

Në këtë optikë historia e mijëra shkrimtarëve që jetuan në botën komuniste përmbledhet në pyetjen e thjeshtë: atëherë kur gjysma e njerëzimit kishte uri, ç'ushqim i dhatë ju?

Përgjigjja në këtë rast s'mund të jetë veçse e thjeshtë:

Në një kohë të errët, kur rrotull tyre gjithçka ishte prishur e degraduar, ata u përpoqën të përgatitnin pak ushqim shpirtëror për bashkëkohësit e vet. Një ushqim të shëndetshëm i cili të pengonte gjithsesi zvetënimin e përgjithshëm.

Dhe çfarë ngushëllimi provuan ata kur konstatuan se ky ushqim, që ata e prodhuan për njerëzit që ishin të burgosur ashtu si ata, u konsiderua i çmuar dhe i shëndetshëm për të gjithë, madje edhe këtu, në Perëndim.

Ju që jetonit në liri, pa kurrfarë mëdyshjeje pranuat të uleshit në tryezën tonë të varfër, për të shijuar ushqimin shpirtëror, bukën e burgut të përgatitur në robëri.

Kjo gjë ishte për ne sadsifaksioni më i thellë, çmimi më i madh që mund të merrnim.

Në këtë akt ne pamë të ridëshmohej edhe një herë e vërteta e madhe se letërsia qëndron mbi regjimet politike, madje, mbi robërinë dhe lirinë, se ajo është unike dhe universale dhe kështu do të jetë në jetë të jetëve.

Ju falemnderit!



## KUR KËRKOHET E DREJTA PËR TË TRADHTUAR

*Intervistë në revistën "ZËRI" të  
Kosovës, më 1997*

*Jetoni prej disa vitesh në Paris. A ndiheni sado pak i shkëputur nga Shqipëria?*

Aspak. Vazhdoj të punoj si më parë. Përderisa krijoj letërsi shqipe, fjala "shkëputje" përjashtohet.

*Vitet e fundit, megjithatë, është bërë si modë zbehja e patriotizmit te shqiptarët. Madje disa intelektualë kanë dalë haptas me teza antishqiptare.*

Vitet e fundit kanë ndodhur shumë shëmtira në Shqipëri. Kjo që thoni ju është e vërtetë: njerëz të ndryshëm për arsye të ndryshme, për të marrë një vizë, një azil politik, një ftesë për mbledhje ndërkombëtare, disa herë për një darkë në një ambasadë të huaj, e kanë shitur vendin e tyre. Këtë e ka bërë vulgu shqiptar, ai që maskohet pas fjalës "popull", por këtë e kanë bërë edhe intelektualët e pabesë. Lidhur me këtë, desha të



shtoja se në Shqipëri e, me sa duket, edhe në Kosovë, ka një abuzim me konceptin "liri" dhe të "drejta". Kërkohen disa herë në emër të tyre gjëra të shëmtuara. Kërkohet e drejta jo vetëm për të mos e dashur, por edhe për ta tradhtuar atdheun.

*Mos vallë kjo zbehje e shqiptarizmit ka lidhje me një farë mode te disa shqiptarë?*

Mendoj se po. Ka shqiptarë që iu duket se mund të bëhen modernë duke e flakur atdheun. Ky është një keqkuptim me të vërtetë tragjik. Ne do të hyjmë në familjen e popujve evropianë si popull dhe jo si elitë intelektualësh. Ashtu siç kanë hyrë edhe popujt e tjerë, me të mirat dhe të këqijat e tyre. Ne do të marrim të mirat e Evropës dhe ndoshta edhe Evropa do të gjejë diçka të mirë e të dobishme tek ne. Mendjet më të ndritura europiane e kanë theksuar një gjë të tillë, pavarësisht nga çasti i keq në të cilin ndodhet kombi shqiptar.

*Jeni shkrimtari shqiptar që më së shumti keni shkruar për Kosovën dhe tragjedinë e saj. Ç'vend zë Kosova në jetën dhe mendimet tuaja?*

Askush nuk mund të mburret se Kosova ka zënë vendin që i duhej në jetën ose veprën e tij. Mendoj se ajo gjithmonë ka marrë më pak se ç'meriton. Kam shkruar dhe botuar vjershën e parë për të 30 vjet më parë, më 1966, kur ishte e vështirë të shkruaje e ta përmendje. Që nga ajo kohë jam përpjekur që ajo të ndihet natyrshëm në veprën time e më shumë në

mendimet e mia. Para tri ditësh kam qenë i lumtur kur romani i shkurtër "Krushqit janë të ngrirë" i shkruar e i botuar pesëmbëdhjetë vjet më parë më mbërriti i botuar në anglisht në SHBA, i përkthyer nga miku i madh i letrave shqipe e i Shqipërisë Robert Elsie.

*Ja, erdhëm natyrshëm te drama e Kosovës. Ka kaq shumë gjëra për të pyetur sa vështirë se do të njaftonin intervista të tëra. Ju jetoni në qendër të Evropës dhe keni shumë kontakte me personalitete europiane. Si shpjegohet moskuptimi i duhur i çështjes së Kosovës nga Evropa dhe SHBA?*

Së pari duhet thënë se çështja e Kosovës s'është aq e injoruar si më parë. Po këtu s'ka vend për kurrfarë euforie. Jemi ende larg njohjes së vërtetë të çështjes, e ende shumë larg kuptimit. Shkaqet janë të shumta: gjysmë shekulli flirt i Jugosllavisë titiste me gjithë Perëndimin përballë gjysmë shekulli izolimi tragjik të Shqipërisë, e kanë dhënë frytin e tyre. Një propagandë intensive serbe, një dizinformim i lemerishëm, përballë një amullie nga ana e jonë. E kështu me radhë, për të vazhduar në gabimet e rënda, iluzionet, kapardisjet, e për të ardhur së fundi te përçarja e mallkuar shqiptare, në Shqipërinë shtetërore e në Kosovë. Megjithatë unë jam vendosmërisht kundër pesimizmit dhe fatalizmit. Të jepesh pas këtyre do të thotë të ngresh duart e të dorëzohesh. Historia e botës dhe e popujve është, përgjithësisht, e rëndë. Fati i Shqipërisë s'është aq i zymtë sa ç'duan ta bëjnë disa.

Të vij te pyetja juaj: Evropa dhe SHBA nuk e kuptojnë siç duhet këtë çështje. Atëherë ç'të bëjmë? Të

ngrihemi e të zemërohem me ta, madje të shajmë e të mallkojmë, siç na propozojnë disa? Kurrsesi jo. Evropa dhe SHBA janë synimi ynë, horizonti, shpresa jonë. Ndryshe, drejt ç'yllnaje tjetër do të orientohemi?

Është fatkeqësi moskuptimi, por atë ne duhet ta kapërcejmë. Ta shpjegojmë hallin tonë, dramën tonë, njëqind herë, njëmijë herë, gjersa një pjesë e saj të arrijë në ndërgjegjen e tyre. Ta përsërisim pa u lodhur të vërtetën tonë, ashtu siç e kanë përsëritur të tjerët gënjeshtrenë e tyre.

*Ka lidhje kjo me këmbënguljen tuaj për informim, për dëshmi të vazhdueshme përpara botës?*

Sigurisht. Gjatë viteve të fundit Jugosllavia e Serbia, për të trullësuar opinionin botëror kanë botuar për shembull mbi 800 libra dhe broshura për Kosovën. Kanë bërë filma, reportazhe, kolokiume të pafundme. Dhe kështu në kushtet e sotme moderne, kur TV luan një rol kolosal për shumëzimin e informacionit, kjo zhurmë kolosale ia ka arritur njëfarësoj qëllimit. Miti i Kosovës, sipas versionit serb, ndonëse folklorik dhe antihistorik, ka arritur te masa e njerëzve që s'kanë mundësi të kenë njohuri të sakta për historinë. Kuptimi i dramës së një populli fillon nga njohja e të vërtetës për të. Ne shqiptarët, sidomos ne intelektualët shqiptarë, akademikët, historianët, gazetarët, shkrimtarët, kemi bërë ende pak për këtë. Tani është koha që kjo të korrigjohet. Është kjo arsyeja që i kam bërë një kritikë frymës së theksuar hermetike e avanguardiste në botimet që bëhen në Kosovë. Ndaj kësaj kritike pati një reagim jo të drejtë. Unë këmbëngul në kritikën time. Në kushtet

e tragjedisë që jeton populli shqiptar, të shfletosh 20 libra e në to, pasi të gjesh njëmijë herë fjalët "orgazmë" e "liri seksuale" e të mos gjesh asnjëherë fjalët "Shqipëri", "Kosovë" apo "liri", për mua është e papranueshme.

*Keni botuar para një muaji në një revistë franceze një tregim për luftën e Kosovës. Mendoni se letërsia artistike mund të jetë po aq efikase për shpërndarjen e së vërtetës sonë?*

S'ka asnjë dyshim. Të gjitha mënyrat, të gjitha mjetet janë të dobishme për të pohuar një të vërtetë. Ju e dini se gjysma e mitit serb mbi Kosovën bazohet mbi betejën e Kosovës. Disa historianë letrarë shqiptarë, në vend që të merren më thelbin e çështjes, kanë shpenzuar shumë energji për të vërtetuar se vrasësi i sulltan Muratit, Millosh Obiliqi, ishte shqiptar. Më është dukur përherë një kotni kjo gjë. E para, se s'ka kurrfarë rëndësie se ç'kombësi ka patur njeriu që thuhet se goditi pas shpine një mbret. E dyta, se vdekja e sulltan Muratit mbetet një vrasje misterioze, që me sa duket, s'është bërë fare prej ballkanasve. Kryesorja në betejën e Kosovës nuk është kombësia e vrasësit, por fakti që në këtë betejë, për të cilën po bëhen kaq shumë spekulime, nuk kanë qenë vetëm serbët, por një aleancë e gjërë ballkanike që ka luftuar kundër osmanëve. Të ngulësh këmbë te kombësia e mbretvrasësit, kjo është njëjloj që si një lypsar të kërkosh një të vërtetë të mohuar. Për të vërtetuar se shqiptarët kanë qenë ndër aleatët kryesorë ballkanas në këtë betejë, s'ka nevojë për vrasësin e hamendsuar të sulltanit. Pjesëmarrja

shqiptare vërtetohet nga të gjitha librat serioze të historisë, nga të gjitha kronikat e dëshmitë.

U zgjata te pyetja e juaj, me që kam përshtypjen se disa herë intelektualët shqiptarë, të drojtur se mos fajësohen për nacionalizëm, duket sikur rrijnë të paralizuar përballë trysnisë së opinionit ndërkombëtar. Parimi im është i thjeshtë: kur je i bindur se ke të drejtë, asnjë opinion a paragjykim evropian qoftë, botëror, apo po deshët kozmik, s'mund të të bëjë të sprapsesh.

*Jeni i përkthyer në mbi 30 gjuhë dhe i botuar në mbi 40 shtete. Me rastin e pranimit tuaj në Akademinë Franceze ju cilësuan si "njëri prej krijuesve më të mëdhenj të botës". Si shpjegohet vonesa e çmimit Nobel për letërsi, që më shumë se për ju vetë, është i rëndësishëm për kombin shqiptar?*

Fraza juaj e fundit e ka brenda përgjigjen. Çfarë i është dhënë me bujari dhe në kohën e duhur kombit shqiptar, që t'i jepet edhe çmimi Nobel?

*Cili ka qenë dëshpërimi juaj më i madh?*

Marsi i këtij viti, kur shteti shqiptar u rrëzua për tridhjetë orë. Në shqipen e vjetër është një shprehje "dita e moskurrit". Besoj se kështu do të kujtohet, si ëndërr e keqe nga gjithë shqiptarët.

*Keni këmbëngulur për mbrojtjen e dinjitetit të vlerave shqiptare. Jeni shprehur shumë herë kundër racizmit antishqiptar e sidomos kundër racizmit kulturor. Mendoni se ky racizëm vazhdon?*

Mendoj se po. Kur themi racizëm nënkuptojmë një reaksion që vjen nga jashtë, nga një tjetër racë. Racizmi kundërshtuar ka një karakteristikë të veçantë se ndihmohet pabesisht nga vetë shqiptarët. Kam folur mjaft për këtë e s'dua të zgjatem. Kur mbroj vlerat e kombit që i përkas kjo s'do të thotë se nuk ia njoh, madje nuk ia denoncoj veset. Por të shkallmoh gjithçka duke nisur nga gjuha shqipe, ta përqeshësh atë që është ndër shtatë-tetë gjuhët themelore të Evropës, (e kjo nuk është fantazia ime, por ekziston prej disa shekujsh në të gjitha tekstet serioze të gjuhësisë), kjo është për të vënë vajin. Dhe këtë e bëjnë intelektualët e shitur shqiptarë. E natyrisht me ta bashkohen pastaj ca horra të huaj, ata që s'i njeh kush në vendin e vet, e që vijnë të bëhen arbitra në kulturën shqipe.

Dua të më kuptoni drejt: unë e di fare mirë ç'është euforia nacionaliste, patriotizmi mburravec e folklorik, unë e di fare mirë se një popull është i qytetëruar kur kultura e tij godet dhe qorton mungesat dhe veset e tij. Unë i njoh fare mirë mungesat e popullit që i përkas: kapardisjen e padurueshme shqiptare, etjen për t'u dukur, smirën, prirjen për përçarje e gjer tek ajo më e rënda e shfaqur kohët e fundit: prirjen iracionale për shkatërrim. Por unë i njoh, gjithashtu, veset e popujve të tjerë, lemeritë që kanë kryer, krimet, vogëlsinë shpirtërore dhe cinizmin. Është kjo që më bën të kem një vizion të qartë të përgjithshëm të kësaj çështjeje.

Që të mos zgjatem, po sjell një shembull mjaft rrokshëm, që e lexova dje në gazetën "Rilindja". Një italian, a italo-gjerman me emrin Benvenuto, ka botuar një vargan shpifjesh për Shqipërinë në shtypin gjerman.

Ja ç'shkruan në fragmentin e përkthyer nga gazeta në numrin 26 shtator 1997. "Më 1992 në Tiranë mbi 80 përqind e banesave kishin një vrimë në dysheme në vend të nevojtores".

A e dini sa i kushton popullit shqiptar një shpifje e tillë e neveritshme e bërë nga ky horr italian? Është një trillim i pabesë, nga ato që i mbeten në mendje lexuesit. Dhe lexuesi ka të drejtë të mendojë: ç'është ky popull barbar e pa kurrfarë dinjiteti, që as në kryeqytetin e vet ende nuk e njeh elementin e parë të qytetërimit njerëzor? Dhe thirrja e fshehtë e këtij palaçoje nga Italia është: ç'merreni me një popull të tillë? Lëreni në mjerim, lëreni të ngodhë urie, ta godasë kamxhiku i serbit, sepse ai nuk meriton fat më të mirë. Shpifje të tilla i paguajnë veçanërisht shtrenjt refugjatët shqiptarë, kudo që ndodhen. Ndaj, shkrime të tilla mbajnë erë krim.

*Ky është problem delikat, me të cilin po ndeshet edhe kultura shqiptare në Kosovë. Ka studiues të huaj që merren me kulturën e letërsisë shqipe si për shembull Elsie, që e përmendët ju, që ka një qëndrim koherent. Por ka të tjerë, si Lanksch, që me qëndrimet e tyre të paqarta kanë zgjuar polemika, sidomos në shtypin e Kosovës. Besoj se e keni parë se ky i fundit aq sa i lavdëron disa shkrimtarë, aq i urren të tjerët. A e quani çorientuese këtë?*

Natyrisht që është çorientuese, madje, më keq. Kur je mik i një kulture e letërsie, duhet të kesh argumente që të pranosh një pjesë të saj e të hedhësh në ballë pjesën tjetër. Në qoftë se nuk ke argumente, por ke vetëm pasione të errëta, atëherë shko e merru me kulturën tënde.

I them këto se ky farë studiuesi a përkthyesi që përmendët ju, ndërsa lavdëron për shembull disa shkrimtarë, brenda e jashtë kufirit, vjell një vrer të hidhur për gjithë të tjerët. Natyrisht që çdo njeri mund të pëlqejë disa shkrimtarë e të mos i dojë të tjerët. Por të deklarosh, siç ka bërë i lartpërmenduri, se letërsia shqipe e periudhës komuniste duhet të dënohet njëlloj si letërsia naziste, kjo është cinike dhe raciste. Askush nuk e ka fajësuar popullin shqiptar, rrjedhimisht kulturën e tij të gjysmës së dytë të shekullit për kriminalitet nazist. Atëherë ku e gjen guximin ky gjerman arrogant për një shëmti të tillë? Unë do të vazhdoja pyetjen: guxon ky njeri ta quajë naziste letërsinë sovjetike, apo hungareze apo gjermanolindore të të njëjtës periudhë? Natyrisht që s'guxon. Por kundër Shqipërisë së vogël këta tipa ndihen trima. Dhe nxjerrin kthetrat. Këtu desha të përsëris një mendim lidhur me disa letrarë të Kosovës që kohët e fundit e kanë bërë zakon të shajnë e të përqeshin letërsinë shqipe. Këtu dua të përsëris se ata letrarë të Kosovës që sulmojnë të njëjtët shkrimtarë shqiptarë, që sistematikisht i sulmon Beogradit shovinist, s'mund të kenë tjetër cilësim veç si shërbëtorë të Beogradit.

*Ndonëse ju kanë lodhur me pyetje të natyrës politike, do të më lejoni t'ju bëj vetëm një pyetje të tillë. Jeni deklaruar disa herë i paanshëm në luftën politike në Shqipëri. A mund të na thoni diçka më shumë?*

Skajimi im i paanshëm rrjedh natyrisht nga letërsia. **Shkruaj libra për të gjithë shqiptarët, përpiqem të bëj**



çmos që shqiptarët të afrohen sa më shumë, të përçahen sa më pak. Mendoj se në luftën politike në Shqipëri doza e pasionit dhe e verbërisë partiake është tepër e lartë. Dhe kjo e errëson vizionin e klasës politike, çka është fatale për këtë klasë dhe për vendin.

Qëndrimi im në këtë pikë është i pandryshueshëm. Shumë spekulantë politikë kanë dashur ta keqinterpretojnë sipas interesit të partisë së tyre, por koha po e tregon se kam patur të drejtë. Kur demokratët ishin në fuqi jam shprehur gjithmonë për respektimin maksimal të opozitës, duke i bërë thirrje kësaj të fundit të mos jetë rrënuese por ndërtuese. Të njëjtin qëndrim e kam tani që rolet kanë ndryshuar në Shqipëri. Unë nuk ëndërroj një idil midis pozitës dhe opozitës, por një mirëkuptim për gjërat themelore duhet të ketë se s'bën. Shqipëria s'mund të ketë jetë pa mirëkuptim e bashkëjetesë. Ndërkaq po ndodh e kundërta: të dy palët vazhdojnë të jenë të egërsuara në mënyrë të pafalshme. Të dyja palët gëzohen për disfatat e njëra-tjetrës, pa u kujtuar se këto janë disfata të Shqipërisë. Shteti i sotëm shqiptar është i detyruar ta respektojë gjer në fund opozitën, që e humbi pushtetin. Nga ana tjetër do të doja t'u thosha opozitarëve shqiptarë, midis të cilëve kam shumë miq, të mos e pengojnë aksionin e qeverisë. Opozita duhet të gëzohet që qeveritarët e sotëm të kryejnë disa punë të mbara në Shqipëri: të normalizojnë jetën, të vendosin rendin, të ngrënë sistemin bankar, rrugor, apo të rregullojnë ujën e rrjetin elektrik. Të gjitha këto do të jenë në dobi të tyre kur një ditë, sipas ligjeve të rotacionit e të demokracisë do të vijë në pushtet. Kështu duke u vënë në garë për t'u kujtuar për të mirë e jo për të keq, do ta çojnë përpara këtë vend të sflitur.

Përndryshe do t'i përgatitin katastrofën. Kombi shqiptar kudo që ndodhet, duhet të gjejë mënyrat për ta detyruar klasën politike shqiptare të kthjellohet nga mendja e të çlirohet nga helmi.

*Përpara se ta përfundojmë intervistën më lejoni të kthehemi te plaga që na dhemb aq shumë, te Kosova. Keni po atë mendim të mëparshëm për eksodin shqiptar?*

Po. I kuptoj të gjitha hallet ekonomike të njerëzve, i kuptoj të gjitha brengat e tjera, por zbrazja e Kosovës nga rinia s'duhet të ndodhi. Kjo zbrazje ka qenë dhe mbetet ëndrra kryesore e shovinistëve serbë. Ëndrra shqiptare duhet të jetë e kundërt me të. Para ca ditësh lexova në gazetën "Rilindja" se partitë politike në Kosovë tregohen disi shpërfillëse me këtë problem, që është problem jete ose vdekjeje. Kjo s'duhet të ndodhi kurrsesi. Sa për agjencitë që merren me shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova, ato duhen konsideruar si agjenci që merren me shitje skllëvërish. Sepse, siç kam lexuar në shtypin kosovar, i përdorin të gjitha mjetet për të mashtruar njerëzit e gjorë. Ndaj dhe meritojnë çdo ndëshkim.

*Mendoni se mungesa e tolerancës është gjithashtu e fortë në Kosovë midis shqiptarëve?*

Besoj se është e ndjeshme. Kam vënë re se me shumë lehtësi etiketohen njerëzit: që nga cilësimi si "tradhtar" i dikujt që duket i përmbajtur, gjer te cilësimi si "terrorist" i atij që është fort i vendosur. Në një lëvizje

ka gjithmonë shumë nuanca sjelljeje, ashtu si në lumë që derdhen shumë rrëke. Po lumi, ndaj është lumë, sepse i çon të gjitha ujërat në një drejtim.

*Kërkoni gjithmonë të jepni mesazhe shprese. Besoj se do të dëshironit ta mbyllnim këtë bisedë me një mesazh të tillë.*

Është e vërtetë. Unë besoj në të ardhmen e shqiptarëve e të të gjithë kombit shqiptar. Kur njeriu është i mërzitur, në mënyrë të vetvetishme sjell në kujtesë gjëra shpresëdhënëse. Në çaste të tilla në mendjen time më së shpeshti vijnë studentët shqiptarë, kudo ku ata ndodhen, e veçanërisht studentët e Tiranës, të Prishtinës e të Tetovës. Ndër ta është drita e së ardhmes, energjia e nevojshme, trupi dhe shpirti e saj. Ata janë befasimi i bukur i Shqipërisë.

Paris, 28-29 shtator 1997  
Bisedoi Musa Jupolli

## PËR KË PUNON KOHA

*Intervistë me gazetën "Sheshi" të  
Kosovës, 18 korrik 1998*

*Zoti Kadare, a pajtoheni që këtij bashkëbisedimi t'ia nisim me Kosovën? Ju jeni autori që më së shumti i ka dhënë Kosovës. Kosova nuk e harron "Baladën e J.G.-së", as "Krushqit janë të ngrirë" as esetë e bukura të "Ftesë në studio", qindra artikuj dhe intervista, ku ju e merrni në mbrojtje kauzën e saj... "*  
*...Fjala "Kosovë" shqiptohet përherë me kursim, me zë të ulët, gati me pëshpërimë. (...) Kështu përmendet në Konferencat ndërkombëtare, në mbarim të ndonjë lajmi, në fund të ndonjë interviste: përherë shkarazi, përherë pak. Ka qëlluar që kancelaritë evropiane, ose politikanët e kanë thënë hapur: kujdes me Kosovën! Kujdes që të mos i nxitim shqiptarët të lëvizin. Që të mos i nxitim serbët të nisin masakrën..." - thoni ju Ismail KADARE, në parathënien e librit me intervista të Dr. Rugovës.*

*Përse mbahen kështu shqiptarët duarlidhur, vallë të shkon mendja në ndonjë komplot ndërkombëtar kundrejt botës dhe qenies shqiptare apo ç'drejin e ka*

*lidhur kështu fatin tonë nyje?*

Nuk besoj as në komplot, as në fat të keq. Ndërkaq, fjalët e rënda komplot ose fat mund të kenë po atë vlerë mohuese që ka fjala "imazh i keq". Shqiptarët mbahen të rrudhur e të tkurrur kështu për një sërë faktorësh. E para, se ata vetë, s'kanë bërë aq sa duhet, për të dalë nga kurthi ku kanë rënë. Së dyti, se vazhdojnë të jenë pa miq e mbrojtës tradicionalë. Së treti, se në kushtet e botës së sotme, ku mediat elektronike, në radhë të parë, luajnë një rol të dorës së parë, Shqipëria bashkë me shqiptarët vazhdon të ofrojë një imazh të keq, të pafavorshëm. Ky imazh ushqehet nga paragjykime të vjetra e të reja: njerëz pa kulturë, të prirë për përçarje, që nuk e njohin rregullin shtetëror, që janë kontrabandistë droge, shitës vajzash, grykës dhe atdhemohues. Virtytet tradicionale, si dhe vlerat shqiptare: mikpritja, dinjiteti, kujtimet historike, gjuha, që është ndër gjuhët themelore të Evropës, dhe letërsia shqipe, që ka hynë në klubin e letërsisë të madhe evropiane, mezi e përballojnë sulmin e imazhit të keq të Shqipërisë. Ato korrigjojnë natyrisht shumë gjëra, por veprimi i tyre s'mund të jetë çudibërës. Korrigjimi i imazhit është vepër e përbashkët e një kombi.

*Ju njiheni si njeriu që bërtiti e mallkoi që më 1990 të mos braktiset Kosova, të mos përkulet kosovari, por të përballë me dinjtet sfidën e lirisë. Mirëpo një intervistë që ju i dhatë TVSH-së në pranverë të këtij viti duket se shkaktoi njëfarë pezmi në Kosovë, ngase Ju hapur thirrët që shqiptarët të demonstrojnë, të protestojnë hapur për shkollat, liritë*

*dhe dinjitetin e tyre të nëpërkëmbur, të shkunden nga frika se do t'i farojë Beogradi... Më duket sikur edhe regjimi i atëhershëm i Berishës që kishte zënë një aleancë me zotin Demaçi ju ka instrumentalizuar Juve për qëllime ultrapolitike, bashkërisht kundër "kolosit të brishtë", zotit Rugovës? Pastaj ndodhën "skemat piramidale" që rrënuan marramendthi shtetin shqiptar dhe thirrja juaj u kuptua në Prishtinë si përpyekje e Berishës për ta spostuar zjarrin në gropën që vlon të Kosovës, për ta spostuar vëmendjen e opinionit shqiptar në Kosovë që ta shpëtojë piramidën e vet pushtetore? Na thoni ju, zoti Kadare, si ndodhi kjo?*

Në intervistën time në TVSH për Kosovën, në fillim të vitit 1997, kam thënë po ato gjëra që i kam shprehur edhe më parë, që prej dy-tre vjetësh. S'kam pasur asnjë dijeni për atë ankth që flisni ju. Ka mundësi që shteti shqiptar, duke i ditur, ashtu si kushdo mendimet e mia, të ketë dashur t'i shfrytëzojë ato për interesat e veta. Por për mua kjo s'ka shumë rëndësi. Çdo shtet e ka bërë dhe vazhdon ta bëjë këtë. Kryesorja ishte që unë as i ndryshova mendimet e mia e as i adoptova ato. Ishte shteti shqiptar ai që erdhi, ose bëri sikur erdhi, te të njëjtat mendime. Në këtë rast, unë, edhe sikur të dyshoja se këtu ka një dredhi, nuk mund të bëja trille e të ndryshoja mendje për shkak të shtetit. Ajo që thashë për Kosovën ishte e drejtë. Kjo është kryesorja. Sa për drojën se Kosova rrezikonte të flijohej, ngjarje që ndodhën pak kohë më pas, lëvizja studentore, shfaqja e UÇK-së, mendoj se s'ishin shenja të flijimit të Kosovës, por të rilindjes së saj.

*Pastaj një zyrë e LDK-së ju sulmoi vrazhdë. Fjalët rrodhën në një tabloid shqiptar se ideator dhe autor i atij teksti denigrues, ku ju shpalleshit oborrtar i ish-regjimit tiranik, ishte shkrimtari Sabri Hamiti. Ju, duket, me zemërim iu vërsulët zotit Hamiti dhe asaj zyre (Qendra Informativ e Kosovës) me një vokabular hiç më të urtë dhe tolerant?*

Habitem sinqerisht se si ju ka bërë përshtypje përgjigjja ime, prej disa rreshtash, kundër një klani dhe kundër një zyre në Kosovë. Kur një shkrimtar, i cili bën çmos për të mbrojtur Kosovën dhe çështjen e saj, sulmohet pabesisht nga një klan dhe një zyrë e Kosovës, mendoj se përpara se të shqetësohemi për përgjigjet e shkrimtarit, duhet të brengosemi për të kundërtën: si është e mundur një mbrapshti e tillë? Ç'është ky sulm pervers! Nga ç'shkak vjen? Unë jam qenie njerëzore dhe është normale të revoltohemi nga e keqja. Ata që s'e kanë këtë cilësi, mendoj se janë të gjymtë. Mosrevoltimi nga e keqja, pranimi i fyerjes, i robërimit bëjnë pjesë në psikën e skllavit. Ju e quani përgjigjen time jotolerante, "hiç të urtë". E unë po ju them se nuk jemi këtu në një konkurs urtësie pleqsh, por në një gjendje dramatike.

Sa për tolerancën, meqënëse kjo lidhet me një çështje shumë më të gjerë, më lejoni të zgjatem pak. Toleranca bën pjesë, pa dyshim në vlerat më sublimë të njerëzimit. Por, siç ndodh shpesh me vlerat sublimë si liria, demokracia etj., me tolerancën bëhen abuzime nga më monstruozet. Ky abuzim, ky keqkuptim tragjik ndodhi në Shqipëri, pas rënies së komunizmit. Në kaosin e krijuar, midis pluhurit që u ngrit nga shembja, një

pjesë e njerëzve kujtuan, ose u pëlqeu të kujtonin se tani, bashkë me lirinë erdhi toleranca absolute. Me fjalë të tjera: s'ka vlerë të qëndrueshme, çdo gjë lejohet. Skenar më katastrofik për të rrënuar një komb, vështirë se mund të mendohet. Pyetja vazhdon të shtrohet kudo: vërtet duhet të lejohet gjithçka?

Para ca kohësh, rasti e solli të polemizoj në bisedë me një botues kosovar lidhur me botimin prej tij të një libri kundër Skënderbeut. Me një buzëqeshje prej njeriu modern, përpara një njeriu jotolerant, më tha se secili ka të drejtë të shkruajë si të dojë, ngaqë bota sot është e tillë, tolerante etj., etj. Botuesi i mjerë kosovar hiqej se i shërbente kulturës moderne shqiptare e s'bënte gjë tjetër veçse i shërbente tradhtisë. Asnjë vend i qytetëruar nuk lejoi sulmin kundër themeleve të veta. E kam thënë dhe e përsëris se vitet e fundit në Shqipëri dhe në Kosovë u bë një përpjekje për të përligjur tradhtinë. Shkurt, në emër të tolerancës, të shkeljes së tabuve, në emër të të drejtave njerëzore, disa shqiptarë kërkuan të drejtën për të tradhtuar atdheun e vet. Bota e qytetëruar nuk e njeht një të drejtë të tillë. Tradhtia dënohet kudo dhe ky dënim bën pjesë në themelet e qytetërimit evropian dhe botëror. Mirëpo "modernët" tanë e quajtën këtë "tabu që duhet të shkelet". Është kjo ide e mbrapshtë që i nxiti disa ushtarë shqiptarë, të cilët bënë shërbimin stërvitor në SHBA, të arratisen ditën e fundit nga kazerma, për të kërkuar strehim politik. Sepse me ata tru të degjeneruar që kishin kujtuan se amerikanët do t'i praninin. Natyrisht amerikanët i kapën dhe i futën në burg si dezertorë, pra si tradhtarë të neveritshëm. Një gazetë e madhe amerikane e përshkroi këtë si një gjë që ndodhte për herë të parë me ushtarët e huaj në SHBA.



Ajo e paraqiti ngjarjen si njollë të zezë për kombin shqiptar. Kurse shtypi shqiptar dhe ai kosovar, nën ndikimin, me sa dukej, të klimës "tolerante" ndaj tradhtisë, heshtën. Unë shpresoj, më lejoni ta përsëris, se kjo sëmundje, kjo murtajë e zezë, kjo teori, kjo doktrinë e tradhtisë, që u përpoq të vinte në gjuhë kombin shqiptar do të kalojë, siç kalojnë gjithë lëngatat. Lëvizja studentore në Prishtinë, e sidomos dalja në skenën shqiptare e UÇK-së, përveç rolit kolosal historik, dëshmitarë të të cilit jemi të gjithë, bëjnë pjesë qysh tani në historinë morale të kombit shqiptar. Kur një popull ndodhet në gjendjen e një grigje të pambrojtur përballë ujkut, ëndrra e tij më sublimë është shfaqja e një shpëtimtari, e një dalzotsi. Kur populli i Kosovës u gjend kështu, grigjë e pambrojtur përpara kasapit serb, UÇK-ja u bë dalzotse e tij. Disa mund të mos jenë në një mendje me disa ide të saj, me stilin e deklaratave, me mënyrën e nderimit etj. etj., por askush s'mund t'ia heqë dot kurrë asaj emrin e madh "dalzots".

Kjo lëvizje kohët e fundit në Kosovë, ky trazim, kjo furtunë, kjo ushtri, dëshmuar se populli shqiptar, pavarësisht nga gabimet që ka bërë, pavarësisht nga cenet, nga vonesat, nga keqkuptimet, nga zvetënimimi i një pjese të tij, ruan në thellësitë e veta aftësi të pashtershme regjenerimi. Kjo përbën bazën e shpresës sonë për këtë popull

*Kohë më parë patëm rastin të lexojmë një shkrim po aq të ashpër kundër jush nga Anton Berisha, që ishte edituar përmes rrjetit Internet, ku ju akuzoheni për ndalimin e librave. Në fakt, ky autor ju akuzon me një mallkim historik: nëse ua falin mëkatit autorët*

*shqiptarë si Trebeshina, si t'ua falë një Kafkë, Prust apo Dostojevski? Vërtet a keni mundur ju ta influenconi dhe ta emanciponi me fuqinë tuaj intelektuale regjimin e atëhershëm tiranik që të qarkullojë i lirë libri "dekadent", "imperialist" etj., edhe në botën shqiptare?*

Njeriun që përmendni ju, as e njoh, as e kam lexuar. Në qoftë se ai shkruan se unë paskam ndaluar libra në Shqipëri, ai është një shpifës ordiner. Dhe kjo, siç do ta shpjegoj më poshtë, është akuza më e lehtë që mund t'i bëhet.

Së pari, desha të them se librat e Trebeshinës janë ndaluar në Shqipëri më 1952, kur unë isha 16 vjeç, nxënës shkolle në Gjirokastrën e largët. Po aq absurde është çështja e ndalimit të Kafkës, Prustit e Dostojevskit. Duhet të jesh budalla ose të hiqesh si i tillë, për të mos e kuptuar se asnjë shkrimtar s'kishte fuqi as t'i lejonte, as t'i ndalonte autorët "dekadentë" sepse këtë gjë e kishte bërë shteti shqiptar në mënyrë të përkryer qysh më 1945, (atëherë unë isha 9 vjeç). Ashtu siç e kishte bërë gjithë perandoria komuniste. Është një e vërtetë e njohur gjerësisht se ndalimi i letërsisë "perëndimore-dekadente" ishte në themelet e politikës kulturore të krejt vendeve të Lindjes.

Të kthehem i te shpifësi kosovar që përmendni ju. Vërtet kaq naiv të jetë ky kritik letrar sa të mos i dijë këto të vërteta që dihen tashmë nga gjithë bota? Vërtet ai shpif pa dashur, për mungesë informacioni, apo shpif me dashje, pra me një synim të caktuar?

Përgjigjja ime, pavarësisht se ju mund t'ju duket "intolerante" dhe "hiç e urtë" është kjo: ai shpif me

dashje, dhe do t'jua vërtetoj.

Ky letrar ka të drejtë të mos pëlqejë asnjë nga librat e mia, asnjë nga mendimet e mia, asnjë nga aktet e mia. Por ai s'ka të drejtë të shpifë. Ju e dini, po aq mirë sa unë, se shpifja është e dënueshme sidomos moralisht. Të shpifësh për një shkrimtar të shquar të një populli është një krim. Të përpiqesh të rrëzosh pa asnjë të drejtë përfaqësuesit e kulturës së një kombi do të thotë të synosh të dobësosh moralisht atë komb. Në kushtet dramatike në të cilat ndodhet kombi shqiptar, kur ai më fort se kurrë ka nevojë për kurajo dhe besim, kjo rëndohet edhe më shumë.

A është kaq i painformuar ky kritik nga Kosova, që përdor edhe Internetin, sa të mos e dijë se shkrimtari I. Kadare, të cilin ai nuk e do, vetëm kohët e fundit ka dhënë mbi dyqind intervista në rrjetet radio-televizive dhe gazetat e mëdha të botës, nga SHBA në Japoni, dhe se në këto intervista tetëdhjetë përqind është folur për çështjen e Kosovës, për mbrojtjen e saj? A nuk ka parë, ose nuk ka dëgjuar ky pседонаiv se pikërisht për këtë ndikim në opinionin ndërkombëtar shkrimtari I. Kadare është bërë tepër i bezdisshëm për Beogradin, ndaj ky ka vënë në veprim kundër tij gazetat e veta, shërbëtorët e vet, që nga shpifësit serbë, te ish miqtë e huaj të titizmit e gjer te priftërinjtë ortodoksë francezë? Në këto ditë të vështira për të Beogradi ka mobilizuar tërë lakejtë e vet për t'u mbrojtur. Në këto rrethana, shërbëtorët e tij shqiptarë janë, pa dyshim, më të çmuarit. Për të neutralizuar mendimin e shkrimtarit shqiptar I. Kadare, shërbëtorët shqiptarë janë me të vërtetë flori. E shihni, bërtet Beogradi, vetë shqiptarët, madje vetë kosovarët janë kundër këtij shkrimtari

shoviniist, shqiptaromadh, e këtij arroganti, që paska ndaluar depërtimin e letërsisë evropiane në Shqipëri!

Fakti, që, siç thoni ju vetë, shkrimin e tij, shpifësi nga Kosova e shpërndan kudo në botë nëpërmjet Internetit, tregon qartë qëllimin e shkrimit. Duke dashur të asgjësojë moralisht shkrimtarin I. Kadare, mesazhi i shpifësit nga Kosova, drejtuar opinionit ndërkombëtar është i qartë: Mos i besoni në asgjë shkrimtarit I. Kadare. Rrjedhimisht mos i besoni kur flet për Kosovën, për masakrat, për tragjedinë, për mitin serb!

Ju duket "hiç e urtë", po të them se një punë e tillë mund ta bëjë vetëm një Judë? E unë mendoj se Juda duhet të quhet Judë. Dhe ndëshkimi i Judës bën pjesë në themelet e qytetërimit botëror.

*Së voni, më dukej sikur ishit paksa të thyer dhe të dëshpëruar. Megjithatë Shqipëria edhe pse në "komë", duket se e ka mbijetuar rrezikun e vdekjes, ndërkaq Kosova sërish po vlon. Studentët paralajmëruan kryengritje. Ju thatë se Kosova duhet të përpiqet e të përballet vetë, e vetmuar, që vetë ta arrijë jetësimin e ëndrrës së lirisë. A thua, e la Shqipëria të vetmuar midis malit dhe lehjeve, në natën me shtrëngatë, a thua do mundet të ecë në këmbë të veta Kosova e martirizuar?*

Asnjëherë nuk e kam menduar Kosovën të vetmuar. E as Shqipërinë. Madje kam thënë shprehimisht se duhet të përjashtohet e të dënohet moralisht jo vetëm çdo ndjenjë ndarjeje, ide ndasie, por edhe çdo tundim për rivalitet.

Për fat të keq, të dyja kanë ndodhur kohët e fundit.

Njëfarë ftohtësie e shkaktuar nga përkitja, pas një ndarjeje të gjatë, ishte diçka që edhe mund të pritej. Ishte zhgënjimi i përplasjes, i njohjes së bëftë pas gjysmë shekulli nostalgjie. Të dyja palët, në mënyrë iluzore e përfytyronin më të sublimuar njëra-tjetrën. Ishte pak a shumë ajo që ndodhi në Gjermani, pas rënies së Murit të Berlinit. Pas ndezullisë së javëve të para erdhi nervozizmi, pastaj ftohja.

Një dukuri e tillë, e dëmshme për çdo popull, bëhet dyfish, trefish dëmprurëse te populli shqiptar, për të cilin ndarja i është bërë një fat i keq që nuk i ndahet. Gjithë strategjia kundërshtqiptare është bazuar në përçarjen e tij. Gjeopolitika e sotme që dëshiron të përjetësojë copëtimin e Shqipërisë, përpiket të vetëjustifikohet me këtë vetëhipnotizim. Diplomatat, gazetarë, ministra, duke shqyer sytë pa pikë turpi thonë: atëherë ju shqiptarët kërkonit të jetoni bashkë?! Thua se të jetojë bashkë një popull qenka gjëja më e panatyrshme, më skandaloze, më e rrezikshme në këtë botë.

Të ndërgjegjshëm për këtë moskuptim tragjik nga ana e të tjerëve, ne shqiptarët duhet të bëjmë çmos për të vërtetuar të kundërtën.

Nuk përfytyroj ndonjë unitet idilik, por mendoj se edhe kjo xanxarë përçarjeje mund të frenohet. Që të kthehemi te thelbi i rrokshëm i çështjes: mendoj se duhet bërë çmos që së paku të marrin fund përçarjet e shëmtuara partiake, kur është fjala për çështje kombëtare. Të mos përsëriten më turpet e shtypit shqiptar ose të shtypit kosovar lidhur me to. Besoj se e dini se kur në Kosovë filloi qëndresa e armatosur, gazetarë të papërgjegjshëm të Tiranës, këta provincialë

të kompleksuar, që duan të hiqen me çdo kusht modernë e evropianë, e quajtën atë qëndresë folklorizëm, nga që këndohen me lahutë, të destinuar të dënohen "nga superushtria serbe"! Nga ana tjetër, letrarë po aq të kompleksuar të Kosovës, filluan të shfaqin një mllef e një dil të të dal (karshillëk) të çuditshëm kundër Shqipërisë, duke thënë se kryesorja është Kosova e pastaj vjen Shqipëria, e marrëzira të tjera si këto.

Mendoj se për këto duhet një NDAL i madh. Një NDAL i padiskutueshëm. Një STOP, nga ata prej të cilit është mirë që njeriu të ketë frikë!

*Kryengritja e studentëve në Prishtinë, në dhjetor '97 dhe pranvera kosovare '98 thatë se shqiptarëve ua ktheu dinjitetin e nëpërkëmbur. Pastaj Kosova, në Drenicë e Deçan, në Klinë, Gjakovë e Pejë u ngrit ta mbrojë veten. Ju i keni parë pamjet nga masakra serbe në Prekaz, ku vriten fëmijë e gra shtatzëna, pleq e burra për ta tmerruar Kosovën. A ju duket se perëndimi sërish po ia lë duart e lira serbit në Kosovë? Si e shpjegoni shpërfilljen perëndimore karshi krimit serb në Ballkan?*

Është e vërtetë se Perëndimi për një kohë të gjatë u tregua i verbër e i shurdhër ndaj dramës shqiptare. Kjo verbëri e shurdhëri është ndihmuar nga një sërë faktorësh që vështirë të analizohen në kuadër të një interviste. Popullit shqiptar iu desh të paguajë e do t'i duhet ende të paguajë vetizolimën kriminale të Shqipërisë zyrtare komuniste për gjysmë shekull. Një ndarje kaq e gjatë e kaq këmbëngulëse nga Perëndimi s'mund të kalonte kaq lehtë. Nuk përjashtohet një hakmarrje

subkoshiente e këtij të fundit, ndaj vendit që vulli aq shumë vrer kundër botës evropiane-atlantike. Më kujtohet para ca vjetësh kur Shqipëria do të vendoste marrëdhënie diplomatike me Spanjën, zyrtarët spanjollë erdhën të trishtuar në Shqipëri ngaqë në dosjet e Ministrisë së Jashtme spanjolle Shqipëria figuronte si vendi që kishte nxjerrë më shumë helm se kushdo kundër Spanjës. E kështu kundër SHBA, e kështu kundër Izraelit, e kështu kundër Vatikanit, e kështu kundër gjithë botës së qytetëruar. Kur ndeshesh me fakte të tilla, s'ka se si të mos kesh dëshirë të ulërish: shtet i mallkuar, si është e mundur të gatujë një prapësi të tillë kundër interesave të popullit tënd. Si është e mundur që u ndave për së gjalli nga ajo që është bota jote dhe u lidhe me radhë me serbët, me sovjetikët, me kinezët, me Pol Potin, me drejtin e me të birin.

Nga ana tjetër, popullit shqiptar, jo për faj të tij, iu desh të mbajë mbi shpinë rrjedhojat e flirtit të vazhdueshëm të Jugosllavisë me Perëndimin. Sa më shumë lulëzonte ky flirt, aq më në terr zhytej fati i shqiptarëve, sepse kërkesa numër një e jugosllavëve për çdo idil të mundshëm me gjithkënd, ishte qëndrimi mohues, asgjësues kundër shqiptarëve.

Ju e dini se diçka themelore ka ndërruar në këtë histori. Diçka e pabesueshme vazhdon të zhvillohet në sytë tanë. Kahjet po ndryshohen. Shqipëria dhe Kosova bashkë me të, ashtu me vështirësi, ashtu midis keqkuptimeve, krimin dhe gjakut të derdhur, dalngadalë, me këmbëngulje po zhvendosen për t'u skajuar në botën ku e kanë vendin, në pjesën e mbarë të botës, në Perëndim. Kurse Serbia lëviz në kah të kundërt. Është ajo që po shkon drejt prapësisë: drejt barbarisë

bolshevike, drejt izolimit, drejt krushqive që Shqipëria i ka braktisur me tmerr, me fjalë të tjera, drejt prapësisë. Shprehja "na morën të keqen! "asnjëherë s'ka qëlluar kaq e saktë. Serbia po ia merr të keqen Shqipërisë. Këtë duhet të dimë ta çmojmë të gjithë. Dhe si çdo gjë duhet ta mbrojmë.

Në këtë këndvështrim mendoj se duhet të jemi të përmbajtur përpara se t'ia lëshojmë mallkimin Evropës dhe përgjithësisht Perëndimit. Shumë gjëra kanë ndërruar në Perëndim dhe ne duhet të dimë të shikojmë. Ne s'mund të hakmerremi për verbërinë e gjertanishme të Perëndimit, duke u verbuar tani vetë ndaj tij. Kësaj i thonë të nxjerrësh sytë e tu.

Në gjithë këtë dramë s'duhet harruar kryesorja: Perëndimi u zgjua, ngaqë lëvizën shqiptarët. Në qoftë se në Kosovë do të vazhdonte gjumi paqësor gandist, Perëndimi do të vazhdonte të flinte. Atëherë, i kujt do të ishte faji kryesor?

*Duke iu referuar luftës në ish-Jugosllavi Zhan Bodriar mendon se "kjo është luftë për definimin e Evropës. Evropa duke qenë se nuk ka definim të qartë, po definohet në terren, përmes ekskluzivitetit, hedhjes, dërrmimit..." Po me Shqipërinë që iu fut iluzorisht Perëndimit në gji dhe Perëndimi proforma iu fut asaj brenda në dhomën e zjarrit si themi ne, ç'ndodhi zoti Kadare?*

*Në librin e tij "Antipolitika" Gjergj Konrad thotë: "Jam optimist sepse dëshira është më e fortë se frika". Ju thoni "shqiptarët, megjithatë nuk janë të pafat..."!? Ku e mbështesni këtë tezë tuajën, këtë optimizëm të druajtshëm, kur ne po na bindin koha dhe rrethanat*



*se s'kemi trohë fati. Orët tona po na lënë në këtë dergjë, në këtë zall të gjallë, që dua t'i them shkretëtirë e Fushëkosovës...*

Së pari, desha t'ju them se nuk ka gjë më të lehtë sesa të lozësh me citimet për Evropën. Si në një garë groteske, janë futur të gjithë, të mençur e të pamençur, të sinqertë e të pasinqertë, burra me peshë e sharlatanë, filozofë e pseudofilozofë etj., për të dhënë nga një aforizëm, nga një thënie, nga një metaforë, nga një kinsemetaforë, nga një maksimë, nga një kundërmaksimë, për këtë kontinent që quhet Evropë, e që po përpiqet t'i japë emrin një bote të re, një vizion të ri, shkurt një shpresë të re për banorët e vet. Shumica e këtyre thënieve nuk janë veç prodhim i një çasti, i një vetndezeje, i një dëshire për të bërë bujë. Si të tilla, shumica janë boshe, kundërthënëse, të kotsëkotshme, rrjedhimisht të papërgjegjshme. Mallkohet Evropa për të kaluarën e saj, e sapo ajo përpiqet të kërkojë një të ardhme (pra një qortim të kësaj të kaluare) përqeshet me cinizëm.

Unë as i çmoj e as i marr seriozisht këta prodhues aforizmesh, ngaqë një pjesë të tyre i njoh fare mirë e ua di ç'mendje të cekët kanë. Ka midis tyre gjithfarë koleksionistësh: nga ish-adhures të Maos e të Kastros, tek liderë të lëvizjes së sotme lesbike, e një Zot e di me ç'fyturë do të shfaqen nesër. Çështja e Evropës është një çështje në rradhë të parë tragjike, me tërë plotërinë që mbart kjo fjalë. Është e tillë ngaqë ajo lidhet me fate popujsh, me drama, me krime dhe me gjak. ( Më i freskët është gjaku Kosovës). Dhe për një çështje tragjike flitet së paku seriozisht dhe së paku harrohet

pakëz vetvetja dhe lihet mënjanë vaniteti. Fati ynë është i lidhur me këtë Evropë. Me të mund të tallen ta zëmë portorikanët ose tibetianët (tashmë mendjelehtësisht sepse edhe fati i tyre nuk është i pandarë nga Evropa), por ne shqiptarët nuk na lejohet qëndrim i papërgjegjshëm.

Ky është kontinenti ynë, trualli, platforma ku është vendosur atdheu ynë, shtëpia jonë, ndaj ne do ta pranojmë atë me të gjitha mungesat e saj, sepse nuk kemi zgjedhje tjetër. Evropa është e ndërgjegjshme për krimet e saj (pak i ka dënuar ajo nazizmin dhe stalinizmin?). Evropa ka derdhur gjak për lirinë dhe demokracinë e vetes e të gjithë botës. Siç thashë më lart, ne do të bëjmë që ajo të kuptojë dramën shqiptare jo duke u zemëruar, siç e kemi zakon, por duke punuar.

Në antikitetin grek, askush, as mendjet më të përndritura nuk u ngritën kundër skllavërisë. Kjo gjë e trishtueshme nuk është një argument për ta mallkuar atë antikitet.

Perëndimi e shikon turbull tani për tani dramën tonë. Por kjo s'mund të vazhdojë gjatë. Perëndimi s'mund të vazhdojë të ketë dy morale, një për popujt në përgjithësi, e një të veçantë për popullin shqiptar. Ai s'mund të vazhdojë të pranojë një koloni në mes të kontinentit. Gjithë puna është që ne shqiptarët, ta bëjmë të ditur se Kosova është koloni. S'mund të themi se këtë gjë e kemi bërë siç duhet, së paku gjer këtë vit.

*Më bëhet nganjëherë se shqiptari kur ndeshet me forcat e jashtësisë i rikthehet legjendës, struket në mit, kërkon azil diku thellë në përrallat për dragojtë dhe zanat. A i duhet Shqipërisë sot një mit rishtar i*

*Skënderbeut (për unitet kombëtar) apo asaj i mjafton një kushtetutë moderne siç thotë z.Fatos Lubonja kohë më parë? A e shquan shqiptarin një kod fatalist, një prirje vetëvrasëse?*

Kur flitet për fate popujsh, nuk është njëlloj siç flitet për besimin ose mosbesimin në jetën e përditshme njerëzore. (Besoj se do të shërohem nga kjo sëmundje, ose s'besoj se do të shërohem. Besoj ose s'besoj se do të më lerë gruaja). Të afishosh mosbesimin në të ardhmen e një populli do të thotë të ngresh flamurin e thyerjes.

Ka shumë popuj që iu pëlqen të shpallen të pafat. Por janë kultura e tyre, strategjia, filozofia e ekzistencës, që e qorton këtë rënie shpirtërore. Ç'do të thoshin gjermanët më 1945, pasi humbën, përveç të tjerash, 20 milion djem, në një popullsi prej 60 milionësh? Ç' do të thoshin armenët? Ç'do të thoshin disa nga fqinjët tanë?

Mendoj se këmbëngulja, për t'u kthyer te fati i keq, si ç'do këngë e qyqes është një dëshirë për të përligjur mënjanimin dhe mospraninë në ravgimin e një populli, në çastet kur ai ka nevojë për ringritje.

Uniteti, thuhet apo nuk thuhet, është i pranishëm në çdo komb të gjallë sot. Ai s'është as luks, as virtyt. Ai është domosdoshmëri. Ndryshe këta popuj a shtete, që ne na duken të fuqishëm e modernë (aq modernë sa nuk e përmendin fjalën "mit", aq të sigurtë sa nuk kanë nevojë të flasin për unitet), në të vërtetë janë të gjallë e janë në këmbë për hir të unitetit. Përndryshe zhbërja e një vendi, e një populli, me fjalë të tjera, vdekja e tij, nuk është gjë tjetër veç një disunitet që s'është. Uniteti i popullit shqiptar ka qenë përherë i vështirë, ndaj e

rëndë dhe tragjike ka qenë historia e tij. Ajo s'mund të jetë veç e tillë edhe në të ardhmen në qoftë se kjo sëmundje nuk do të zbutet.

Uniteti i çdo populli, ashtu si pullazi i çdo tempulli mbështetet mbi disa shtylla. Kur shtyllat nisin e bien njëra pas tjetrës, pullazi do të bjerë, e pas tij do të bjerë vetë kombi.

Gjergj Kastrioti, që përmendni ju, është programuesi kryesor i orientimit shqiptar. Programi i tij vazhdon të jetë ende i saktë, ndaj goditja kundër figurës së tij, është goditje tradhtare kundër jetës së Shqipërisë. Një shtyllë tjetër e kombit shqiptar është gjuha shqipe, kjo pjellë e tij madhështore, që si në pasqyrë, ashtu si çdo gjuhë jep mendësitë tona, fuqinë e mendjes e të shpirtit, fluturimin dhe energjinë tonë të brendshme. Ashtu si Skënderbeu, gjuha shqipe u sulmua vitet e fundit edhe më tinëzisht dhe kjo nuk është e rastit. Shtylla të tjera të kombit shqiptar janë kujtimet historike, toleranca fetare, përftimi i nderit e familjes, energjia për të qenë bashkë, së fundi kultura e tij. Të gjitha këto u sulmuan nga i njëjti zhgan i pabesë, që përmenda më lart. Ju i dini ulërimat e këtij zhgani. Ju i dini propozimet e tij. Ju e keni parë besoj se si muaj me radhë, sa herë flitej për Shqipërinë në TV-të e huaja, në hartën e saj, si thikë ndarëse shfaqej lumi Shkumbin. Këtë nuk na e bënë veç të huajt, siç na ka ënda të ankohe mi. Këtë ia kemi bërë vetes.

Uniteti është i vështirë, por formula e tij është e thjeshtë. Një shtet, një popull që jeton në kufijtë e një shteti, s'është gjë tjetër veç një grupim njerëzish, që janë marrë vesh për ca gjëra themelore. Nderimi i këtij pakti është vazhdimi i unitetit, pra vazhdimi i jetës së

një vendi. Prishja e paktit është rrënimi.

Uniteti për t'u njëmendsuar kërkon nga gjithkush të heqë dorë nga diçka e vetja. Të vjetrit përmendnin në këtë rast fjalën "altar". Kjo fjalë lidhej me flijimin. Pikërisht këtu nis moskuptimi i shqiptarëve me vendin e vet. Të përfshirë nga një grykësi makabre, një pjesë e tyre s'duan të japin asgjë. Nuk e kuptojnë se ajo që do të japin do t'ju kthehet prapë, në bazë të ligjeve të kësaj bote. Edhe këtu UÇK-ja luajti një rol parësor midis grykësisë materialiste, ringjalli vlerën e idealeve.

Çoroditjen fatale në jetën e shqiptarëve e ka sjellë niveli i ulët moral i partive politike. Vite më parë, në një intervistë kam përmendur thënien e të vjetërve se partitë politike, kur nuk merren vesh me njëra-tjetrën, janë më keq se murtaja. Atëherë ishte viti 1991 dhe ndonëse e pata këtë drojë, nuk e besoja se ajo do të vinte vërtet. Përçarja po bëhet murtaja e shqiptarëve. Në këto ditë, klasa politike në Shqipëri, megjithë tragjedinë e Kosovës, vazhdon, për turpin e saj, të jetë e përçarë. Shtypi shqiptar, i përcjell shpesh me mendjelehtësi ngjarjet e Kosovës. Një pjesë e shtypit të Kosovës nga ana e tij, me të njëjtën mendjelehtësi lëshon fjalë të zeza kundër Shqipërisë. Me sa papërgjegjësi shkruhet "Shqipëria u shit". "Shqipëria u bë koloni e Greqisë" etj., etj. Kur këto gazeta lëshojnë zezona të tilla, a nuk mendojnë se e thyejnë moralisht popullin e Kosovës? Të thyesh moralin e një populli që ndodhet në luftë do të thotë t'i futësh thikën në shpinë.

*"Shqiptari gëzohet deri në marrëzi dhe hidhërohet deri në zemërim " pati thënë Konica. Që të dyja këto gjendje ekstreme emocionale kanë diçka çmendurake.*

*A mund të shërohet shpirti shqiptar nga dyzimet deri në përmasa patologjike (ëndërr-zhëgjëndërr, delir-ankth, realitet-mit) apo kombi po e vuan traumën gjysmëshekullore të zënies nën rrotat e makinës së quajtur komunizëm, se po e vuan një shkëputje nga "parajsa tokësore" e premtuar nga komunizmi në Lindje?*

Meqënëse ju e ngritët pyetjen tuaj mbi një citim të Faik Konicës, dëshiroj t'ju them se pavarësisht se e çmoj Konicën dhe e quaj princ të kulturës shqiptare, citimet e tij, sidomos kur lidhen me karakterizimin e Shqipërisë janë kaq kundërtënëse saqë mund të kthehen fare mirë kundër atij vetë. Kohët e fundit janë bërë shumë spekulime me të dhe kjo nuk është një rastësi. Një kohe të çoroditur, një krize morale si ajo që kanë përjetuar vitet e fundit shqiptarët u shkonin për shtat këto citime, disa herë të papërgjegjshme të atij vetë, e natyrisht të atyre që i përdorin...

*A thua pse, i madh e i vogël, zotohemi që një shekull për bërjen e atdheut të lirë ndërkaq që s'ia dalim zot?*

*Dhe ne vazhdimisht po ikim para serbëve, po ikim nga pavarësia, nga Kosova ndër azile ...Në këtë pikë ju, Kadare, keni të drejtë të qortoni për qyqarllëk. Kjo ma kujton një dokument të "Vehermahtit" gjerman ku thuhet se "në Shqipëri ikja konsiderohet për mençuri"?*

Kur bëhet një luftë, palët ndërluftuese kanë zakonisht si synim thyerjen e kundërshtarit. Në Kosovë

lufta është me një synim disi të veçantë: shqiptarët duan të fitojnë lirinë, serbët, të shpërngulin shqiptarët nga Kosova. Ndërkaq, shpërngulja e shqiptarëve, ky qëllim final i serbëve, ka kohë që ka nisur. E veçanta në Kosovë është se shpërngulja, aq e ëndërruar prej serbëve, është organizuar në masën dërrmuese prej vetë shqiptarëve, natyrisht nën nxitjen serbe.

Agjencitë e nxjerrjes së shqiptarëve nga Kosova, këto dyqane sklleverësh janë drejtuar nga shqiptarët grykësa dhe tradhtarë. Asnjëherë këto agjenci nuk janë dënuar as fizikisht (ato meritonin të digjeshin me vajguri), e as moralisht.

Në Kosovë u krijua një rreth me cen (rreth vicioz). Nga një anë u mbyllën shkollat, nga ana tjetër u nxit zbrazja e Kosovës prej të rinjve. Kjo e dyta përlligjej prej të parës. Këtë kurth të mbrapshtë e theu lëvizja studentore, për ta hedhur pastaj në erë UÇK-ja.

Shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova ishte fitorja e përditshme e Serbisë dhe vdekja e përditshme e Kosovës. Në këtë rrënim të kombit shqiptar, përveç Serbisë, ka qenë e gatshme të marrë pjesë Maqedonia. Jam ndodhur në Greqi në fillim të këtij viti, kur miqtë e mi grekë më njoftuan se zyrtarët maqedonas nuk i fshihnin planet për të hapur korridorin e zbrazjes së re të Kosovës. Janë të gjitha gjasat që Rusia ka qenë e përzier në këtë plan kriminal.

Për një kohë të gjatë, si në Kosovë, si në Shqipëri u përpunua psikoza e braktisjes së vendit. Ndërsa nxitej ikja, fare pak ose aspak nuk flitej për tragjedinë e mijëra të rinjve shqiptarë në rrugët e botës, për përdhunimet, vrasjet, për kufomat e gjetura në hendek me një thikë në shpinë, për të zhdukurit, për të infektuarit nëpër burgje

nga SIDA etj., etj. Zbrazja e trojeve shqiptare është ëndrra e ëndrrave të Serbisë. Mjafton kjo për të kuptuar se ç'duhet të jetë për të kjo zbrazje.

*Ju thoni se pas Gilgameshit letërsia vazhdoi me Trojën dhe vrasjen e ndërgjegjes greke "të ushqehet nga vdekja dhe nënproduktet e saj: nata, gjumi, ëndrrat, vrasja e ndërgjegjes". Duket se ju, si autor, e keni bërë pikërisht atë kompromisin me të pamundurën, më parë në publicistikë me "Peshën e kryqit" dhe pastaj, më fort dhe më thellë te "Shkaba" duke qenë i mposhtur nga vdekja, ju pra për hir të letërsisë një pjesë tuajën e keni "shmangur", shpëtuar nga vdekja. Koekzistenca juaj "paqësore" me regjimin totalitar sikur e kërkonte këtë sfidë, t'i jepni mishin tuaj shkabës sa herë që ajo të kërkontë me atë "Krrraun" e përbindshme e të tejbotshme, qiellore? Ju lutem Kadare, " ikjen" tuaj të tejbotshme mbi shkabën e kuptoj si aspekt emancipues të krejt shqiptarëve për "kthim në shtëpi" - në prehërin e demokracisë perëndimore?*

Një vepër artistike s'mund të jetë e zbrërthyeshme si në një pasqyrë laborator. Unë jam kundër shpjegimeve të veprave nëpërmjet simboleve. Simbolet i krijon jeta dhe jo shkrimtari. Shumë, shumë ai pasuron, thellon ose qorton simbolet që gjëllojnë në jetë. Romanin "Shkaba" e kam bazuar në një legjendë ku simbolika është fare e thjeshtë dhe e rrokshme: çdo ngjitje lart, çdo fluturim, çdo përpjekje drejt lirisë, kërkon një çmim. Elementi bashkëkohor me të cilin e kam pasuruar legjendën e kryehershme, ka të bëjë me

Ushqehet nga vdekja  
06.92x39831



keqkuptimin tragjik që u krijua vitet e fundit midis njeriut shqiptar dhe atdheut të vet. Ky atdhe përfaqësohet këtu nga shkaba, e cila vërtet është emblema e Shqipërisë. (Desha të shtoj këtu se ndonëse është në vulën dhe kurorat e shumë vendeve, në asnjë popull tjetër shpendi mbretëror s'ka lidhje aq të forta, - të pranuar për habi nga gjithë bota - se sa me shqiptarët). Qëllon që bijtë e shqipes, siç na quajnë, kërkojnë shumë prej vendit të vet, pa dashur t'i japin asgjë. Në zemërim e sipër, ata i bien me thikë, pa e kuptuar se i bien vetes. Në qoftë se do të kërkonin pa tjetër një kuptim sipër tekstit, ky është kuptimi.

*Troja - si thoni - një vrasje e vonuar ndërgjegje që e lindi Homerin. A i besoni ju "magjisë" së letërsisë, kodit të saj etik që një ditë kjo vrasje ndërgjegje do të ndodhë te serbët?, që t'u qasen shqiptarëve të mundur për gati një shekull nga ligji i xhandarëve, rrethimi, shantazhi, helmi dhe plumbi?*

Nuk besoj se te qytetërimet e sotme mund të ndodhë shpesh kjo ngritje. E aq më pak te serbët. Me ngjarjet e fundit në Kosovë, e ashtuquajtura opozitë serbe dhe të ashtuquajturit demokratë serbë treguan një nivel të mjerueshëm emancipimi. Veç kësaj, mendoj se shqiptarët nuk kanë nevojë për këtë farë vrasje ndërgjegjeje, sepse ajo mund të pritet nga një kundërshtar disi i denjë e jo nga një kriminel i rradhës, ku gjithçka është karikaturale.

*Ju lutem, Kadare, cili është raporti i realitetit me letërsinë, a mund të shprehë ajo tërë kompleksitetin e*

*dramës jetësore të një populli, të njerëzimit...?*

Letërsia i jep të gjitha: edhe tmerrin, edhe dramën, edhe shpresën, edhe modelin e së ardhmes. Gjithë puna është që ajo të mos japë as dramë të rreme e as shpresë të rreme.

*Një dorë shkrimtarësh në Kosovë ua zënë për të madhe preferimin e temave letrare (si të ishin detyrë shtëpie?) për masakrën e 81-shit, për helmimin e fëmijëve të 90-tës, për Procesin e Paraçinit... Ata thonë se këto janë tema për publicistin e jo për shkrimtarin dhe ua shohin për të madhe pse ju s'e duroni dot "shkrimin hermetik e metafizik". Ku qëndron mjeshhtëria e shkrimit letrar, hermetizëm, në gjuhën dhe formën, apo në thjeshtësinë dhe qartësinë?*

Së pari, më duket se vërtet është për të qarë që të detyrohem të diskutoj për gjëra të sqaruara gjithkund prej kohësh e që kanë ende peshë veç në kokat e letrarëve provincialë. Sepse është e qartë si drita e diellit se, kur një vend bie në zi e përgjaket, siç ka ndodhur me Kosovën, shkrimtarët e këtij vendi s'mund të hiqen mënjandë e të numërojnë yjet. Asgjëkund në Evropën e në botën e sotme nuk pranohet kjo dhe ky ka qenë thelbi i vërejtjes sime për një pjesë të shkrimtarëve të Kosovës. Ajo ka qenë një vërejtje në trajtë sugjerimi, asgjë më tepër.

Reagimi agresiv i disa prej letrarëve të Kosovës tregon se sëmundja ka qenë më e thellë se ç'kujtoja unë. Pra, s'ka qenë rastësi, por një vendosmëri për të mos shkruar asgjë për masakrat, për enigmat që mbulon

Kosova. E unë po ju them këtyre letrarëve se përshkrimi i krimeve të bëra kundër njeriut, popullit tënd, çdo populli, nuk mund të quhet kurrsesi me përqeshje "detyrë shtëpie", pasi ato krime kanë qenë ushqim i letërsisë së madhe botërore që nga tragjikët grekë, të "Ferri" i Dantes, të "Makbethi" e "Hamleti" të Shekspir e gjer të "Procesi" i Kafkës.

Në mënyrë shoqërore pra u bëra letrarëve të Kosovës sugjerimin që ata duhej të dëshmonin për dramën e popullit të tyre. Ju e dini se refuzimi për të dëshmuar kundër një krimi, kur ke qenë i pranishëm aty, është i dënueshëm. Ata letrarë të Kosovës, që për një arsye ose një tjetër, nuk duan të dëshmojnë, mbajnë mbi vete peshën e ndërgjegjes së tyre. Por ata, që jo vetëm s'duan të dëshmojnë, por kërkojnë të krijojnë teorinë e mosdëshmimit, të qepjes së gojës do të mbajnë një fajësim shumë më të rëndë. Kur serbët masakruan shqiptarët në Drenicë, në Prekaz, një nga shëmtitë e tyre qepja e buzëve të viktimave. Pra mesazhi i tyre ishte i qartë: kështu do ta pësoni po nuk e qepët gojën!

*Ju vini në Paris nga një vilajet i zymtë, nga Ballkani i legjendave që i pjell mjegulla, si të "Legjenda e legjendave", pastaj pëlçet zënka midis fqinjve për t'i përvetësuar ato legjenda (thua se nuk ka sa të hanë edhe qentë?). Ju bëni fjalë për këto grindje fqinjësh tek "Ftesë në studio" por më duket se jeni pak i njëanshëm me faktin se shqiptarët i merrni si më superiorët në rajon!? E ata më duket se dijnë të grinden pikërisht për një grua si Paridi me Melenaun për Helenën e Trojës. As grekët madje (aderojnë në UE) nuk janë shkundur nga këto grindje*

*(ata shkojnë keq me shqiptarët, maqedonët, turqit...)  
Ta zëmë epin për Oso Kukën, ju e shihni anakronik,  
pra a mendoni se ky Ishull (VraNina) që ne i themi i  
pavarur (lexo: Kosova) dhe kjo kullë baroti "fuçi  
baroti" (Ballkani) - zhargon pezhorativ në mendiumet  
dhe diplomacinë evropërendimore për regjionin e  
Evropës Juglindore - janë shembëllesa të një konserve.  
A mbretëron këtu vërtet logjika e robit, e lypsit dhe e  
grindavecit, apo Ballkani "si bure baruti" është një  
sajesë e konstituimit politik të Evropës që këtë  
konstituim e bën përmes përjashtimit?*

Para së gjithash jam kundër përdorimit të shprehjes  
"ka sa të hanë qentë" për legjendat e cilido popull. E  
dyta, s'besoj se ka ndonjë ndjenjë superioriteti për  
shqiptarët në "Ftesë në studio". Kritika e huaj, tepër  
syçelët se mos shqiptarët i bëjnë ndonjë vlerësim vetes,  
do ta kishte kapur me bujë këtë cen.

Mendoj se kohët e fundit, nën trysninë e një  
vetëfajësimi të përgjithshëm, shqiptarëve iu duket se  
po u mbiçmohen vlerat po të shkruhet normalisht për  
ta. Vërtet juve ju shqetëson hamendja se shqiptarët po  
dalin pa të drejtë superiorë diku? Po ju e keni dëgjuar  
propagandën e neveritshme serbe, fyerjet, shpifjet  
kundër shqiptarëve? Një senatore serbe, duke folur para  
ca javësh në TV-në francez e përmbloodhi kështu çështjen  
e Kosovës: "Mendoni sikur Harlemi të ngrinte krye.  
Ç'do të bënin SHBA-të? Natyrisht do të përdornin  
policinë dhe ushtrinë". Pra, për këtë bibë serbe Kosova  
shqiptare është Harlemi dhe Serbia na qenka SHBA-  
ja.

Në këto kushte, vërtet juve ju duket një problem

superioriteti i pandehur i shqiptarëve?

Natyrisht mund të flitet për sipërani të një qytetërimi ndaj një tjetri, treguesi vendimtar i tij është mungesa e urrejtjes dhe e përjashtimit. E në qoftë se unë kam shkruar se fakti që te shqiptarët s'ka doktrina shfarosëse kundër të tjerëve, është shenjë dalluese qytetërimi, të fundit që duhet të mërzhiten nga një pohim i tillë duhet të jenë shqiptarët.

Kam folur gjerësisht në "Ftesë në studio" për gjuhën shqipe, për rangun e saj, për vendin që ajo zë në hierarkinë e gjuhëve evropiane, si një ndër 6 ose 7 gjuhët themelore të Evropës (krahas gjuhës gjermanike, italike, çeltike, balte, sllave e gjuhës greke). Nga droja se mos cilësohen si nacionalistë ka shqiptarë që nuk e thonë këtë të vërtetë. Të tjerë nuk e thonë nga injoranca. Ka ndodhur që një nga "liderët" kosovarë, pasi është përkulur si vasal përpara Millosheviçit, duke u prishur gjakun miliona shqiptarëve që ndiqnin lajmet në TV, ka shkuar e ka dhënë intervistë në "Euronjuz". Meqenëse nuk zotëron kurrfarë gjuhe të huaj nga ato që quhen ndërkombëtarë, ky farë "lideri" në rrjetin e TV, Evropë; në vend që të flasë shqip flet serbisht. Pra e braktisi gjuhën e vet, për një dialekt të sllavishtes. Ja ku të çon logjika e vasalit. Natyrisht që për mendësinë e këtij "lideri", të thuash se gjuha shqipe, ndonëse s'është gjuhë e komunikimit ndërkombëtar, është gjuhë themelore e Evropës, është një absurditet!

Lidhur me raportet midis dy popujve, mendoj se si shumëçka në kronikën e zezë shqiptaro-serbe, edhe këtu ka pasaktësi të ndjeshme. Mendoj se urrejtjet e palodhura ushqehen nga komplekset. Është bërë zakon të thuhet se ka urrejtje shekullore të dyanshme midis

shqiptarëve e serbëve. Kjo është e vërtetë, por nuk di ndonjë studim që të jetë thelluar për shkaqe më të fshehta se livadhet e kullotat (në mesjetë), kufijtë (në shekullin tonë), psikozaat shoviniste (në çdo kohë) etj. Përsa i përket "urrejtjes së dyanshme" del një pyetje themelore: vërtet ajo është e dyanshme?

Në Kosovë, merret me mend që ashtu është, e dyanshme. Verilindje e Shqipërisë, në këtë pikë mund t'i ngjitet Kosovës. Por më thellë në Shqipëri, gjithçka ndryshon. Në qoftë se, siç komentojnë gjithë udhëtarët e huaj, mjediset dhe kafenetë e Beogradit nxijnë nga urrejtja që nuk shter kundër shqiptarëve, po të shkoni në Tiranë shqiptarët, me përjashtim kur shohin lajmet në TV, rrallë kujtohen që në këtë botë ka një vend me emrin Serbi. Dhe kështu ka qenë përherë. Serbët dhe Serbia kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten jashtë vizionit të tyre. Me mendje të drejtuar nga shtetet e mëdha përtej detit, iu duket jo serioze të merren me fqinjët sllavë. Kjo shpërfillje mund të jetë jo fort e mençur, kjo mund të mbajë erë donkishotizëm, por kjo është e vërtetë. Nga ky fakt rrjedh një e vërtetë tjetër themelore: te shqiptarët që jetojnë në Shqipëri nuk ka urrejtje të palodhur, pra s'janë ata që e ripërtërijnë urrejtjen. Pra lidhet me kompleksin e anës tjetër, sidomos me një ndjenjë të vonuar revanshi, me ëndrrën për të patur edhe ata një koloni, (ëndërr e mbrapshtë, që e kanë disa herë ata që kanë vuajtur vetë nga shtypja dhe përbuzja shekullore). Të kenë nën vete shqiptarët, që sipas tyre, kanë qenë bashkësundues me otomanët, mbi ta, kjo me sa duket, për psikikën e të kompleksuarit është një kënaqësi e rrallë. Në një shkrim të Drashkoviqit në "Le Monde diplomatique", vite me

radhë, renditeshin gjithë vezirët, gjeneralët e kryevezirët shqiptarë, me nëntekstin e qartë drejtuar shqiptarëve: koha juaj, kur ishit senjorë të Ballkanit, ka kaluar. Tani, zotër jemi ne, sllavët e jugut.

*Në këtë luftën e mbrame ballkanike, ishin të krishterët ata që kryen krimin, ushtruan gjenocidin mbi myslimanët. Ishin serbët xhelatët, që së pari propogandojnë me zhurmë se "pala tjetër janë satana" e pastaj nisin ndjekjen e tyre. Ju lutem, z.Kadare, spastrimi etnik është specialitet i Evropës, andaj, më duket se shqiptarëve u është bjerrë shpresa tek Evropa, çka të bëhet?*

*"Njeriut i vjen keq për shterpësinë e tërë kontinentit..." - thotë publicisti slloven Ervin Hladnik dhe konkludon se të krishterët kësaj herë ishin barbarët, prej nga atëherë frika nga islami? Ç'flet ashtu Ismail Kadare për islamin ndër shqiptarët - thonë njerëzit në Kosovë? Ç'flet ashtu marrëzira Hantington, kur flet për përleshjen e qytetërimeve, kur Evropa që fle vetë në djepin e multikulturalitetit refuzon kulturën islame?*

*Një nga intelektualët më në zë slloven Dr.Tomazh Mastnak u shpreh për revistën tonë se "në bërthamën e Evropës ndodhet ideja e pastrimit etnik. Armiqësia ndaj myslimanëve është zaten shumë më e vjetër se Evropa. Evropa atë e mori nga krishterimi. Dhe është fakt se kjo armi qësi ndodhet në bërthamën konstituive të Evropës si bashkësi politike. Në luftën kundër Bosnjës kjo u dëshmuua në mënyrë dramatike. Bodriar thoshte se "serbët ishin bashkëpjesëmarrësit "tanë" (d.m.th. evropiane) në pastrimin etnik të Evropës". A*

*mendoni ju pra se Evropa si bashkësi politike po ndërtohet mbi bazë të përjashtimit?*

Mendimet e mia për Perëndimin (Evropën dhe SHBA-të) besoj se i thashë përgjithësisht qartë në krye të kësaj interviste. Meqenëse ju këmbëngulni do të shtoja se mjaft kemi dëgjuar sharjet kundër Perëndimit prej Enver Hoxhës, Stalinit, Maos etj. Populli shqiptar e ka paguar shtrenjt të ashtuquajturën mbrojtje të maksizëm-leninizmit. Tani ai s'ka ndërmend të bëjë flijime për "mbrojtje" të tilla botërore, siç janë fetë e ndryshme. Shqiptarët s'kanë pjellë asnjë nga fetë e mëdha, as kanë përgjegjësi për fatet e tyre, as duhen të merren me luftrat e tyre, nëse këto luftëra ekzistojnë vërtet. Ndaj zjarrmitë në këtë lëmë janë vrastare. Të tre besimet e shqiptarëve kanë një histori bashkëjetese të admirueshme dhe zgjimi i demonëve që u nxit në këtë fushë ka qenë veç qëllimkeq.

Disa herë në shtypin e Kosovës unë pikas një mllef të tërthortë kundër "Perëndimit të krishterë", i cili mendohet se ka bërë dhunë, madje dhunën e mosdurimit i ka kthyer në parim kundër islamizmit. Madje Evropa nëpërmjet kësaj dhune po modelon fytyrën e saj të ardhme.

Jo vetëm që unë s'besoj në këtë shestim, por më shqetëson fakti që ka njerëz në Kosovë që merren me këtë. A s'na mjafton tragjedia jonë? A s'na mjaftuan dekada të tëra kur u bëmë avokatë të marksizëm-leninizmit? Përse duhet të bëhemi prapë avokatë të dikujt?

*Ju te "Piramida" bëni një alegori politike me*



*dekadën e fundit të vendit të shqipeve, mbi ndërtimin e shtetit përbindësh, duke u hequr edhe ëndjen njerëzve-shtetasve. Kështu ngjashëm veproni edhe me "Pallatin e ëndrrave", duke renovuar artistikisht strukturën arqitektnike të ndërtimit të shtetit-përbindësh (Perandorisë otomane) por duke e shpalosur pretekstin letrar përmes fatalitetit të shqiptarëve (Qyprillinjve) me një atmosferë që Bosquet e quan kafkiane? A bëni ju vërtet një akuzë kundër vetë ndërtimit në thelb johuman të shtetit, të çdo shteti, si koncept dhe makinë që bluan shpirtërat e lirë, apo përmes një alegorie politike e demaskoni kështu ngritjen e piramidës diktatoriale të "Dinastisë Hoxha"?*

Më kanë tërhequr ndërtimet e mëdha dhe krimet e mëdha. Shpesh ato kanë lidhje midis tyre, qoftë kur shfaqen në trajtë urash, (Ura me tre harqe), ngrehinash shtetërore (Pallati i Ëndrrave), muresh mbrojtës ose kinsembrojtës (Muri Kinez), makina ankthi (Përbindëshi), kishash që vazhdojnë jetë të dytrajtshme, kisha dhe xhami bashkë (Kisha e Shën Sofisë) etj. "Piramida" ka qenë përgjithësisht mishërimi i varrit dhe i monumentit shtetëror, por unë si autor i këtij shekulli dhe i ish perandorisë komuniste kam parë më shumë në të peshën e shtypjes. Në libër del qartë mendimi se është një ngrehë që është shfaqur në shumë fytyra, e me sa duket, në të ardhmen mund të shfaqet përsëri.

*Të vetmet gjëra të jashtme që ende arrijnë ta shënojnë kohën janë grafititë e njerëzve që çojnë krye*

*kundër vullnetit të sovranit (me këtë përzierje emërtimelesh, termash, ambientesh të kohës piramidale dhe modernes, ju zoti Kadare shtresëzoni dimensionin piramidal të kohës, domethënë përziemi kohët në roman). Ndërkaq shkrimi i rrallë i ndonjë grafitije "Keops vdeksh" - ishte hyrje në një kohë tjetër - në një hetim të ri, në përmasën piramidale të njehsimit të kohës, ngase "koha" do të riseminohej si "hetim". A do ta shqetësonte më shumë dikë grafitia "Poshtë shteti" apo "Poshtë Krishti"?*

*Në Perëndim hasa në bluzat e të rinjve grafitin: "Vrani idolet tuaja!" - nën portretin e Jezusë?*

Meqenëse intervista jonë u zgjat shumë, më lejoni t'i përgjigjem vetëm pjesës së fundit të pyetjes suaj, atë që lidhet me idolet. U bënë modë në Shqipëri, e më pas kjo nisi të kalojë edhe në Kosovë, britmat kundër idhujve. Kjo s'kishte lidhje fare me rrëzimin e diktaturës dhe të shtyllave të saj. Kjo ndodhi më pas. Kur në shkurt të vitit 1991 u rrëzua shtatorja e Enver Hoxhës, askujt nuk i shkoi në mend t'i sulej shtatores së Skënderbeut, që ndodhej disa hapa larg. Një gjë e tillë u kërkua më pas. U kërkua në mënyrë kriminale rrëzimi i Skënderbeut, i Fan Nolit, i Ismail Qemalit, i Migjenit etj.

Kjo luftë kundër "idhujve" s'kishte asnjë lidhje me diktaturën, madje mund të thuhet se në një farë mënyre ishte një revansh, një hakmarrje e diktaturës, sipas parimit "pas meje, gjëma të bëhet!". Fakti që në krye të zërave më të zellshëm, që kërkonin rrëzimin e gjithçkaje, ishin bijtë e ish nomenklaturës komuniste, e vërteton këtë. Deviza e tyre ishte e qartë: i rrëzuat idhujt tanë?

Le të rrëzohet pas tyre gjithçka.

Rrjedhoja e këtyre britmave ishte fatale. U hodh baltë mbi gjithkënd, u shembën monumente të kulturës, u dogjën vlera kombëtare, që nuk ishin prekur as nga otomanët, as nga nazistët. S'kam parë kurrkund ndonjë fjalë frenimi apo keqardhje nga këta pseudointelektualë dinakë, që nxitën këtë psikozë rrënimi. Të ndjeshëm kinse për padrejtësitë, të zellshëm për gjithfarë denoncimesh në ambasadat e huaja dhe në shtypin e huaj, nuk kam parë asnjë protestë, asnjë fjalë për lirimin e liderit të shquar të Kosovës, ish ministrit të Jashtëm të saj kur Kosova kishte autonominë, politikanit profesionist, filozofit dhe militantit të pamposhtur të lirisë Ukshin Hotit. Ishte i vetmi nga liderët që, pasi u fut në burg e vazhdon të jetë në burg, në kohën që Kosovës i duhej aq shumë.

Me sa jam njoftuar në demonstratat e para në Prishtinë emri i tij është përmendur shpesh e më shpesh.

*Duke lexuar librat tuaj "Nga dhjetori në dhjetor", "Pesha e kryqit", por edhe "Legjenda e legjendave" m'u krijua përshtypja se e keni krijuar një nevojë të madhe për t'u mbrojtur. Ju sikur vazhdimisht shihni diçka që ju ndjek prapa, përndryshe përse e bartni atë kryq të mallkuar prej fajtori e nuk e hidhni përgjithmonë? Tek e fundit, ta parafrazojmë Lasgushin e madh, ju jeni shkrimtar, pra, edhe gjykatës, prokuror, ministër drejtësie?*

Besoj se nuk është aspak ashtu. Së pari, te "Legjenda e legjendave", as që flitet fare për gjëra të tilla. Në dy librat e tjerë gjithashtu s'ka kurrfarë ndjenje

faji ose ikje etj. Unë jam kundër mendimit të shprehur andej-këtej se "shkrimtari është mirë të mos përgjigjet kur e sulmojnë". Më duket jo vetëm i pakuptimtë, por dashakeqës. Në këtë botë të gjithë u përgjigjen fajësimeve: përgjigjen qeveritë, presidentët, akademitë, trajnerët e futbollit, shkencëtarët, gratë e famshme etj., etj. Përse shkrimtari duhet ta qepi gojën? Ju e filluat intervistën tuaj pikërisht duke më kërkuar përgjigje për ca shpifje.

Natyrisht që edhe po të dojë shkrimtari nuk është në gjendje t'u përgjigjet të gjithëve. Por herë pas here ai detyrohet ta bëjë këtë. Ai është njeri publik. Vepra e tij ka të bëjë me mijëra, disa herë me miliona njerëz. Janë ata që kanë nevojë për sqarimet e tij.

Një rrethanë e tillë, theksohet për shkrimtarët që kanë jetuar gati gjysmë shekulli në një vend të izoluar si Shqipëria. Njerëzit kanë të drejtë të dijnë çka ndodhur brenda këtij terri. Si është mbajtur në këmbë letërsia, si është shtypur, si është kontrolluar, si është zvetnuar. Ata kanë të drejtë të dijnë si është zhvilluar kjo luftë e tmerrshme brenda kulturës. Kush e ka mbrojtur letërsinë e kush e ka shkelur me këmbë, kush ka denoncuar kolegët e kush është denoncuar, me fjalë të tjera, kush ka qenë viktima e kush xhelati. Kam propozuar prej kohësh të shkruhet një histori e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, kam propozuar hapjen e arkivave të fshehta, për të parë si kanë funksionuar mekanizmat e terrorit në kulturë. E kam bërë këtë që të dalë e vërteta, që t'u pritët rruga shpifjeve, si shpifja e atij Judës nga Kosova, që më përmendët në krye të kësaj interviste. Propozimi im nuk është pritur mirë nga disa rrethe. Sepse këto rrethe janë të interesuara të mbahet mjegulla dhe terri.

Ju mund të thoni se mos vallë hapja e arkivave të fshehtë shton përçarjen? Mendoj të kundërtën: përçarjen e shton shumë pikërisht ky kaos. Kurse transparenca sado e dhimbshme të jetë, si një operacion kirurgjikal, e shëndosh atmosferën.

*Folëm në krye të bisedës për Kosovën dhe shqiptarët që i kanë shtjerr shekujt në këtë hapësirë, për të cilën edhe serbët e kanë thurur një mit të fuqishëm. A na thoni diçka rreth librit tuaj të ri, të sapo botuar në Francë dhe në Shqipëri "Tri këngë zie për Kosovën". A thua të gjithë ballkanasit pas luftës së Kosovës janë të mallkuar që të bëjnë jetë të tejbotshme? Si të zbresim në tokë?*

Lufta në Fushëkosovë më ka tërhequr përherë. Kam shkruar një tregim me tre pjesë (tri këngë), i cili duke qenë në radhë të parë letërsi, kryen njëkohësisht një mision të nevojshëm për shqiptarët, për gjithë ballkanasit dhe opinionin botëror: rrëzon mitin serb të Kosovës. Ju e dini se sa shtrenjtë po e paguan populli shqiptar këtë mashtrim. Ndaj të ngrihesh kundër tij është një akt moral.

E merrni me mend se kur shtëpia botuese franceze shpalli daljen së shpejti të një libri për luftën e Kosovës, të shkruar nga shqiptari I.Kadare, gazetarët e lexuesit kanë pritur një libër me prirje të theksuar proshqiptare e natyrisht antiserbe. Në një rast të tillë misioni moral i librit do të ishte i dështuar, sepse askujt nuk i pëlqen që në një libër me një temë aq përvëluese si kjo, autori të jetë i anshëm. Për të shmangur një rrezik të tillë, për të treguar se letërsia shqipe, qytetërimi shqiptar, është

i aftë për një vizion të tillë sipëran zgjedha në këtë tregim një trajtë të skajshme epike. Pra paanshmërinë absolute në përshkrimin e gjithçkaje. Në tre pjesët e tij përmbledhet lufta e Kosovës, ashtu siç ka ndodhur në të vërtetë, ushtritë pjesëmarrëse, princat ballkanas, sulltani turk, djemtë e tij, rapsodët serbe e shqiptarë, personazhe të tjera nga të dy kampet. Në këtë tregim të gjithë janë të barabartë si përpara vdekjes. Nuk ka as lavde as sharje për askënd. Sulltan Murati, princi Llazar, konti Balsha, princi Bajazit, sërbi Vladan, shqiptari Gjorg, turku Ibrahim, greku Anastasios, ambasadori i Vatikanit, etj. etj., përshkruhen si nga një kamera e pashpirt.

Nisur nga fakti që sot s'mund të ketë akuza simetrike ndaj serbëve dhe shqiptarëve, nga që njëra palë është xhelati e tjetra viktima, një lexuesi shqiptar mund t'i duket e padrejtë paanshmëria ime lidhur me dy personazhet kryesorë: njëri shqiptar, tjetri serb. Por unë jam nisur nga ajo, që faji i sotëm nuk mund të zhvendoset gjashtë shekuj më parë, përveç qëllimit tjetër, atij të besueshmërisë, që në këtë rast është kryesori.

Në këtë ngjarje historike shqiptarët s'kanë nevojë për favorizim. Kryesorja është që në këtë libër thuhet se kanë qenë në atë kohë në Kosovë, ashtu siç janë edhe sot. Kryesorja është që thuhet se ata kanë marrë pjesë në atë luftë, në logun mbrojtës. Miti i rrejtshëm serb është bazuar mbi mohimin e të dyjave. Shqiptarët s'kanë nevojë për mit, ata kanë nevojë veç për të vërtetën.

*Ç'kuptim ka sot fjala paranojë për Kadarenë (një gazetar holandez ua përshkruan juve një dozë të*

*pashmangshme paranoje?) A do ta mbijetojë kombi ynë këtë paranojë? Si do ta definonit këtë fundshekull - epokën e Internetit, në kontekstin shqiptar dhe në atë global. Më duket sikur ne duam të vazhdojmë jetën duke e veçuar, duke dalluar nga të tjerët, me një trill apo një krenari arkaike, ndërkaq që ngjashmëria do të ishte emri i epokës. Pra si t'u ngjajmë të tjerëve me dokë dhe arte, me mendësi e sjellje demokratike, me zhvillim e sens për bashkëpunimin, me gjithçka tjetër dhe njëkohësisht t'i ruajmë veçoritë e shpirtit të kombit?*

Unë besoj në të ardhmen e shqiptarëve. Janë të gjitha gjasat që mijëvjeçari i tretë i Evropës, që është njëkohësisht mijëvjeçari i tretë i Shqipërisë, të jetë më në fund me fat. Jemi ende shumë pranë ekranit të ngjarjeve dhe mjaft gjëra ende na shpëtojnë. Pluhuri i kohës, nervozizmi, përçarjet, krismat e armëve na pengojnë të kemi një vizion të qartë të asaj që vjen.

Ka ndodhur një ndryshim thelbësor kohët e fundit. Kombi shqiptar ka bërë një zgjedhje të re. Ai i ka treguar dhëmbët bishës serbe. Tregimi i dhëmbëve kur bëhet me arsye të drejtë bën pjesë në dinjitetin e një populli. Si rrjedhojë e kësaj, si rrjedhojë e faktorit idealist, martir, që është UÇK-ja, ka një ndërrim kahu të historisë. Ka një ndryshim në orën e këtij kombi.

Kosova është duke ecur drejt lirisë. Pra gjithë kombi shqiptar po ecën drejt gjendjes së tij natyrale. Nuk mund të ketë kthim prapa gjithsesi. Edhe në qoftë se pavarësia e Kosovës, prej së cilës bota në mënyrë iracionale druhet si prej një fantazme, mund të vonojë teorikisht, rruga drejt saj është hapur gjerësisht tashmë.

Sa për zgjidhjen e përgjithshme të çështjes shqiptare, në trevat e tjera ballkanike, Maqedoni, Mal të Zi etj., ajo gjithashtu i tmerron, pa kurrfarë arsye, shumë njerëz e shumë zyra botërore. Por, ajo gjithashtu s'mund të pengohet gjatë. Ajo s'mund të pengohet sepse shqiptarët nuk kërkojnë ndonjë gjë të veçantë, ndonjë gjë të mbrapshtë, ndonjë favor, ndonjë lëmoshë. Ata kërkojnë të jenë si të tjerët. Pra SHQIPTARËT SI TË GJITHË KOMBET. Kjo kërkesë natyrale, e moralshme, e shëndetshme për të gjithë, s'mund të sprapset për një kohë të gjatë.

Shqiptarët i kanë të gjitha shanset sepse KOHA PUNON PËR TA. Në një Evropë të nesërme, e cila nuk është fare larg, në një Evropë, pra, me kufij të çdramatizuar, me ligje demokratike për qarkullimin e lirë të gjithçkaje (njerëzve, ideve, kulturave, mallrave), shqiptarët do ta ndiejnë veten shumë mirë. Ky mendim nuk bazohet në ndonjë dëshirë poetike, por në një fakt të pakundërshtueshëm: kombi shqiptar është një komb i fuqishëm fizikisht dhe mendërisht. Për të jetuar normalisht ai nuk ka nevojë për sforcim, për dhunë kundër të tjerëve, për armiqësi, për ëndrra groteske pushtimesh. Ai kërkon vetëm ta lënë TË JETOJË. I penguar, ai ka mundur mirë a keq të mbërrijë gjer në fund të këtij mijëvjeçari. I lirë, ai do të bëhet, pa dyshim një ndër dy-tri kombet më të fuqishëm të Ballkanit. Duke qenë se liria e tij nuk bazohet mbi cënimin e lirisë të tjetërkujt, ai ka me vete logjikën e së ardhmes.

Në këtë kuadër liria e shqiptarëve bën pjesë në lirinë e të gjithëve, duke përfshirë edhe lirinë e Evropës. Ata që janë kundër kësaj lirie janë njëkohësisht kundër vetvetes. Në qoftë se shqiptarët do të ngrinin dorë



kundër lirisë së të tjerëve, qoftë kjo liri e serbëve, ata nuk do ta meritonin as lirinë e vet.

*Dhe, krejt në fund, a na thoni Kadare, si të tejkalohet sindromi i përçarjes që ka pllakosur shqiptarët, posaçërisht liderët politikë të Kosovës?*

Për shansin që kanë përpara shqiptarët duhet të jenë të përgatitur. Tani për tani pengesat kryesore nuk janë tanket serbe, por mbrapshtia në kokat e tyre, kryesisht përçarja.

Përçarja është vërtet mallkim, por as ajo s'duhet të demonizohet më shumë se ç'duhet. Le të mos kërkojmë paqe e harmoni idilike. Popujt energjikë e kanë shpesh një dozë përçarjeje. Veç doza s'duhet të kthehet në mbidozë, (overdozë). Grekët e vjetër ishin shpesh të përçarë, por me mençuri e kapërcenin kur duhej përçarjen. Shqiptarët kanë dhënë shembuj të fuqishëm për këtë. Ata kanë mposhtur përçarjen fetare. A mundet që të mos jenë në gjendje të kapërcejnë përçarjet meskine politike?

Kur koha punon për ty, është vështirë që ti të mos punosh për kohën.

Bashkëbisedoi: Halil MATOSHI

## NE, QË S'DUAM VETVETEN

*Intervistë në "Albania" 30 tetor 1999.*

*Çfarë përbën për shkrimtarin Kadare mbarimi i luftës në KOSOVË?*

Kthim për mbarë i fatit të Kosovës. Rrjedhimisht, i fatit të të gjithë kombit shqiptar.

*Çfarë mendoni se janë detyrat e shqiptarëve në Kosovë dhe institucioneve të tyre respektive, për të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës?*

Bashkëpunimi me Evropën dhe me institucionet e saj, për t'u përfshirë në kursin evropiano-atlantik. Përfshirja në këtë kurs nuk është humbje e pavarësisë, por është, përkundrazi, njëmendësimi i saj. Ai që quhet integrim në Evropën e nesërme s'ka të bëjë as me servilizmin, as me acarimin grindavec: dy mënyra të sjelluri të turpshme të vendit tonë në gjysmën e dytë të këtij shekulli.

*Çfarë është, në optikën e shkrimtarit Kadare, e ardhmja e Kosovës?*

Të ardhmen e Kosovës e shoh në duart e shqiptarëve. Atë e forcon çdo ditë çdo aksion qytetërues i shqiptarëve; ashtu siç e dobëson çdo bëmë e tyre me kah të kundërt. Ne e dimë vetë më mirë se kushdo se sa të aftë jemi për të dyja, e sidomos, për këtë të fundit.

Të jesh i qytetëruar do të thotë të jesh qytetar në kuptimin e madh të fjalës. E qytetar nuk do të thotë pse je nga qyteti dhe di të broçkullisësh në kafene. Të jesh qytetar do të thotë, në radhë të parë, të ndërtosh lirinë dhe demokracinë tënde. Liria dhe demokracia e vërtetë janë ato që nuk dhunojnë lirinë e tjetrit, qoftë ky person a grumbull personash, qoftë popull tjetër.

*Qendra të ndryshme të studimeve ndërkombëtare, por siç duket edhe administratat perëndimore, po e argumentojnë mungesën e vullnetit për të diskutuar pavarësinë e Kosovës me rënien e shtetit shqiptar në Shqipëri dhe pamundësinë e deritanishme për ta ngritur këtë shtet.*

Kjo është krejtësisht e vërtetë dhe kjo duhet të vërë në mendime të thella gjithkënd, që pretendon se ka mend. Tundja dhe shkundja e shtetit shqiptar si një barakë me llamarinë që e shkalafit era, ky është një imazh tepër i shtrenjtë i rretheve kundërshqiptare, që, për fat të keq, nuk janë të pakta në Ballkan. Në të vërtetë, kjo është shpresa e tyre e madhe, ndoshta e vetme, për të kryer riroberimin e Kosovës.

Dihet se në një luftë, kur nuk ia del dot t'i dalësh

përballë kundërshtarit, provon rrugë të tjera, goditjen pas shpine, rrethimin e ngadaltë, lodhjen, ligështimin shpirtëror, çoroditjen. Të gjitha këto janë provuar e do të vazhdojnë të provohen në këtë gadishull.

Shqipëria e troshitur është argumenti më i mirë për të vënë në dyshim lirinë e ardhshme të Kosovës. Është një pasqyrë ogurzezë, që do të donim të mos ekzistonte. Por, për fat të keq, pasqyra është aty. Në vend që të fyhemi e të xhindosemi me këtë, ne duhet, së pari, të pushojmë së troshituri Shqipërinë e shtetin shqiptar. Së dyti, të përveshim mëngët për të riparuar dëmtimet.

*Në Shqipëri u ndërrua qeveria me arsye jo fort të qarta. A mund të na thoni mendimin tuaj?*

Në një vend përsëmbari, një qeveri ndërrohet për t'u zëvendësuar me një tjetër më të mirë. Meqenëse në Shqipëri shumë gjëra bëhen së prapthi, nuk do të habiteshja që ekipi ekzekutiv të zëvendësohej nga një ekip më i keq. Shpresoj që një gjë e tillë të mos ndodhë.

Në kushtet e Shqipërisë, zëvendësimi i një qeverie me një tjetër, qoftë edhe e të njëjtit nivel, mendoj se është një gjë negative. Veç një nivel më i lartë e përligj këtë gjë. Le të shpresojmë se do të jetë kështu.

Ndryshe kemi të drejtë të mendojmë se qeveria e re do të na vijë me flamurin e egërsimit me opozitën, flamur i papranueshëm sot në Shqipëri dhe në Evropë. Pas kësaj, s'na mbetet, veç t'i besojmë edhe pëshpërimës se ekipi i ri, pasi të acarohet me opozitën, do të zbutet me bandat!

*A është e dobishme, për stabilitetin ballkanik, një*

## *Shqipëri e fortë në pikëpamjen e ngritjes së një shteti që të vetëfunksionojë?*

Natyrisht, ngado që ta marrësh, duhet një Shqipëri e fortë. Ajo i volit, në radhë të parë shqiptarëve, sepse është shtëpia e tyre. Ajo i volit krejt Gadishullit të Ballkanit, sepse popujt duan të qetësohen më në fund dhe të jetojnë normalisht. Mirëpo, është provuar tashmë shumë herë se kur nis grindja dhe rrëmuja në një kënd të oborrit, ajo do të mbërrijë në këndin tjetër. Stabiliteti shqiptar i volit Evropës, sepse Evropa e kuptoi, më në fund, se Ballkani është pjesë e saj ose, së paku, oborri i saj i madh.

Stabiliteti i Shqipërisë nuk u vjen për shtat kastave shoviniste ballkanike, si dhe kastave politike të pabesa shqiptare, ngaqë të dyja mendojnë të nxjerrin përfitime prej saj. Në Shqipëri, korrupsioni, krimi i organizuar, bandat, të gjitha këto, nuk e durojnë dot një shtet serioz dhe të gjitha ëndërrojnë për një shtet harvallinë. Ata do të bëjnë çmos për ta vënë në gjunjë Shqipërinë, sepse kështu mund ta vjedhin, ta shesin, t'i rrjepin shtatë lëkurët për interesat e tyre dhe të këlyshëve të tyre. Ata duan të mbushin valixhet me para dhe pastaj të ikin, siç e kanë bërë zakon, jashtë shtetit, për t'i ngrënë në qetësi, me gratë dhe fëmijët e tyre, ato që kanë vjedhur.

Një dyluftim i egër do të bëhet këtu midis pjesës së shëndoshë të Shqipërisë dhe këtyre kastave, që janë mortja e saj. Shqipëria e shëndoshë duhet të tregohet e pamëshirshme me ta. Unë kam besim se ajo do të gjejë forca dhe njerëz idealistë për ta goditur këtë flamë. Ajo nuk do t'i lërë të gëzojnë paratë e grabitura as ata dhe as gratë e fëmijët e tyre. Unë jam takuar e kam

folur gjatë me shumë njerëz në Shqipëri, me njerëz që kanë jo vetëm mendje të kthjellët e fisnike, por që kanë shpesh edhe mjetet, edhe armët, për ta vënë në gjunjë të keqen. Unë kam besim te këta njerëz.

*Ka filluar të flitet më shpesh për rrezikun e "Shqipërisë së Madhe". Mendoni se ka patur një ide për të mbajtur të dobët shtetin shqiptar me qëllim për të zvogëluar ambiciet për "Shqipërinë e Madhe"?*

Pasi dështuan me mitin e Kosovës si djep i Serbisë, rrethet antishqiptare ballkanase, kryesisht serbe dhe greke, si dhe përkrahësit e tyre evropianë, po përpiqen të krijojnë një kundërmit, atë të "Shqipërisë së Madhe". Me këtë fantazmë përpiqen të trembin kancelaritë evropiane dhe opinionin publik botëror.

Ne, shqiptarët, as duhet të hutohemi prej kasnecëve që i bien borisë kundër "Shqipërisë së Madhe" virtuale, qofshin këta filozofë apo akademikë - ngaqë kemi parë mjaft të tillë kohët e fundit, që meritojnë emrin kriminelë, - as të zemërohemi, por të mbledhim mendjen për ta shpjeguar me gjakftohtësi këtë punë.

Shqipëria e natyrshme, Shqipëria natyrale, siç e thotë vetë fjala, do të vijë natyrshëm. Dhe gjërat që vijnë natyrshëm janë më të sigurtat dhe më harmoniozet.

*Një fenomen i ri po zhvillohet në mënyrë intensive. Shqipëria është kthyer në një vend tranzit, ku shqiptarët, tani edhe pjesa më e kualifikuar, po kërkon mënyrat për të ikur. Si mund të rikthehet shpresa?*

Askush s'mund të pengojë qarkullimin e njerëzve

dhe shqiptarët s'bëjnë përjashtim nga ky ligj. Kjo ka ndodhur me të gjithë popujt e Evropës dhe kjo do të ndodhë edhe me ne. Ajo që është e veçantë kohët e fundit në Shqipëri është një psikozë disi e sëmurë, që është krijuar në lidhje me ikjen. Psikozë të sëmurë unë quaj një prirje për ikje, kur ajo s'ka arsye të njëmendta. Kam takuar në Francë familje bujqish shqiptarë që kanë shitur tokën, livadhin e shtëpinë dhe janë shkukur me gra e fëmijë, pa e patur të qartë as vetë përse. Kanë ndërruar pra shtëpinë e tokën me një banesë të varfër emigranti, për të mos thënë edhe më keq. Kam takuar njerëz të shtresave të tjera, mjekë, arkitektë e inxhinierë, që bëjnë punë fare të padenja, por nuk po zgjatem me këtë ngaqë kjo dihet. Përmenda tre profesione, për të cilat ka punë në Shqipëri dhe që në Shqipëri, sido që të jetë, shpërblehen më mirë, po të bëhen të gjitha krahasimet.

Natyrisht, ka dhe do të ketë gjithmonë njerëz që, për një arsye ose një tjetër, u volit të punojnë në një tjetër vend, por e kisha fjalën për psikozën. Psikoza i errëson arsyet. Ajo krijon gjendje shpirtërore të turbullta, dyzime torturuese. Ka njerëz që e dinë se në atë vend ku venë nuk do t'i kenë punët mirë, por psikoza i bën të mendojnë se duke shkuar "atje" vetvetiu ngrihen në një rang më të lartë. E, në të vërtetë, është e kundërta.

Ata që mendojnë të ikin, ngaqë nuk janë disa herë të bindur për shkaqet e këtij vendimi, e lënë veten të vetëhipnotizohen, duke krijuar një mendim mohues për gjithçka. Ata nisin dhe e përhapin atë mendim, kërkojnë t'i mbushin mendjen të tjerëve për të ikur e, në të vërtetë, duan t'i mbushin mendjen vetes. Kështu, kjo arrin gjer te mendimi "Ky vend s'bëhet! T'i bjerë më mirë zjarri!".

Mendoj se këtu fillon diçka e keqe, e pandershme, diçka që meriton të quhet turp për një popull. Është e drejta jote ta braktisësh anijen, por s'ke kurrfarë të drejte të dëshirosh mbytjen e saj, për të ngushëlluar veten se ti, që ike, zgjodhe rrugën më të drejtë.

Për fat të keq, një pjesë e shtypit shqiptar i bën jehonë miradashëse kësaj psikoze të sëmurë, për shkaqe të ndryshme, që nuk është vendi të shtjellohen këtu.

Shpresa që ju dëshironi, siç e kuptova unë, të rikthehet mendoj se mund të rikthehet vërtet. Kjo zonë e Ballkanit, Tiranë-Shkup-Prishtinë, me fjalë të tjera, kjo zonë ku gjallon me shumicë gjindja shqiptare, mund të kritikohet për shumë gjëra, por një gjë nuk mund t'i mohohet: ajo nuk ngjan më provinciale, kënd i humbur, kënd i mënjanuar. Në këtë hapësirë ka një energji të brendshme, nga ato që janë karakteristike për zonat qendrore. Kjo zonë, me të ardhme të fuqishme, do t'i lërë prapa pjesë të tëra të gadishullit, ndaj ka edhe nervozizëm kundër saj.

Këtu ka mundësi të mëdha. Këtu ka diçka që nis e jo diçka që mbaron. Njerëzit e aftë e kuptojnë këtë. Ata do ta kapin shansin dhe ritmin e kohës. Ata do të jenë të suksesshmit dhe jo ankimtarët, që ngopen me ëndrra të zbrazëta.

Do të shtoja edhe diçka. Dihet se në shumë vende shqiptarët nuk i duan. Përveç shkaqeve meskine vulgare, përveç atij "shovinizmi prej parvënyje" të një pjese të shtypit grek e italian (si të thuash "shovinizmi i larove të djeshëm", që kujtojnë se u bënë zotërinj), një nga shkaqet themelore, përse nuk duhen shqiptarët, është se shqiptarët nuk e duan vetveten.

Këtu është dhe nyja tragjike ku ngecin një pjesë



prej tyre: duke u ndarë me vendin e vet keqas - me mallkime, mllefe e sharje - kujtojnë se ngrihen mbi atë vend dhe shihen me mirëkuptim prej të tjerëve. Është krejt e kundërta: pas buzëqeshjes hipokrite të palës tjetër, vjen përçmimi.

*Po ju vetë, z. Ismail Kadare, ndonëse jeni i lidhur me anë të librave me vendin, a keni ndërmend të vini të jetoni një ditë këtu?*

Ju keni të drejtë të ma bëni këtë pyetje. Unë kam ndër mend të kthehem e të jetoj në Shqipëri. Kjo nuk do të jetë tepër e largët. Një trysni politike e bezdisshme në vend, si edhe fakti që në Paris tani për tani kam, si të thuash, të vendosur punishten time letrare (botimi i veprave të plota në dy gjuhë, administrimin e botimeve në të gjithë botën), kanë qenë dy shkaqet e vonesës për këtë vendim. Me qetësimin e vendit, bie pengesa e parë. Me krijimin e mundësive moderne të komunikacionit, gjen zgjidhje pjesërisht edhe pengesa tjetër. Të tjerat janë çështje të dorës së dytë, që janë të zgjidhshme më lehtë.

*Çfarë është mjedisi aktual shqiptar, ai social-politik, ekonomik-kulturor për shkrimtarin Kadare? A sugjeron e frymëzon ide një mjedis dhe një vend që po shpërdoron skajshmërisht liritë e pluralizmit?*

Në Shqipëri ka etje, dëshirë dhe vullnet për një zhvillim kulturor të vërtetë, ndryshe nga ç'paralajmërojnë qyqet. (Kur qyqet janë të shumta në Evropë, merret me mend se si gëlojnë këtu në Ballkan).

Dy shfaqje teatrale, të dy stileve fare të ndryshme, që pashë në Tiranë, më habitën me nivelin e lartë artistik.

Pjesa e nxjerrë prej A. Borës nga një legjendë mesjetare, ai grup vajzash e djemsh të talentuar e me përkushtim prekës ndaj artit, mund ta përfaqësojnë teatrin shqiptar me dinjitet në çdo skenë të Evropës. Filmi "Bolero" i B. Bishës gjithashtu. Kam parë shumë pëlhura të mrekullueshme të piktorëve të rinj, kam dëgjuar koncerte, kam dëgjuar biseda të thella, nga ato që paralajmërojnë art, së fundi, kam ndjekur në orët e lajmeve greva të artistëve, çka tregon se në këtë vend ka njerëz që e duan artin e kulturën dhe jo vetëm që e duan por që e krijojnë dhe që janë plot zemërim e shqetësim fisnik për ta mbrojtur nga barbaria e kohës.

Lidhur me letërsinë, ngaqë botuesit janë të shumtë, kam frikë se më kanë shpëtuar autorë ose vepra të rëndësishme. Qoftë kështu! Ndërkaq, dua të them se, gjatë udhëtimit të fundit në Shqipëri, u njoha me revistën "Aleph" dhe ky ishte për mua një gëzim i madh intelektual. Kjo revistë e një grupi shkrimtarësh, eseistësh, kritikësh e përkthyesish të rinj është, me sa duket, arritja më e rëndësishme kulturore e viteve të fundit. Dikujt mund t'i duket ky vlerësim i tepruar, ngaqë në botime të tilla të guximshme e heraldike ka përherë diçka shqetësuese, diçka që nuk e arrin dot shenjë, ose e kapërcen atë. Parapëlqej një vizion tjetër: atë të gjetjes së vlerave të mirëfillta, edhe kur ato, për arsye që mund të merren me mend, qëllojnë të jenë jo fort të kapshme sepse janë të fshehura pas gjithfarë guackash e zhguajsh. Ky vizion, si të thuash diamantin, është i nevojshëm kur kemi të bëjmë me dukuri që hapin shtigje.

Në këtë aventurë të bukur artistike, përveç një niveli të admirueshëm e një elitizmi të shëndoshë, kam vërejtur një tjetër shenjë, ndoshta pikërisht atë që ka paravendosur fatin e saj të mbarë. Ky grup shkrimtarësh e intelektualësh të rinj ka hyrë në letërsi me dashuri dhe jo me mllef e hidhësi, lëngatë, për fat të keq, tepër e njohur, që ka rrëzuar kaq breza të rinj shkrimtarësh në këtë vend. Të hysh me dashuri në tempull nuk do të thotë të mos guxosh, të synosh e madje të kalosh krenajat e letërsisë. S'kam qenë as nëntëmbëdhjetë vjeç kur isha i bindur se shkruaja më bukur se Naim Frashëri (për të mos ju thënë gjëma të tjera). E, megjithatë, kjo bindje, që nuk u qortua brenda meje asnjëherë, nuk më bëri kurrë ta përçmoja e aq më pak ta shaja poetin, përkundrazi. S'ka të bëjë me moralin, s'ka të bëjë me dashurinë kristiane. Dashuria në letërsi është pjesë e kësaj mjeshtërie të shenjtë. Ajo është njëherësh pjellë e trurit dhe shenjimi i fatit.

Revista "Aleph", siç vura re, ka nisur si revistë përkthimesh, për të shkuar drejt përmasash plotësuese. Gërshetimi i letrave botërore me ato shqipe, ka qenë përvojë tepër e suksesshme, çka duket me botimin e romanit "Dueli" të A. Tufës, një nga krijimet më të bukura, që më ka qëlluar të lexoj në këta dhjetë vjet të paskomunizmit.

Bisedoi: Ylli Rakipi

## SHQIPËRIA, SI DO TË JETË NË BALLKAN

*Intervistë në "Shekulli",  
Tiranë ,Tetor 2000*

*Pyetja e parë për ju kur vini në Shqipëri është bërë tanimë tradicionale. Si e shikoni gjendjen? Pas kësaj pyetjeje është preokupimi i ligjshëm i njerëzve për fatin tonë, për shanset që kemi ose që i humbim.*

Një pyetje tradicionale ka rrezik të nxisë një përgjigje të të njëjtit lloj, pra tradicionale. Do të përpiqem t'i shmangem kësaj dhe ta mendoj pyetjen tuaj si të bërë për herë të parë.

Unë hyj ndër ata që kam besim në këtë vend. Meqenëse në kohën tonë mosbesimi ngjan më modern (shpesh me arsye) se besimi, përgjigjja ime mund të duket jo fort e kohës. E, megjithatë, po e përsëris: besimi im nuk është lëkundur aspak.

Shanset që dalin ose që humbin për një popull nuk janë si numrat e llotarisë. Ka një gërshetim faktorësh që i diktojnë. Ato që duken dhe ato që fshihen në thellësi. Ato që ne i dimë e ato që nuk i dimë, që do t'i marrim

vesh më pas, që nuk do t'i marrim vesh, e që, ndoshta, s'është nevoja t'i marrim vesh asnjëherë.

Kur u duk se populli shqiptar u harrua, se një pjesë e tij po mbytej nga dhuna serbe dhe nga shpërfillja evropiane, ndodhi e pabesueshmja: pikërisht për shkak të tij u krye lufta e fundit e mijëvjeçarit në Evropë, luftë që do të mbetet në historinë e kontinentit dhe të botës.

Ndër këta faktorë, faktori shqiptar mbetet sot kryesori. Çdo e keqe që mund t'i vijë sot nga të tjerët popullit shqiptar, mbetet e vogël në krahasim me të keqen që shqiptarët mund t'i bëjnë (e nganjëherë s'përtojnë t'ia bëjnë) vetvetes.

Në qoftë se ky vizion ju duket pesimist, po ju them se është e kundërta. Është optimiste të dish se rrjedha e fatit tënd është transferuar në duart e tua.

Një rregullim i brendshëm i shqiptarëve qoftë në Shqipëri, qoftë në Kosovë, një qytetërim i jetës politike, forcimi i institucioneve demokratike, zhvillimi i ekonomisë, shëndoshja morale vlejné më shumë se aleancat, marrëveshjet, kreditë, ndihmat. Përkundër profecive të kukuvajkave anambanë kontinentit evropian, zgjedhjet e porsazhvilluara në Kosovë ishin një dëshmi e mrekullueshme e rezervës qytetëruese që ndryn në vetvete populli shqiptar.

*Mendoni se do të ndihet më në fund prania jonë në Ballkan, se do të bëhemi edhe ne të rëndësishëm, siç thoshin filozofët tanë të Rilindjes, apo kjo nuk është veçse një ëndërr si të tjerat?*

Pesha dhe rëndësia e një populli nuk varen as nga

ëndërrimet boshe, e aq më pak nga lakmitë, për t'u fryrë si bretkoca, që donte të bëhej buall, (përrallë aq fort aktuale sot në Ballkan).

Populli shqiptar duhet të sigurojë në gadishull atë peshë e rëndësi që i jep gjendja e tij natyrale (atë hise të vet nën këtë diell, siç thoshin të vjetrit) pa lakmuar më tepër, e pa ulur kryet për t'u kënaqur me më pak.

Pesha, përmasat e njëmendta të një populli janë në fund të fundit pasqyrimi i asaj që quhet liri e tij, e drejta natyrale për të jetuar e për t'u zhvilluar.

Një nga shkaqet themelore të konfliktit shqiptaroserb, ndonëse nuk thuhet, mendoj se ka të bëjë pikërisht me peshën dhe rëndësinë e tyre në gadishull. Skema tani për tani është kjo: Serbia e rëndësishme. Shqipëria e parëndësishme. Rrjedhimisht bëhet çmos që Serbia të vazhdojë të quhet e rëndësishme, Shqipëria të vazhdojë të quhet e parëndësishme. Serbia ka vënë në fytyrë maskën e Jugosllavisë së zhdukur, e hiqet si shtet i madh. Shqipëria vazhdon të mbajë rrekat e vendit të coptuar e nga kjo duket edhe më e vogël e më pa peshë. Në të vërtetë ky është një dekor i jashtëm, një realitet virtual, kurse thelbi është ndryshe. Faktori shqiptar në gadishull, përmasat e popullit shqiptar, numri, energjia njerëzore, historia, kultura, gjuha, nuk ka asgjë më pak se faktori serb. Kjo e vërtetë jo vetëm nuk pranohet prej serbëve, por iu shkakton atyre një tërbim të papërfytyrueshëm. Kjo e vërtetë nuk pranohet as nga miqtë e tyre në Evropë dhe në botë. Një tufë e pafundshme politologësh, letrarësh, gazetarësh, bëjnë çmos për ta mbajtur në këmbë këtë iluzion. Përpara faktorit fizik shqiptar (sasisë së shqiptarëve) ata mbyllin sytë, duke përfutur dinakërisht nga shpërndarja e

shqiptarëve në dy shtete fqinje, e sidomos duke e konsideruar Kosovën pjesë të Serbisë. Për faktorin shpirtëror, kulturor, e kanë më lehtë sepse në sferat më të epërme mashtrimet sajohen gjithmonë më lehtë. Për ta bërë edhe më të besueshme këtë hipnozë ata shkojnë edhe më larg, duke ngulur këmbë se kështu ka qenë gjithmonë, pra ky realitet i sotëm është sipas tyre vazhdimi logjik i një gjendje shekullore. Për mendësinë europiane, në të cilën mbeturinat e vizionit kolonialist janë ende të forta, kjo është diçka e lehtë për të ngjitur ngaqë iu kujton ato që kanë mësuar në shkollë për raportet koloni-metropol. Ndonëse intelektualisht ata mund ta dënojnë shtypjen, në një shtresë të errët të ndërgjegjes, si ish kolonialistë, ata identifikohen me shtypësin, kurse i shtypuri iu duket tradicionalisht i largët e i huaj. Pikërisht te kjo e kanë vënë shpresën nacionalistët serbë dhe pikërisht nga kjo shpjegohet habia e tyre që Evropa dhe SHBA u morën seriozisht me shqiptarët. Për ta ky është dëshpërimi më i madh ngaqë, sipas tyre, kushërinjtë e Evropës ishin ata, kurse bijtë e njerks ishin shqiptarët.

Raportet serbo-shqiptare gjatë shekujve s'kanë asgjë të përbashkët me këtë klishe. Akademiku Dushan Batakoviç, një nga kasnecët e Serbisë së Madhe, në librin e tij "Kosova, spirale e urrejtjes" botuar pak kohë më parë në Zvicër, dëshmon për diçka që propaganda serbe nuk dëshiron ta cekë. Duke folur për bashkimin e Kosovës me Serbinë më 1918, ai shkruan: "Shqiptarët e Kosovës, liderët e tyre, shefat e klaneve e të pronarëve të mëdhenj, që qenë konsideruar si një farë aristokracie kombëtare, deklaruan haptas se nuk mund ta duronin sundimin e ish shërbëtorëve të tyre, ata të cilët ende i

quanin në mënyrë përçmuese *shkje*".

Siç shihet, mosdurimi ose urrejtja serbo-shqiptare, ajo e cila shpesh trajtohet si misterioze etj. etj. është, veç të tjerash, një çështje revanshi. Dje ju shqiptarët ishit senjorë në Ballkan, sot është radha e jonë etj. etj. Me fjalë të tjera, historia e njohur e njerëzve, që për t'u shëruar nga dhuna dhe fyerjet e pësuar në fëmëni, kërkojnë t'i ushtrojnë ato mbi të tjerët, histori që, me sa duket, përsëritet midis popujve.

*Të rikthehemi te pesha dhe rëndësia e një populli. Krijohet përshtypja se po të kërkojmë ne shqiptarët "hisën tonë nën këtë diell" kjo quhet si kërkesë për Shqipërinë e Madhe.*

Është e vërtetë se merret ashtu. Miti i Shqipërisë së Madhe u ringjall kohët e fundit për të krijuar barazpeshë me kërkesën e Serbisë së madhe. Ndryshimi është se ndërsa ky i fundit është një program në emër të të cilit luftohet e veprohet haptas, fantazma e Shqipërisë së Madhe gjëllon kryesisht në propagandën antishqiptare.

Me fjalë të tjera, ndërsa Shqipëria quhet e parëndësishme me gjithçka, ajo bëhet befas e rëndësishme, pra pranohet rëndësia e saj jo si një realitet normal, por vetëm si rrezik, si një mundësi e keqe. Të mësuar që në mënyrë fyese e të verbër ta quanin të vogël e të parëndësishëm, tani që populli shqiptar po del nga mjegulla e një nate, shtati i tij i natyrshëm i tmerron ata që s'e kanë dashur. Ata ulërijnë: po del rreziku, po del Shqipëria e Madhe! Ne duhet t'u themi: s'po del asnjë rrezik, asnjë Shqipëri e Madhe ose e



Vogël. Po del thjesht Shqipëria.

Kundërthënia është e hapët. Një vend s'mund të jetë njëkohësisht edhe i rëndësishëm edhe i parëndësishëm. (I rëndësishëm kur është rasti për t'u goditur, i parëndësishëm kur duhet dhënë dora e ndihmës apo miqësisë).

Në këtë kah, shprehja Shqipëri e Madhe nuk është veçse një eufemizëm që nënkupton një program cinik për të penguar zhvillimin normal të një populli, një doktrinë ngacmimi të përhershëm për ta lënë atë popull shtatanik, për t'i ngritur mure e pengesa midis, pikërisht kur muret janë shembur në kontinent.

Me të njohurit e mi të huaj, kur më bie rasti shpesh të bisedoj për këtë temë i pyes: ku e keni parë projektin e Shqipërisë së madhe, ku i keni parë librat, konferencat, forumet, doktrinën, programin, partitë që e mbrojnë, grupet parlamentare, lëvizjen popullore, skicën e hapur, skicën e fshehtë etj., etj. Kësaj pyetjeje ata i përgjigjen zakonisht me një ngritje supesh.

*Shkrimtari grek Vasili Vasilikos, ka shkruar kohët e fundit në gazetën "Lë Monde" se vepra juaj është, me sa duket një skicë e fshehtë e Shqipërisë së Madhe.*

E kam parë këtë shkrim dhe më ka zbavitur. Ndoshta shprehja Shqipëri e Madhe, duhet zëvendësuar këtu me shprehjen Shqipëri e Stërmadhe, ngaqë po të nisemi nga projekti im i fshehtë dhe padyshim tepër djallëzor, në të do të futeshin edhe piramidat e Egjiptit edhe stepa ruse edhe rrafshulta të Anadollit dhe ndonjë copë nga Muri Kinez, dhe hapësira të tjera që kam përmendur në librat e mia.

Singerisht s'do të më vinte keq që disa njerëz të merreshin me këto libra e të linin të qetë popullin shqiptar, që edhe pa këto marrëzira, ka mjaft andrralla mbi kokë.

Kjo që thashë më lart duket si mahi, por nuk është aspak e tepruar. Ju e dini ndoshta se synimi shqiptar për një gjuhë të njëjësuar, synim i përbashkët i të gjitha kombeve evropiane, është i interpretuar gjithashtu si pjesë e projektit për Shqipërinë e Madhe dhe kjo jo vetëm nga rrethe të huaja antishqiptare por edhe nga disa karagjozë shqiptarë, në Tiranë e në Prishtinë.

Shqiptarët nuk kanë nevojë as për Shqipëri të madhe, as për Shqipëri të vogël, ata kanë nevojë për Shqipërinë e tyre natyrale brenda peizazhit demokratik evropian. Nuk mund t'i kërkohen këtij vendi ligje të tjera nga ato që s'i kërkohen askujt. Shqiptarët s'mund të merren as si gogol për të trembur të tjerët, as si nxënës shembullorë. Ata s'kanë nevojë për nofka lavdëruese, natyrisht as për fyerje.

Shqiptarët do ta ripohojnë peshën e tyre, identitetin, gjithçka, jo duke u mburrur për shembull me papët me origjinë ilire, as me themelimin e dinastisë mbretërore egjiptiane (që për fat e kanë harruar), e as me profka të tjera të këtij lloji. Aq më pak mund ta pohojnë atë me revansh dhe me krime. Dihet që krimi është ngjithës, sidomos në hapësirën nervoze ballkanike. Për të patur të drejtën morale të dënojnë krimin e ushtruar ndaj tyre shqiptarët duhet t'i refuzojnë me ngulm hakmarrjen dhe krimin si mënyrë çlirimi nga e keqja. Ne duhet të mësohemi të dënojmë të keqen, racizmin tonë kur ai shfaqet, krimin tonë. T'i dënojmë jo për të larë gojën, për t'u paraqitur humanistë, por me bindje të thellë se

rruga e krimit është rruga e katastrofës. Ndonëse kemi pësuar dhunë nga serbët, s'duhet të kemi drojë të dënojmë me pasion hakmarrjen ndaj serbëve të pafajshëm, ndaj ciganëve e ndaj kujdo qoftë.

Thuhet shpesh se nuk jemi racistë agresivë. Dhe përmenden raportet e shqiptarëve me ciganët ose me romët ose gipsët (ata që jo pa përçmim quhen jevgj). Mendoj, megjithatë, se ashtu si tumorin e keq e mbështjell shpesh një cipë e hollë, ashtu ndodh edhe me racizmin pasiv. Shumë shpejt ai mund të kthehet në racizëm veprues. Ne duhet t'i kishim mbrojtur më me vendosmëri ciganët dhe romët e pafajshëm në Kosovë, kur ata u kërcënuan nga hakmarrja e verbër. Ne s'duhet të bënim asnjë lëshim kur ishte fjala për mbrojtjen e serbëve të pafajshëm. Ne duhet të dënojmë ashpërsisht krimet e trafikantëve shqiptarë kundër kurdëve, kinezëve ose nevojtarëve të kombësive të tjera, që mjerimi i bie në mëshirën tonë. Për ne duhet të jetë i papranueshëm dhe kriminal humori i zi që bëhet me këtë rast me viktimat ngaqë janë të tjetër kombësie.

Nga ky pastrim populli shqiptar nuk dobësohet. Përkundrazi.

*Ju keni reaguar ashpër kohët e fundit ndaj librit të Xavier Raufer "Mafia shqiptare" duke e akuzuar pikërisht për racizëm antishqiptar; A mund të shërbejë ky racizëm antishqiptar si argument për të përligjur kundërsulmin tonë?*

Kurrresi nuk mund të përligjet kurrfarë racizmi. Libri i francezit Xavier Raufer është shembull i një racizmi primitiv, që të kujton fashizmin. Në të thuhet se

mafia shqiptare drejtoka mafien evropiane, ngaqë në bazë të saj qëndrojnë "Kanuni" dhe "Besa"! (Pra kemi përsëri rëndësinë, madje përmasat evropiane të një populli, por vetëm për keq). Në të thuhet se janë shqiptarët e shekullit 15 që i mësuan italianëve kodin mafioz! Në të këmbëngulet se thelbi, struktura e brendshme e këtij kombi është mafioze, për të ardhur gjer te pohimi kriminal se të deportuarit shqiptarë gjatë luftës së Kosovës, nuk ikin prej masakrave, por ishin të zgjedhur nga mafia për të shpërndarë drogën nëpër botë.

Është padyshim revoltuese që një intelektual francez mund të pështyjë kështu mbi dramën e një populli, mbi fëmijët e vrarë e mbi gjithë atë zi të pafund. E megjithatë as racizmi i këtij barbari nga Evropa, as racizmi prej horrash provincialë i italianëve, ose ai prej horrash fshati i grekëve, as cinizmi i mynxyrave të tilla morale si raportuesi i OKB-së Jirzhi Dientsbier, nuk mundën kurrsesi të përlligjin marrëzitë tona të mundshme.

*Të kthehemi në ngjarjen e fundit aktuale të Ballkanit: rënien e Millosheviçit dhe ngritjen e Kostunicës. Besoj se e keni pritur këtë pyetje. Kemi dëgjuar reagimin tuaj të ftohtë për Kostunicën në radion e Francës e të Zvicrës.*

Së pari, dua të theksoj se rënia e Millosheviçit ka qenë pa asnjë dyshim një lajm i mirë. Së dyti, se me një Serbi demokratike si Kosova, si Shqipëria, si gjithë Ballkani do të fqinjëzonin krejt ndryshe, domethënë shumë më mirë se me një Serbi nacionaliste (domethënë

të marrë). Unë jam kundër çdo lloj xhelozie ndaj vendeve të tjera në rajon.

Gjithë puna është nëse jemi vërtet përpara një zhvillimi demokratik apo përpara një bllofi. Në këtë kah unë i kuptoj fare mirë rezervat e shqiptarëve të Kosovës. Do të përpiqem t'i bije shkurt për të mos u zgjatur në gjëra të njohura. Ka qenë nevoja për një ndryshim të Serbisë e jo veç të liderit të saj. Një lider komunist-nacionalist u zëvendësua nga një lider jokomunist-nacionalist, madje më i thekur për nacionalizëm se i pari. Ky lider na paska si faqen më të ndritur të biografisë antishqiptarizmin, për shkak të të cilit Titoja e dënoi më 1974!

Kjo do të ishte gjysma e të keqes nëqoftëse ky njeri do të kishte bërë një korrigjim. Por për fat të keq, deklaratimet e tij të para sidomos ato për gjyqin e Hagës, për Kosovën e për të burgosurit shqiptarë të zënë peng nga Serbia ishin politikisht e moralisht të mjerueshme. Ato tregojnë se elita politike serbe është sot më e paemancipuar në gadishull. Megjithatë, unë mendoj se në rastin e Kostunicës, nëqoftëse ai ndryshon për të mirë nuk ka pse të mbahen paragjykime kundër tij.

*Megjithatë Europa, sidomos Franca e Italia pa pritur asnjë shenjë treguan një eufori të habitshme në këtë rast.*

Është e vërtetë se u tregua një dehje e një eufori befasuese, çka tregon se emancipimi nuk është vetëm problem ballkanik.

E kuptoj fare mirë inkurajimin që i jepet një vendi kur bie një tiran, megjithatë është e pakuptueshme se si

Evropa nuk i kërkoi asnjë deklaram politik themelor këtij vendi për dhjetë vjet krime kundër të tjerëve. U duk sikur Evropa kërkoi të kalojë një sfungjer mbi peisazhin e përgjakur ballkanik. Por në Ballkan, më mirë se kudo dihet se asnjë sfungjer s'mund të lajë gjakun dhe krimin. Nga kjo pikëpamje ekstaza europiane mund të merrej si një fyerje për të gjithë popujt që e vuajtën këtë tmerr. Një thirrje për ta bërë të ndërgjegjshme Serbinë për përgjegjësinë e saj është pritur nga opinioni publik, çka është shprehur gjerësisht nga shtypi.

*Është një harresë kjo gjë sipas jush apo kërkesë për revizionimin e një politike?*

Besoj se janë të dyja nga pak. Analistët e kërkojnë shpjegimin e kësaj në lidhjet tradicionale. Pa e kundërshtuar këtë mendoj se prapa tyre ka shkaqe më të fshehura. Në një shkallë botërore mendoj se pavarësisht nga përparimi i tij njerëzimi ka mbetur shumë i egër. Mendimi kriminel, ai që shoqëron veprimin kriminel jo vetëm s'është zbehur por rrallë herë ka qenë kaq i dukshëm si në shekullin tonë. Në këtë skajim Evropa nuk bën ndonjë përjashtim. Flirti me krimin këtu janë të njohura.

Në kujtimet e amerikanit Xhejms Rubin, botuar tani së fundi në "Financial Times", përmendet episodi kur presidenti i Serbisë, Milutinoviç që kryesonte delegacionin serb në Rambuje, duke mos kuptuar asgjë nga ajo që po ndodhte, u thotë amerikanëve: "Përse shqetësoheni për shqiptarët? Na e lini ne këtë punë dhe ne e mbarojmë për një javë" (Me fjalë të tjera, na lini t'i farojmë ne shpejt e shpejt).

Të mësuar të flasin kështu me perëndimorët kur vjen fjala për shqiptarët, serbët e përdorin atë gjuhë edhe një javë përpara bombardimit. Pyetja që del në këtë rast është tepër shqetësuese: mirë ky kriminel kokëtrashë, krejtësisht jashtë realitetit flet kështu, po Evropa si e ka pranuar këtë gjuhë më parë? Sepse kjo gjuhë cubash, për fat të keq nuk është përdorur për herë të parë në Rambuje. Ajo ka patur, me sa dukej një traditë dhe pranimi i asaj gjuhe ka qenë interpretuar nga serbët si dritë e gjelbër për krimin antishqiptar.

*A mund të flitet në këtë rast për një predispozitë antishqiptare në një pjesë të Evropës, përshembull në Francë, ku ju kaloni një pjesë të kohës?*

Gjërat janë më të ndërlikuara se ç'duken. Gjatë luftës së Kosovës, Franca u fajësua gjithashtu prej Serbisë për predispozitë antiserbe. Si njëra predispozitë, si tjetra janë dhe nuk janë të vërteta. Varet nga rrethanat, varet për ç'sfera bëhet fjalë. Në një vizion të përgjithshëm Franca, ka qenë dhe ndoshta vazhdon të mbetet më afër Serbisë se Shqipërisë. Sidomos diplomacia, kreu i ushtrisë, e djathta ekstreme dhe e majta ekstreme. Ndërkaq një pjesë zotëruese e elitës kulturore e politike dhe e opinionit publik kanë tjetër qëndrim. E megjithatë edhe kjo ndarje nuk është edhe s'ka si të jetë e saktë.

E vërteta është se ndërsa ekziston një nostalgji proserbe në këtë vend, nuk mund të flitet për një nostalgji proshqiptare. Nostalgji proshqiptare mendoj se nuk ka kurrkund, ngaqë miqtë e mbrapshtë që ne zumë: jugosllavë, sovjetikë dhe kinezë, kanë qenë miq

të rremë dhe po aq të rremë kanë qenë miqtë më të hershëm, italianët. Nostalgjinë proshqiptare mund ta krijojë koha jonë. Atë mund ta krijojë qytetërimi ynë i sotëm demokratik në qoftë se ai ndërtohet, në aleancë me ngrohtësinë e njeriut dhe me peisazhin shqiptar, hatu e parë e këtij vendi.

Në vend që të na zerë smira pse ky ose ai vend ka afërsi me Serbinë, ne duhet të dimë t'i fitojmë miqësitë. Natyrisht që miqësia s'mund të jetë e njajshme. Në një mbledhje në mjediset e Asamblesë Kombëtare të Francës kam dëgjuar të citohet ambasadori francez në Shqipëri, sipas të cilit gjatë një jave në Tiranë vriten aq njerëz sa ç'vriten gjatë dy vjetëve në krejt Evropën Perëndimore. Në qoftë se zyrtari në fjalë e ka dhënë vërtet këtë shifër, me fjalë të tjera këtë thirrje për izolim të Shqipërisë, është vështirë të pritet ndonjë miqësi prej tij dhe prej zyrës që ai drejton.

Franca është një vend që unë e dua dhe e quaj një atdhe të dytë, gjë që më shtyn të them për të gjëra që nuk do t'i thoshja për një vend tjetër. Duke afishuar një ngrohtësi të tepëruar për një vend që ende nuk është shpëlarë nga krimi i djeshëm, Franca ka rrezik të fitojë ftohtësinë e së paku pesë shteteve të tjera ballkanike. Tërheqja e Francës prej gadishullit ku gjatë më shumë se dy shekuj ka qenë ngulitur natyrshëm në kulturën dhe historinë e gjithë popujve ballkanas nëpërmjet iluminizmit të saj, do të jetë një gjë e keqe për atë vetë dhe natyrisht për ballkanasit.

*Si e komentoni "profecinë" e presidentit të porsazgjedhur jugosllav se konflikti në Ballkan, pasi ka braktisur Serbinë do të zbresë në jug, domethënë*



## *në Shqipëri, si konflikt midis veriut dhe jugut?*

Ky pohim meriton një analizë psiko-politike. Ai zbulon një të vërtetë të fshehur me kujdes, një program, një hall, një ëndërr të Serbisë. Ka gjasë të jetë programi, halli ose ëndrra numër një e fqinjit tonë: destabilizimi i Shqipërisë. Zyrat jugosllave kanë vite që punojnë për të, nacionalistët kanë vite që psherëtitjnë, agjentët kanë vite që robëtohen. Kërkojnë idera, mënyra, mjete, herë të reja, herë të vjetra, herë të ringritura nga varri. Shefi i ri jugosllav, me të zënë vend në fronin presidencial, me të hapur dosjen e parë, ka ndeshur, me sa duket, kryefjalën e programit serb: troshitjen e Shqipërisë. Dhe meqenëse, me sa duket, nuk është fort i rafinuar nga mendja, u ngut ta shpallte gjithë gëzim në TV italian.

Tani del fare qartë se çka qenë kohët e fundit gjithë ajo zhurmë për konfliktin e pritnë midis jugut dhe veriut të Shqipërisë, midis gegëve dhe toskëve e natyrisht midis shqiptarëve të Shqipërisë e të Kosovës. Tani del qartë se ç'ka qenë ajo vijë ndarëse, lumi Shkumbin, që nuk mungonte asnjëherë në hartën e Shqipërisë, në lajmet e pranverës së vitit 1997. Përherë e më qartë del se ç'është ajo zhurmë për ndarjen e gegërishtes nga toskërishtja, ai nervozizëm kundër gjuhës së njëjësuar, për të ardhur gjer te gogoli i Shqipërisë së Madhe si një tmerr për Europën. Ky tmerr, sipas tyre, mund të shmangej vetëm po të ngriheshin mure midis shqiptarëve, të thyheshin urat bashkuese, të thyhej gjuha, duke u ndarë më dysh, mundësisht më tresh. Së fundi tani del edhe më qartë se ç'është ky pasion për destabilizim në Shqipëri e në Kosovë.

Agjentura ka punuar me shumë zell për këtë. Një pjesë e elitës politike dhe kulturore, si në Shqipëri si në Kosovë është përzier në këtë lojë të dyshimtë. Populli shqiptar ka kohë që me intuitë e ka ndier këtë mbrapshti. Shumë herë kam takuar njerëz të thjeshtë që më kanë pyetur: si shpjegohet që sapo nis të ndreqet diçka, menjëherë vihet në lëvizje një forcë e errët për të rikthyer kaosin?

*Rrjedhimisht një ftohje që vihet re në ca rrethe politike dhe kulturore në Kosovë kundër Shqipërisë a ka lidhje me këtë?*

Natyrisht. Ka patur psikoza nga të dy anët, por kohët e fundit armiqësimi ndaj Shqipërisë është shtuar në ato rrethe që përmendët ju. Duhet të jesh i metë nga mendja që të mos e kuptosh se kur një politikan ose letrar i Kosovës kërkon armiqësi ose preteks armiqësimi me Shqipërinë, ai s'bën gjë tjetër veçse i luan syrin Beogradit për t'i thënë: më ndanë nga ty, por zemrën e kam atje.

Dyshoj se ftohja shkallë-shkallë e Kosovës me Shqipërinë do të jetë këndeje e tutje boshti i strategjisë serbe. Për të do të punojnë forca të caktuara politike në Kosovë, të ndjekura nga një zhgan intelektualësh e letrarësh të pabesë, që në kësi rastesh s'mungojnë kurrë.

Ndërkaq, jam i bindur se kjo ndodh veç në sipërfaqe. Në thellësi asgjë nuk ndryshon. Sepse në thellësi, atje ku jeton, mendon dhe vendos ligjet populli i madh, atje sundon tjetër logjikë e tjetër realitet.

*Një seri artikujsh kundër jush, nga një farë Anton*

*Berisha e disa letrarë të tjerë ku ju akuzojnë se me kritikën tuaj i keni fyer shkrimtarët e Kosovës, a bëjnë pjesë në pretekset për sherr, apo kanë një bazë?*

Nuk i kam fyer dhe nuk do t'i fyej kurrë shkrimtarët e Kosovës. Po ju kujtoj se ndër tri veprat artistike që kam shkruar për dramën kosovare, dy prej tyre kanë si personazh qendror një shkrimtar dhe një poet, të dy sublimuar në shkallën më të lartë.

Kam kritikur disa herë hermetizmin e një pjese të letërsisë kosovare, nga që kam patur bindjen se kjo rendje ndaj avanguardizmit ka qenë shkak që ata të mos dëshmojnë për krimin kundër popullit të tyre. Përgjigja e tyre se ky dëshmim "është si detyrë shtëpie" e kam quajtur moralisht të papranueshme. Kam menduar dhe mendoj se dënimi i krimit ka ushqyer majat e letërsisë botërore.

Siç e shihni, kritika ime ka marrë shkas në radhë të parë nga mosdëshmimi i krimit, me fjalë të tjera nga mosplotësimi i dosjes së Kosovës, dosjes numër një të kombit shqiptar në këtë fund shekulli.

Dënimi i krimit në Kosovë nuk është vetëm çështje letrare. Ai ka lidhje me lirinë e Kosovës. Ju e dini se ç'po ndodh tani. Beogradi ka shpërthyer një ofensivë për të kthyer opinionin botëror në favor të tij. Ai përpiqet t'i kthejë gjërat kryengulthi: Serbët t'i paraqesë si viktima dhe shqiptarët si agresorë. Shkrimtarë e filozofë të njohur në perëndim si Petër Handke, Regis Debray, Naom Shomsky etj., për turp të tyre janë vënë të dëshmojnë në dobi të serbëve. Kurse disa letrarëve të Kosovës u duket se po ta bëjnë këtë në dobi të popullit të vet iu bie klasi.

Dëshmimi i letërsisë nuk është as luks e as "detyrë shtëpie". Ai ka një vend të pazëvendësueshëm në letrat kredenciale të një populli.

*Në një intervistë botuar në shtypin kosovar më 1998, njërin nga sulmuesit tuaj, e keni quajtur "Juda i Kosovës". Në romanin tuaj të fundit "Lulet e ftohta të marsit" e keni përsëri personazhin e Judës, këtë herë për një intelektual të Tiranës. Cili ka qenë shkaku që i jeni kthyer këtij personazhi të Biblës? Identiteti i tij, për shumë njerëz është i lexueshëm.*

Në jetën tonë, si në Shqipëri, si në Kosovë, judët po i ndeshim përsëri. Ndryshe nga kohë më parë, judët nuk mund të mbeten më pa u damkosur e pa u dënuar. Ka ardhur kohë e vështirë për judët. E meritojnë krusmën që i pret, si ai që shpif në Prishtinë a në Kozencë, si ai që ka spiunuar shkrimtarët në Tiranë.

*Të kthehem te problemi i stabilitetit që folëm pak më parë. Në gati çdo intervistë ju theksoni domosdoshmërinë për stabilitet mbi gjithçka. Lidhur me këtë a mendoni se diçka u arrit me zgjedhjet e fundit?*

Nuk besoj se e teproj me kërkesën për stabilitet. Si çdo shqiptar, unë e kujtoj me tmerr dhe me pikëllim vitin 1997. Ai ankth ende s'ka kaluar. Shqipëria pa stabilitet është njëlloj sikur ta ketë arkiolin përbri. Për fat të keq ka forca që janë të interesuara që të jetë kështu. Për fatin dyfish të keq qëllon që ato forca gjenden ndonjëherë jo vetëm midis opozitës por edhe midis

klasës politike që është në pushtet. Aleanca me krimin çon në atë logjikë.

Për zgjedhjet e fundit është folur aq shumë sa është vështirë të shtosh diçka. Mendoj se rruga për t'i thënë lamtumirë dhunës gjatë kalimit të pushtetit duhet të na gëzojë të gjithëve. Ndërkaq mendoj se nuk ka vend as për eufori të fituesve, e as për alibi të humbësve. Diçka është arritur por shumëçka nuk është arritur. Dobësimi i opozitës, ajo që mëndjelehtësisht i gëzon disa, është humbje për të gjithë. Në këtë dekadë të parë të demokracisë do të ishte mirë që pushteti të kalonte nga një forcë politike te tjetra. Do të ishte mirë që populli shqiptar t'i provonte të dyja palët. Kështu ai do të mësonte se si punon makina e demokracisë. Kalimi pa dhunë i pushtetit, ligji i parë i shoqërisë civile, është edhe më i vështiri për t'u mësuar. Por kjo nuk mund të kryhet me urrejtje, verbëri e bojkot, e natyrisht as me ngazëllim cinik fitimtarësh ose kërcëllitje dhëmbësh të të mundurve.

Kur partitë politike do t'i heqin nga vetja militantët sejmenë, ata që mbajnë gjallë këtë psikozë të mbetur nga lufta midis feudalëve dhe qyteteve, që Evropa e ka kryer disa shekuj më parë, dhe që një pjesë e Ballkanit po e kryen tani, ky do të jetë një frymëmarrje lehtësuese për të gjithë.

*Çështja e Himarës ishte sipas jush diçka e re apo një rizgjim i vjetër i demonëve nacionalistë?*

Farsa e Himarës ishte, në radhë të parë, theatër tipik ballkanik plot nerva, mllef, marrëzi dhe belbëzime idiotësh, siç do të thoshte Shekspiri. Një farë kohe nuk

e kam kuptuar dot se përse bëhej grindje. Kryetari i Partisë të të Drejtave të Njeriut, asaj që akuzohej si greke ose progreke, deklaroi qartë se është parti shqiptare, madje theksoi se në Himarë nuk ka minoritet grek. Ndërkaq, ata që pohojnë të kundërtën, duke përfshirë edhe vëzhguesit e huaj, as nuk e kundërshtuan as nuk e përkrahën këtë kryetar, që në këtë rast mund të quhej i zoti i punës, siç thuhet. Atë nuk e përfilli as pala shqiptare. Madje nga kjo palë dolën ca antigrekë të zjarrtë që gjer dje ishin akuzuar si progrekë të ligj. Prapësia ishte e tillë sa që s'do të habitësja po të dilte ndonjë nacionalist grek që të shpallej proshqiptar etj. etj.

Teatri absurd i Ballkanit është i pashtershëm. Këtu askush nuk habitet që një parti demokristiane i ka anëtarët myslimanë, ose që partia e të drejtave të njeriut, e akuzuar si greke nuk fiton pikërisht në zonën ku ka minoritarë grekë. Ndërkaq, shumë njerëz, duke përfshirë edhe ca vëzhgues të huaj, presin që ajo të fitojë në një zonë ku s'ka të tillë.

Lidhur me këta të fundit, është kërkuar me të drejtë një minimum njohjeje e vendit ku vijnë të vëzhgojnë. Aq më tepër që raportues e vëzhgues të tillë kanë qenë shpesh herë të verbër në Ballkan. Nuk u kërkon kush të dinë hollësisht, por ca gjëra themelore duhet t'i dinë. Kështu p.sh. të dinë që pa llogaritur refugjatët e sotëm, në Greqi ka njëzet herë më shumë shtetas grekë me origjinë shqiptare, se sa ka shtetas shqiptarë me origjinë greke në Shqipëri. E megjithatë asnjë herë, asnjë qeveri shqiptare nuk është kujtuar për ta. Vëzhguesit duhet të dinë gjithashtu se në Greqi, pas luftës së Dytë Botërore është kryer pastrim etnik i shqiptarëve, (çamëve) me

zjarr dhe me hekur. Ky kujtim i hidhur në vend që ta shtyjë Greqinë, drejt një shqyrtimi të ndërgjegjes, nxit shpesh herë të kundërtën.

I them këto fjalë për një vend, kulturën antike të të cilit e kam admiruar gjithmonë. Prej saj kam mësuar pikërisht se ç'është shqyrtimi i ndërgjegjes.

*Ju jepni herë pas here mesazhe shprese në kundërshtim me një frymë pesimizmi që ndeshet tek ne. Në mbyllje të kësaj interviste, a mund të na thoni diçka për të ardhmen?*

Nuk kam dhënë dhe nuk do të jap kurrë një kumt shprese, nëse nuk besoj në të. Kam bindjen se kombi shqiptar pavarësisht nga trazimet e sotme të mëdha, nuk ka qenë kurrë më mirë se sot. Në jetën e tij gërshetimi i rrethanave, atë që astrologët e mendojnë si skajim të favorshëm yjesh, kurrë nuk ka qenë kaq i mbarë. Asnjëherë ora e tij nuk ka qenë në të njëjtin kah me orën e botës së qytetëruar. Me fjalë të tjera, është hera e parë që zhvillimi shqiptar, prirja e tij, hovzimi i tij, përkojnë me programin e kontinentit.

Asnjë aspiratë shqiptare sot dhe asnjë interes jetik nuk bie ndesh me kostumin europian. Përkundrazi, të gjitha interesat e tij përkojnë me ato të Europës së nesërme: zbehja e kufijve, kontaktet e lira, shkëmbimet lëndore, njerëzore, kulturore. Është një shans i madh kur një popull s'kërkon veç zhvillimin e tij natyror. Është shans kur ai s'ka nevojë për demonë e për fantazma.

Prej gjithë këtyre që përmenda më lart, prej logjikës së brendshme të gjërave kushtëzohet natyrshëm emancipimi i njeriut shqiptar. Ky njeri, me ngecjet, cenet

dhe dozën e njohur të marrëzisë ballkanase, mbetet, tani për tani, pengesa e fundit e Shqipërisë. Por hullija e ecjes së tij është përcaktuar ndërkaq dhe janë të gjitha gjasat që ai të bëjë pjesë në grupin e parë të madh të qytetarëve evropianë në gadishull. E parë nga ky kënd, historia jonë moderne këndeje e tutje mund të merret si historia e kapërcimit të vetvetes.

Bisedoi Remzi Lani



**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

*Kadare, Ismail*

*Kadare*

Unaza në kthetra: sprova letrare, shkrime të ndryshme, intervista / Ismail Kadare; përgat. për bot. Bujar Hudhri. - Tiranë: Onufri, 2001. 176f.; 21cm.

*Ismail*

ISBN 99927-45-30-4

821.18-3

*Unaza në kthetra*

821.18-92